

MBROSHITJA

Viti i 94-të i botimit
Janar-shkurt 2026 / Nr. 1

NËN DY FLAMUJ, NJË MISIION

Brugëtimi i një emigranti shqiptar drejt
komandës së anijes luftarake amerikane
në epokën e tensioneve globale

REVISTA MBROJTJA

Organ Qendror i Ministrisë së Mbrojtjes

Viti i 94-të i botimit Janar-shkurt 2026 / Nr. 1

DREJTOR I QKMBM

ARBEN SKËNDERAJ

Shefe e Sektorit të Botimeve &

Kryeredaktore

ANJEZA MUSOLLARI

GRAPHIC DESIGNER

AFËRDITA HYSAJ

REDAKTORE / KORREKTORE

SUELA HODA

BASHKËPUNËTORË

KOLONEL HYSNI GJERGJI

PROF. ASOC. DR. ZAHO GOLEMI

© Ministria e Mbrojtjes

Materialet e publikuara në këtë revistë nuk mund të riprodhohen elektronikisht apo fizikisht e të përdoren për qëllime përfitimi, pa marrë autorizim nga botuesit e saj.

Botues:

Qendra e Kulturës, Medias dhe Botimeve të Mbrojtjes.

Adresa:

Rruga e Dibrës/ Garnizoni "Skënderbej"

Revista mund të gjendet në formatin elektronik (pdf) në adresën:

<http://www.mbrojtja.gov.al/index.php/publikime/revista-mbrojtja>



Mbrojtja

Ministri Vengu: Shqipëria hyn në një fazë të re të sigurisë dhe mbrojtjes. Buxheti 2026 ndërton kapacitete reale shtetërore	4
Shqipëria dhe Belgjika forcojnë partneritetin ushtarak për siguri rajonale	6
BUXHETI I MBROJTJES 2026, "Historik": Shqipëria Rrit Investimet për Forcat e Armatosura dhe Sigurinë Kombëtare	8
Ministri Vengu viziton trupat shqiptare në misionin e NATO-s në Bullgari: Vlerësim për togën shqiptare në Novo Selo	10
Efektivët e Forcës Tokësore rrisin kapacitetet luftarake me sistemin "Javelin".....	18
Gjeneralletjënant Arben Kingji merr pjesë në Takimin e 13-të të Konferencës së Shefave të Shtabit të Përgjithshëm të nismës "DECI" në Budapest	19
EMERGJENCAT CIVILE 2026 - Shqipëria forcon kapacitetet për përballimin e krizave dhe fatkeqësive natyrore	24
Forcat Tokësore në mision: Ndërrim kontingjentesh në kuadër të misionit NATO eVA	29
Gradimi, një hap i ri përgjegjësie dhe lidhshëri në Akademinë e Forcave të Armatosura	31
Bashkëpunim në aviacion dhe teknologji, FAJ zhvillon vizitë në Turqi	34
Betimi që lidh fjalën me Atdheun	36
Major Llaha: Rugëtimi i një oficeri, pesha e një grade, forca e një familjeje	45
Arben Skënderaj: Muzika dhe kultura, forca që bashkon uniformën me shpirtin	48
Mirënjohje që forcon misionin	50
105 vjet arma e artilerisë së ushtrisë shqiptare (1921-2026)	54
Policia ushtarake, 34 vite në shërbim të rendit, ligjit dhe sigurisë kombëtare	57
Rezoluta 1325 - dhe forcat e armatosura të Shqipërisë	65
Histori që shkruhet me dinjitet: dy gra në gradën gjeneral brigade	68
Kontributi i Grave dhe Vajzave Oficere në Ushtrinë Shqiptare	70
Sektorët që do të udhëheqin industrinë e mbrojtjes në vitin 2026:	
Industria globale, një epokë e re e sigurisë	74
Dëshmorët e Fekenit në memorien e përjetësisë ushtarake dhe kombëtare.....	76
Ballkani midis "NDAA-2026" dhe operacioneve hibride ruse	82
Tre dëshmorë nga oxhaku "Proda" krenari për Shqipërinë	94
Industria Ushtarake: Nga historia e armatimeve tek sfida e teknologjive moderne	98

63
100 Vjet
Forcë
Detare
Shqiptare

14

**Korridori 8 shpallet korridor sigurie
i NATO-s, Shqipëria në zemër të
planeve strategjike të Aleancës**

21

**Takim trepalësh në Shkodër: Intensifikohet
bashkëpunimi ushtarak Shqipëri-Kroaci-Kosovë**

52

**KAMPUSI I SË ARDHMES
Akademia e Forcave të Armatosura,
investimi strategjik që ndryshon
fytyrën e arsimit ushtarak shqiptar**



INTERVISTA

**Nën Dy Flamuj, Një Mision
Rrugëtimi i një emigranti
shqiptar drejt komandës së anijes
luftarake amerikane në epokën e
tensioneve globale**

Faqe 38



EDITORIAL

**Drejtësia që po vihet në
provë: Rasti i ish-krerëve
të UÇK-së dhe pesha e një
vendimi të padrejtë**

ANJEZA MUSOLLARI,
Shefe e Sektorit të Botimeve

Faqe 52

SOCIALE

**Lot në Sallën Evropiane:
Dëshmia e Roman
Oleksiv, fëmija që i
mbijetoi raketës dhe i foli
ndërgjegjes së Evropës**

Faqe 88



Ministri Vengu: Shqipëria hyn në një fazë të re të sigurisë dhe mbrojtjes

Buxheti 2026 ndërton kapacitete reale shtetërore

Ministri i Mbrojtjes, **Pirro Vengu**, deklaroi gjatë një konference për mediat se **Shqipëria po hyn në një fazë të re të politikës së sigurisë dhe mbrojtjes**, në një realitet gjeopolitik ku paqja nuk mund të merret më si e mirëqenë, por kërkon **investime konkrete në kapacitete reale shtetërore**.

Duke iu referuar zhvillimeve të fundit ndërkombëtare dhe rolit të Ballkanit në arkitekturën e sigurisë evropiane, ministri Vengu theksoi se **rajoni përballet me forma të reja kërcënimesh**, ndërsa Shqipëria po përgatit aktualisht edhe **Rishikimin Strategjik të Mbrojtjes**, si një dokument kyç për orientimin afatmesëm dhe afatgjatë të Forcave të Armatosura.

Buxheti 2026 – nga shpenzim në investim strategjik

Ministri i Mbrojtjes vuri në dukje se **Buxheti i Mbrojtjes për vitin 2026 nuk është një buxhet rutinë**, por një instrument strategjik që synon ndërtimin e kapaciteteve reale ushtarake, zhvillimin e industrisë së mbrojtjes dhe forcimin e sovranitetit kombëtar, përfshirë edhe dimensionin dixhital.

"Buxheti i 2026 nuk është një buxhet paqeje romantike. Është një buxhet i përballjes së menaxhuar dhe i sovranitetit kombëtar. Me këtë buxhet, Shqipëria konsolidohet si një aleatë e qëndrueshme dhe e besueshme në NATO", – u shpreh ministri Vengu.

Sipas tij, për herë të parë Shqipëria arrin nivelin 2.12% të Prodhimit të Brendshëm Bruto për mbrojtjen, duke shënuar një rritje prej 12% krahasuar me buxhetin e vitit 2025.

Investim te kapitali njerëzor, themeli i ushtrisë moderne

Një nga shtyllat kryesore të reformës në mbrojtje mbetet **investimi te personeli i Forcave të Armatosura**. Ministri Vengu e cilësoi kapitalin njerëzor si themelin e çdo ushtrie moderne dhe bëri të ditur se **pagat e ushtarakëve do të rriten ndjeshëm në mënyrë progresive**.

"Synimi ynë është që deri në vitin 2029 të arrijmë mesataren e NATO-s. Rritja parashikon 60–70% për pagat



bazë dhe rreth 30% për nivelet e larta të komandimit”, – theksoi ai.

Po ashtu, ministri njoftoi se **komponenti aktiv i Forcave të Armatosura do të rritet me rreth 30%**, duke garantuar më shumë forca profesionale dhe një nivel më të lartë gatishmërie operacionale.

Modernizim dhe rikthim kapacitetesh të munguara

Ministri Vengu nënvizoi se **50% e Buxhetit të Mbrojtjes përbëhet nga investime**, dhe jo shpenzime, duke u fokusuar drejtpërdrejt në modernizimin e kapaciteteve ushtarake.

Sipas tij, Forcat e Armatosura po rikthejnë kapacitete që kanë munguar prej dekadash:

- Rikthim i plotë i gatishmërisë në **Forcën Ajrore** dhe flotën e helikopterëve;
- Rritje e ndjeshme e kapaciteteve dhe e flotës së **Forcës Detare**, përfshirë mjete të reja dhe investime në rinovimin e mjeteve ekzistuese;
- Investime domethënëse në **Forcën Tokësore**, përfshirë sistemet antitank **“Javelin”**;
- Rikthimi i **kapaciteteve kundërajrore** gjatë vitit 2026, pas dekadash mungese.

Industria ushtarake, investim në sovranitet

Një element thelbësor i strategjisë së re të mbrojtjes është **zhvillimi i industrisë ushtarake vendase**. Ministri Vengu theksoi se kjo industri shihet si një investim i drejtpërdrejtë



në sovranitetin teknologjik dhe ekonomik të vendit.

Në lidhje me kompaninë shtetërore **KAYO**, ministri bëri të ditur se ajo ka nisur tashmë aktivitetin prodhues, duke nënshkruar në vitin 2025 **gjashtë marrëveshje shtet-privat**, që përfshijnë prodhimin e:

- armatimit të lehtë,
- municioneve,
- mjeteve të blinduara,
- mjeteve për emergjencat civile,
- uniformave,
- dronëve dhe sistemeve antidron.

Gjithashtu, ai informoi se është në fazë përfundimtare një negociatë e rëndësishme me gjigantin italian **“Fincantieri”** për prodhimin e anijeve në **Pashaliman**.

Sipas ministrit, aktiviteti industrial ka nisur tashmë me linjat e para të prodhimit dhe rekrutimet fillestare: **50 punonjës janë rekrutuar**, ndërsa gjatë këtij viti pritet të punësohen **326 persona**. Këto investime parashikohet të gjenerojnë **3.8 milionë euro të ardhura direkte** dhe rreth **8 milionë euro të ardhura indirekte** për ekonominë.

Shqipëria, rol në rritje në NATO dhe BE

Ministri Vengu theksoi se **Shqipëria po rrit ndjeshëm kontributin e saj në misionet ndërkombëtare**. Gjatë vitit 2025, më shumë se **700 efektivë shqiptarë** kanë qenë të angazhuar në misione të NATO-s dhe BE-së, një kontribut që, sipas tij, do të vijojë të rritet edhe në vitet në vijim.

Në këtë dalje për mediat, ministri i Mbrojtjes Pirro Vengu shoqërohej nga Shefi i Shtabit të Përgjithshëm të Forcave të Armatosura, gjenerallejtënant Arben Kingji, Drejtori i AKMC-së, Haki Çako, si dhe Drejtori i Agjencisë për Industrinë e Mbrojtjes, Dorian Tola.



Shqipëria dhe Belgjika forcojnë partneritetin ushtarak për siguri rajonale

Ministri i Mbrojtjes, **Pirro Vengu**, priti në takim homologun e tij belg, **Theo Francken**, i cili zhvilloi një vizitë zyrtare në kryeqytet.

Gjatë takimit, dy ministrat diskutuan mbi forcimin e mëtejshëm të marrëdhënieve dypalëshe në fushën e mbrojtjes, me fokus të veçantë në stërvitjet e përbashkëta, rritjen e ndërveprimit operacional dhe zhvillimin e bashkëpunimit në industrinë e mbrojtjes. Sipas tyre, këto elemente janë thelbësore për rritjen e kapaciteteve mbrojtëse dhe për forcimin e sigurisë rajonale.

Ministri Vengu vlerësoi partneritetin me Belgjikën dhe rolin e saj si aleate e besueshme në kuadër të NATO-s, duke theksuar rëndësinë e bashkëpunimit me vendet mike dhe aleate: “Kënaqësi të prisja në Tiranë homologun belg Theo Francken, një mik i vyer i vendit tonë. Me Belgjikën po punojmë për të thelluar bashkëpunimin në stërvitje të përbashkëta, ndërveprim operacional dhe industrinë e mbrojtjes, si pjesë e përpjekjes për të rritur kapacitetet tona dhe sigurinë rajonale”, - u shpreh ministri Vengu.

Në këtë takim u ritheksua se **thellimi i partneritetit me aleatët mbetet një prioritet strategjik për Shqipërinë**, në funksion të stabilitetit, sigurisë rajonale dhe perspektivës europiane të vendit.

MINISTRI VENUGU: Konferenca e Mynihut, platformë kyçe për avancimin e partneriteteve strategjike

Ministri i Mbrojtjes, Pirro Vengu, mori pjesë në **Konferencën e Mynihut për Sigurinë**, i cili është një event vjetor mbi politikën ndërkombëtare të sigurisë që mbahet në Gjermani që nga viti 1963. Në këtë konferencë morën pjesë krerë shtetesh, qeverish dhe organizatash ndërkombëtare, ministra, deputetë, përfaqësues të forcave të armatosura, shkencës, shoqërisë civile, biznesit dhe medias.

Munich Security Conference është cilësuar si një nga ngjarjet më të rëndësishme në nivel global, ku mblidhen zërat më me peshë të sigurisë dhe ku formësohet debati strategjik për çështjet kryesore ndërkombëtare.

Sipas ministrit Vengu, për Shqipërinë kjo konferencë përfaqëson një mundësi konkrete për të avancuar marrëdhëniet me partnerët tradicionalë, si dhe për të çelur rrugë të reja bashkëpunimi me aktorë kyç institucionalë dhe drejtues të kompanive të mëdha, në funksion të sigurisë kombëtare dhe zhvillimit të industrisë ushtarake.

“Konferenca e Sigurisë e Mynihut është padyshim një nga ngjarjet kryesore ku mblidhen zërat më me peshë të sigurisë globale dhe ku formësohet debati strategjik. Për Shqipërinë kjo përfaqëson një mundësi konkrete për të avancuar marrëdhëniet me partnerët tradicionalë dhe për të çelur rrugë të reja bashkëpunimi me aktorë kyç institucionalë dhe drejtues të kompanive të mëdha, në funksion të forcimit të sigurisë kombëtare dhe zhvillimit të industrisë ushtarake”, - u shpreh ministri Vengu.



Ministri thekson se në një Evropë që përballlet me një mjedis sigurie gjithnjë e më sfidues, forcimi i partneriteteve dhe koordinimi strategjik mbeten një domosdoshmëri për garantimin e stabilitetit dhe rritjen e kapaciteteve mbrojtëse.

Konferenca e Mynihut për Sigurinë është një event vjetor mbi politikën ndërkombëtare të sigurisë që mbahet në Gjermani që nga viti 1963. Në këtë forum marrin pjesë krerë shtetesh, qeverish dhe organizatash ndërkombëtare, ministra, deputetë, përfaqësues të forcave të armatosura, akademisë, shoqërisë civile, biznesit dhe medias, duke e shndërruar atë në një nga platformat më të rëndësishme globale për dialogun mbi sigurinë dhe mbrojtjen.





BUXHETI I MBROJTJES 2026, “Historik”: Shqipëria Rrit Investimet për Forcat e Armatosura dhe Sigurinë Kombëtare

Ministri i Mbrojtjes, Pirro Vengu, deklaroi para nisjes së seancës plenare se buxheti i Ministrisë së Mbrojtjes për vitin 2026 është “historik”, si për nga përmasat, ashtu edhe për projektet madhore që ai financon. Sipas tij, ky buxhet përbën një hap vendimtar për forcimin e sigurisë kombëtare dhe rritjen e mirëqenies së qytetarëve.

“Sot në Kuvend paraqesim përpara sovranit një buxhet historik, historik nga përmasat dhe historik nga projektet që ai financon. Një buxhet që siguron pensione më të larta, paga më të larta për të gjithë shqiptarët, më shumë zhvillim ekonomik dhe më shumë investime publike. Një buxhet që siguron mirëqenie dhe forcim të shtetit shqiptar”, - u shpreh ministri Vengu.

Buxheti i Mbrojtjes për vitin 2026 arrin në 59 miliardë lekë, duke kapur për herë të parë 2.12% të Prodhimit të Brendshëm Bruto dhe shënon nivelin më të lartë në 35 vitet e fundit. Ministri Vengu theksoi se ky financim garanton vijimin e politikës së rritjes së pagave dhe fuqizimin e kapitalit njerëzor, si dhe afrohet me mesataren e vendeve të NATO-s brenda këtij mandati.

Një pjesë substanciale e buxhetit është dedikuar investimeve madhore në Forcën Ajrore, Forcën Detare, Forcat Speciale dhe Komandën e re Kibernetike, duke rritur ndjeshëm kapacitetet operacionale dhe

luftarake të ushtrisë shqiptare. Ministri vuri në dukje se viti 2026 shënon edhe një rritje të ndjeshme të interesit për t'u bashkuar me Forcat e Armatosura, me 720 rekrutë të rinj.

Me investimet në kampusin e ri të Akademisë së Forcave të Armatosura, shkollën e re të aviacionit dhe qendrën stërvitore në Bunavi, synimi është të vendoset inovacioni në qendër të formimit akademik dhe profesional të brezit të ri të ushtarakëve.

Një vëmendje e veçantë i kushtohet edhe Emergjencave Civile, me projekte për rritjen e kapaciteteve të reagimit dhe ndërtimin e dy qendrave rajonale në Krane dhe Bushat. Po ashtu parashikohet rinovimi i flotës zjarrfikëse përmes prodhimeve të industrisë së ringritur ushtarake “Made in Albania”.

Ministri Vengu e cilësoi industrinë ushtarake vendase si një “motor të ri për ekonominë”, duke theksuar rëndësinë e prodhimit të municioneve, mjeteve të blinduara, dronëve, sistemeve antidron dhe pajisjeve taktike që garantojnë modernizimin afatgjatë të Forcave të Armatosura.

Në përmbyllje të deklaratës, ai e quajti miratimin e këtij buxheti një moment historik për vendin: “Miratimi i këtij buxheti nuk është vetëm një veprim politik, por një akt kombëtar. Përmes tij çelim një kapitull të ri për Forcat e Armatosura, për Emergjencat Civile, për një Shqipëri më të fortë dhe më të sigurt”.



Ministri Vengu: Anëtarësimi i Kosovës në A-5, një nevojë strategjike për sigurinë rajonale

Ministri i Mbrojtjes, Pirro Vengu, mori pjesë në Ministerialin e SHBA - Karta e Adriatikut (A-5), i mbajtur në Sarajevë, një forum i rëndësishëm që bashkon Shtetet e Bashkuara të Amerikës dhe pesë vende të Ballkanit Perëndimor në kuadër të bashkëpunimit rajonal të sigurisë dhe mbrojtjes. Gjatë fjalës së tij pas përfundimit të punimeve të ministerialit, ministri Vengu theksoi se **Ballkani Perëndimor vijon të përballët me sfida të trashëguara dhe kërcënime të reja**, të cilat kërkojnë qasje të koordinuar dhe investime të përbashkëta. "Ballkani Perëndimor ka ende shumë sfida të trashëguara dhe kërcënime të reja, të cilat kërkojnë partneritet më të ngushtë, investime në kapitalin njerëzor, në mbrojtje kibernetike, në industri, në pajisje dhe sisteme të përbashkëta", - deklaroi ministri Vengu.

Ai shtoi se, në bashkëpunim me SHBA-në, Shqipëria beson fort në rëndësinë e kësaj nisme rajonale, e cila duhet të orientohej drejt **bashkëpunimit më efektiv në funksion të rritjes së qëndrueshmërisë së çdo vendi anëtar**.

Në këtë kontekst, ministri Vengu nënvizoi se **anëtarësimi i Kosovës në A-5 përbën një nevojë strategjike**, duke e konsideruar përfshirjen e saj si një hap të domosdoshëm drejt forcimit të stabilitetit rajonal.

Ministri i Mbrojtjes i Shqipërisë rikonfirmoi gjithashtu gatishmërinë e plotë të vendit tonë për të kontribuar

aktivisht në kuadër të të gjitha aktiviteteve dhe objektivave të Kartës së Adriatikut.

Rreth A-5

Iniciativa SHBA - Karta e Adriatikut (A-5) u themelua në vitin 2003 nga SHBA-ja, Shqipëria, Kroacia dhe Maqedonia e Veriut, me qëllimin kryesor **mbështetjen e vendeve të**



rajonit në procesin e integritetit euroatlantik dhe forcimin e bashkëpunimit në fushën e mbrojtjes.

Më 4 dhjetor 2008, iniciativës iu bashkuan edhe **Mali i Zi** dhe **Bosnje-Hercegovina**, duke zgjeruar kështu bashkëpunimin rajonal në këtë platformë të rëndësishme sigurie.



MINISTRI VENUGU

viziton trupat shqiptare në misionin e NATO-s në Bullgari:

Vlerësim për togën shqiptare në Novo Selo

Ministri i Mbrojtjes, z. **Pirro Vengu**, ka vizituar bazën e **Grup Batalionit Shumëkombësh të NATO-s në Novo Selo, Bullgari**, ku shërben edhe një togë e Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë, në kuadër të angazhimeve të vendit tonë në misionet e Aleancës së Atlantikut të Veriut.

Gjatë vizitës në bazë, ministri Vengu u njoh nga afër me kushtet e shërbimit dhe detyrat që kryejnë efektivët shqiptarë, duke vlerësuar profesionalizmin, disiplinën dhe përkushtimin e tyre në përmbushjen e misionit shumëkombësh.

Përmes një postimi në rrjetet sociale, ministri i Mbrojtjes shprehu krenarinë për vlerësimin e dhënë nga komandanti italian i misionit, kolonel Mattia Scirocco, i cili theksoi se toga shqiptare luan një rol aktiv në detyrat e grupit, duke kontribuar përtej misionit të saj të paracaktuar operacional.

Sipas ministrit Vengu, ky vlerësim përbën një dëshmi të qartë të **profesionalizmit, përkushtimit dhe besueshmërisë së efektivëve shqiptarë** në çdo mision ku ata shërbejnë nën flamurin e NATO-s, si dhe të rolit

gjithnjë e më aktiv të Shqipërisë në sigurinë kolektive.

“Në Bazën e Grup Batalionit Shumëkombësh të NATO-s në Novo Selo, Bullgari, isha krenar të dëgjoja nga komandanti italian i misionit se toga që përfaqëson Forcat e Armatosura të Shqipërisë luan një rol aktiv në detyrat e grupit, duke kontribuar përtej misionit të saj të paracaktuar. Kjo është një dëshmi e qartë e profesionalizmit, përkushtimit dhe besueshmërisë së efektivëve tanë në çdo mision ku shërbejnë nën flamurin e Aleancës”, - është shprehur ministri Vengu.

Në vijim, ministri theksoi se Shqipëria mbetet e gatshme të **rrisë më tej prezencën dhe kontributin e saj** në misionet e NATO-s, aty ku nevoja e kërkon, për të dëshmuar angazhimin e palëkundur ndaj sigurisë kolektive dhe për të forcuar përgatitjen operacionale të Forcave të Armatosura, krah për krah me aleatët.

Angazhimi i togës shqiptare në Novo Selo konfirmon edhe një herë rolin aktiv të Shqipërisë si një partner i besueshëm dhe kontribuues në strukturat e Aleancës së Atlantikut të Veriut.



Ministri Vengu inspektoi kompleksin stërvitor Bizë/Pajet, investim strategjik për Forcat e Armatosura

Ministri i Mbrojtjes, **Pirro Vengu**, inspektoi kompleksin stërvitor në **Bizë/Pajet**, një investim strategjik që synon modernizimin dhe fuqizimin e kapaciteteve të trajnimit të Forcave të Armatosura, si dhe zhvillimin e stërvitjeve ndërkombëtare në përputhje me standardet bashkëkohore të **NATO-s**.

Gjatë inspektimit, ministri Vengu u njoh nga afër me infrastrukturën dhe kapacitetet funksionale të kompleksit, i cili përfaqëson një pol të ri modernizimi për përgatitjen operacionale të trupave dhe rritjen e ndërveprimit me partnerët ndërkombëtarë.

Kompleksi stërvitor në Bizë/Pajet ka kapacitet akomodimi deri në **1 200 persona** dhe ofron kushte të plota fjetjeje, ushqimi, ambiente moderne dhe shërbime të tjera thelbësore, duke garantuar mbështetje të plotë logjistike dhe operacionale për zhvillimin e stërvitjeve të zgjatura dhe komplekse.

Ministri Vengu theksoi se ky investim përbën një element kyç për rritjen e gatishmërisë së Forcave të Armatosura dhe për forcimin e bashkëpunimit me aleatët dhe partnerët strategjikë, duke e pozicionuar Shqipërinë si një faktor aktiv dhe të besueshëm në arkitekturën e sigurisë rajonale dhe ndërkombëtare.

Ky kompleks stërvitor do të jetë funksional për stërvitjen kryesore të Forcave të Armatosura që pritet të zhvillohet në muajin **shtator**, për certifikimin e **Grup Batalionit të Këmbësorisë së Lehtë** sipas standardeve të NATO-s, si dhe për stërvitje dypalëshe dhe shumëkombëshe, përfshirë **“Defender Europe 2027”**.





SIGURI DHE TRANSPARENCË: Projektligji për armët merr dritën jeshile në Parlament

Pas një seance maratonë, Kuvendi i Shqipërisë miratoi me 84 vota pro, 10 kundër dhe pa asnjë abstenim projektligjin “Për importin, eksportin dhe tranzitin e armëve të zjarrit, të komponentëve të tyre kryesorë dhe të municioneve”.

Nisma ligjore synon forcimin e kuadrit rregullator të Industrisë së Mbrojtjes dhe rritjen e kontrollit mbi mallrat me përdorim të dyfishtë, civil dhe ushtarak.

Gjatë prezantimit në seancën plenare, ministri i Mbrojtjes, Pirro Vengu, theksoi se projektligji është pjesë e një pakete më të gjerë reformash ligjore:

“Përmes mekanizmave të parashikuar synojmë të garantojmë integritetin e të gjithë zinxhirit: nga prodhimi, tregtimi, eksporti e deri te tranziti i armëve të zjarrit, duke rritur sigurinë, transparencën dhe bashkëveprimin e institucioneve ligjzbatuese”, - deklaroi ministri Vengu.

Sipas ministrit, ligji është tërësisht i ri dhe transponon plotësisht rregulloren e Bashkimit Evropian, duke e vendosur Shqipërinë në të njëjtin standard ligjor me vendet anëtare në një fushë kyçe për sigurinë publike dhe kombëtare. Ai nënvizoi se projektligji forcon mekanizmin e kontrollit shtetëror pa krijuar institucione të reja, duke u mbështetur në përvojën 17-vjeçare të Autoritetit Shtetëror të Kontrollit të Eksporteve.

Një nga risitë kryesore është krijimi i një mekanizmi elektronik licencimi, të sigurt dhe të enkriptuar, që pritet të rrisë mbrojtjen e të dhënave dhe efikasitetin e autorizimeve. Ligji parashikon gjithashtu rritjen e bashkëpunimit mes agjencive ligjzbatuese dhe ngritjen e një baze

të dhënash unike ndërinstitucionale, duke mundësuar gjurmueshmëri të avancuar për çdo armë zjarri, si dhe kontrole para dhe pas dërgesës.

Ministri Vengu theksoi se projektligji nuk sjell kosto shtesë për buxhetin e shtetit dhe do të zbatohet nga kapacitetet ekzistuese institucionale:

“Projektligji është pjesë e piketave ndërmjetëse në procesin e negociatave me Bashkimin Evropian dhe përfaqëson një hap të matshëm drejt përmbytjes së tyre”, - shtoi ministri, duke falënderuar komisionet parlamentare që e mbështetën nismën në frymë konsensuale.

Me këtë projektligj, Shqipëria forcon një hap kyç në rritjen e sigurisë kombëtare dhe modernizimin e kuadrit ligjor në fushën e armëve të zjarrit dhe mallrave me përdorim të dyfishtë.





INSTITUCIONET RRISIN GATISHMËRINË për emergjencat dimërore, ministri Vengu: Investim historik për sigurinë e çdo familjeje

Ministri i Mbrojtjes, Pirro Vengu, ministrja e Punëve të Brendshme, Albana Koçiu, ministri i Shtetit për Pushtetin Vendor, Ervin Demo, si dhe prefektët e 12 qarqeve, drejtues të AKMC-së, Policisë së Shtetit dhe Shërbimit Zjarrfikës zhvilluan sot një takim pune të dedikuar masave paraprake për menaxhimin e emergjencave civile gjatë sezonit të dimrit. Takimi vjen pas reshjeve intensive dhe përmbytjeve të lokalizuara të ditëve të fundit, ku falë reagimit të shpejtë të strukturave të Emergjencave Civile, dëmet u minimizuan dhe situata u menaxhua me efikasitet. Gjatë fjalës së saj, ministrja Koçiu theksoi rëndësinë e gatishmërisë së plotë institucionale dhe koordinimit në çdo nivel të territorit. Ajo veçoi rolin qendror të prefektëve në menaxhimin e situatës në qark, duke kërkuar inventarizim të shpejtë e të plotë të dëmeve, raportim të menjëhershëm për çdo problem dhe rishikim urgjent të planeve të emergjencës sipas realitetit të terrenit. “Në menaxhimin e emergjencave nuk ka ‘detaje të vogla’. Suksemi varet nga informacioni i saktë, koordinimi i pandërprerë dhe reagimi i shpejtë në terren” - tha Koçiu, duke theksuar gatishmërinë e strukturave të Policisë së Shtetit, Shërbimit Zjarrfikës dhe ekipeve të Mbrojtjes Civile. Ajo nënvizoi angazhimin e Ministrisë së Brendshme

për forcimin e rolit të prefektëve, rritjen e transparencës dhe performancës në nivel qarku, si dhe përmirësimin e bashkëpunimit ndërinstitucional. “Na duhet punë, përgjegjësi dhe bashkëpunim. Ne jemi gati. Dhe të gjithë duhet të jemi gati”, - përfundoi ministria.

Ministri i Mbrojtjes, Pirro Vengu, në fjalën e tij theksoi se projektbuxheti i vitit 2026 për Mbrojtjen Civile dhe Shërbimin Zjarrfikës është “më i madhi ndonjëherë”, duke e cilësuar atë një investim të drejtpërdrejtë për sigurinë e çdo familjeje në çdo bashki të vendit. “Rrisim mbështetjen për njësitë vendore. Rinovojmë flotën kombëtare. Zgjerojmë financimin për infrastrukturën parandaluese në zonat me risk, duke përfshirë urat, digat dhe pritrat lumore”, - u shpreh Vengu.

Ai theksoi se sfidat e emergjencave kërkojnë bashkërendim të plotë dhe funksional të të gjitha hallkave të qeverisjes, nga niveli qendror te ai vendor. “Vetëm kështu sigurojmë vlerësim të saktë të dëmeve, vendimarrje të shpejtë dhe mbështetje pa vonesa për qytetarët”, - tha ministri.

Takimi përmbylli angazhimin e institucioneve për të hyrë në sezonin dimëror me koordinim të forcuar, kapacitete të rritura dhe përgjegjësi të përbashkët për mbrojtjen e komuniteteve.



KORRIDORI 8 SHPALLET KORRIDOR SIGURIE I NATO-S, Shqipëria në zemër të planeve strategjike të Aleancës

Ministrat e Mbrojtjes të vendeve anëtare të NATO-s, u mbledhën në Bruksel në një ministerial të rëndësishëm, ku në fokus ishte përshtatja e planeve të Aleancës me realitetin e ri të sigurisë në Evropë dhe më gjerë. Takimi vjen në një kohë sfidash të shumta gjeopolitike, rritjeje të investimeve në mbrojtje dhe rishikimi të kapaciteteve ushtarake në funksion të mbrojtjes kolektive.

Në këtë ministerial mori pjesë edhe ministri i Mbrojtjes së Shqipërisë, Pirro Vengu, i cili bëri të ditur një zhvillim me rëndësi strategjike për vendin: përfshirjen zyrtare të Korridorit 8 në planet dhe infrastrukturën kritike ushtarake të Aleancës.

Korridori 8, tashmë korridor sigurie i Aleancës

Sipas ministrit Vengu, Korridori 8 me pikënisje në kompleksin portual Durrës–Porto Romano dhe dalje në Detin e Zi është njohur si korridor sigurie për mbrojtjen kolektive. Ky vendim e vendos Shqipërinë në një pozicion kyç në arkitekturën euroatlantike të sigurisë, duke e kthyer vendin në një nyje strategjike të transportit, logjistikës dhe lëvizjes së forcave në rast nevojë.

“Kjo është një arritje konkrete, që e pozicionon Shqipërinë në zemrën e të gjitha planeve rajonale dhe në zemrën e infrastrukturave, ku Aleanca do të përqendrohet në vitet në vijim”, - theksoi Vengu, duke e cilësuar procesin si rezultat të një pune të disiplinuar dhe të qëndrueshme disa vjeçare.

Edhe kryeministri Edi Rama reagoi lidhur me këtë zhvillim, duke theksuar se njohja e Korridorit 8 si korridor sigurie “forcon ndjeshëm sigurinë rajonale” dhe rrit rolin

e Shqipërisë në strukturat e Aleancës.

Rritja e rolit të Shqipërisë në misionin KFOR

Në fokus të diskutimeve ishte edhe e ardhmja e operacioneve ku Shqipëria kontribuon, veçanërisht misioni i KFOR-it në Kosovë. Ministri Vengu bëri të ditur se Shqipëria do të rrisë kapacitetet dhe përfshirjen e saj në këtë mision, duke u angazhuar për herë të parë edhe me Forcën Ajrore.

Ky hap konsiderohet një rritje cilësore e kontributit shqiptar në sigurinë rajonale, në një moment kur stabiliteti në Kosovë dhe në rajon mbetet prioritet për Aleancën. Sipas ministrit, në partneritet të ngushtë me Shtetet e Bashkuara dhe Komandën Amerikane në Evropë po bëhen rivlerësime të nevojshme për të ardhmen e misionit, duke krijuar gjithashtu një mundësi për qeverinë e re në Kosovë që të thellojë bashkëpunimin me NATO-n.


Investimet në mbrojtje dhe industria ushtarake

Një tjetër temë qendrore e ministerialit ishte rritja e investimeve në mbrojtje dhe ristrukturimi i industrisë ushtarake në vendet aleate. Në kushtet e një mjedisi sigurie gjithnjë e më kompleks, vendet anëtare po rishikojnë strategjitë e tyre për prodhimin dhe furnizimin me pajisje ushtarake, me synim rritjen e kapaciteteve dhe autonomisë strategjike.

Ministri Vengu theksoi se Shqipëria e ka nisur me vendosmëri këtë proces, duke krijuar kapacitete të reja në industrinë e mbrojtjes, me disa kontrata të lidhura dhe të tjera në proces negociimi. Sipas tij, këto zhvillime janë



mirëpritur nga aleatët, si pjesë e përpjekjeve për të forcuar kontributin e çdo vendi në kuadër të mbrojtjes kolektive.



Korridori 8 me pikënisje në kompleksin portual Durrës-Porto Romano dhe dalje në Detin e Zi është njohur si korridor sigurie për mbrojtjen kolektive. Ky vendim e vendos Shqipërinë në një pozicion kyç në arkitekturën euroatlantike të sigurisë, duke e kthyer vendin në një nyje strategjike të transportit, logjistikës dhe lëvizjes së forcave në rast nevojë.



Përgatitjet për Samitin e NATO-s në Tiranë 2027

Në kuadër të angazhimeve të ardhshme, ministri bëri të ditur se kanë nisur përgatitjet për Samitin e NATO-s, që do të mbahet në Tiranë në vitin 2027. Skuadrat shqiptare, në bashkëpunim me kolegët turq dhe Sekretariatit e Aleancës në Bruksel, kanë filluar punën për organizimin e këtij event të rëndësishëm diplomatik dhe strategjik.

Mbajtja e Samitit në Tiranë pritet të jetë një moment historik për Shqipërinë, duke reflektuar rolin në rritje të vendit brenda NATO-s dhe besimin e Aleancës në kontributin shqiptar për sigurinë euroatlantike.

Një pozicionim i ri strategjik për Shqipërinë

Përfshirja e Korridorit 8 në infrastrukturën kritike të NATO-s, rritja e kontributit në KFOR, zhvillimi i industrisë ushtarake dhe organizimi i Samitit të vitit 2027 përbëjnë një paketë zhvillimesh që e vendosin Shqipërinë në një fazë të re të angazhimit të saj në Aleancë.

Ministeriali i Brukselit konfirmoi se në një mjedis të ri sigurie, ku sfidat janë të shumëfishta dhe të ndërthurura, roli i vendeve anëtare përfshirë Shqipërinë po bëhet gjithnjë e më i rëndësishëm në garantimin e stabilitetit dhe mbrojtjes kolektive.





EFEKTIVËT E FORCËS TOKËSORE

rrisin kapacitetet luftarake me sistemin "Javelin"

Në Shkollën e Trupës së Forcës Tokësore po zhvillohet për herë të parë një kurs trajnimi për përdorimin e sistemit raketor kundërtank "Javelin", një nga sistemet më të avancuara të mbrojtjes tokësore që përdoret nga vendet anëtare të NATO-s dhe tashmë pjesë e inventarit të **Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë**.

Trajnimi po realizohet me efektivë të **Batalionit të Këmbëtorisë së Lehtë**, të cilët po përgatiten në përdorimin operacional të këtij sistemi modern, duke u fokusuar në procedurat e përdorimit, targetimit dhe zbatimit të skenarëve realë luftarakë.

Nënkolonel **Jorid Aliaj**, komandant i Shkollës së Trupës në Forcën Tokësore, theksoi se ky kurs përfaqëson një hap të rëndësishëm në rritjen e nivelit profesional të efektivëve dhe në përshtatjen e tyre me armët e gjeneratës së fundit.

"Në Shkollën e Trupës të Forcës Tokësore, për herë të parë po zhvillojmë një kurs trajnimi me personelin e Batalionit të Këmbëtorisë së Lehtë për përdorimin e sistemit kundërtank 'Javelin'. Ky sistem ka ardhur së fundmi në Forcën Tokësore dhe personeli po trajnohet në procedurat e përdorimit, targetimit dhe aplikimin e skenarëve realë, nën asistencën e instruktorëve tanë", - u shpreh nënkolonel Aliaj.

Sipas tij, përdorimi i sistemit "Javelin" rrit ndjeshëm aftësinë e operatorëve për të marrë vendime të sakta dhe në kohë reale, duke përmirësuar

ndjeshëm efikasitetin operacional të njësive tokësore.

"Trajnerët e Shkollës së Trupës janë këtu për të asistuar personelin në kuptimin e të dhënave taktiko-teknike të sistemit, me qëllim që operatorët të jenë sa më të familjarizuar dhe ta përdorin armën në mënyrë sa më efikase", - shtoi ai.

Komandanti i Shkollës së Trupës theksoi gjithashtu se ky trajnim nuk zëvendëson stërvitjen në terren, por shërben si një plotësim i domosdoshëm i saj, duke krijuar kushte sa më afër realitetit operacional.

"Në këtë trajnim replikohen situata të ndryshme që hasen në operacione reale, në të gjitha llojet e terreneve, përfshirë edhe angazhimin ndaj objektivave ajrore që fluturojnë në lartësi të ulëta. Objektivi ynë është të kemi një trupë maksimalisht të përgatitur profesionalisht dhe të rrisim aftësinë goditëse të Forcave tona", - theksoi nënkolonel Aliaj.

Sistemi raketor kundërtank "**Javelin**" konsiderohet një element kyç në mbrojtjen tokësore moderne, duke rritur ndjeshëm aftësinë e Forcës Tokësore për të përballuar kërcënime të avancuara dhe për të vepruar në përputhje me standardet dhe doktrinën e Aleancës së Atlantikut të Veriut.

Ky trajnim dhe pajisja me sisteme të tilla moderne janë pjesë e **strategjisë afatgjatë të modernizimit të Forcave të Armatosura**, rritjes së kapaciteteve parandaluese dhe përafrimit të plotë me strukturat dhe aftësitë e NATO-s.



FORCAT E ARMATOSURA

marrin pjesë në stërvitjen ndërkombëtare “Cyber Unity 2026”

Në ambientet e Agjencisë së Mbështetjes dhe Prokurimit të NATO-s (NSPA), u zhvillua stërvitja ndërkombëtare “Cyber Unity 2026”, e organizuar nga Komanda Evropiane e Shteteve të Bashkuara (USEUCOM), me mbështetjen e Luksemburgut.

Në këtë stërvitje morën pjesë përfaqësues nga **Komanda Kibernetike dhe Ndërlidhjes** e Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë, të cilët u angazhuan në skenarë realistë për reagimin, menaxhimin dhe përballimin e incidenteve kibernetike.

Gjatë zhvillimit të stërvitjes, pjesëmarrësit testuan dhe përmirësuan procedurat operacionale, duke forcuar



aftësitë profesionale dhe ndërveprimin me strukturat partnere ndërkombëtare, në përputhje me standardet dhe doktrinën e Aleancës së Atlantikut të Veriut.

Stërvitja “**Cyber Unity 2026**” përbën një element të rëndësishëm në rritjen e **sigurisë kibernetike**, duke kontribuar në forcimin e kapaciteteve mbrojtëse dhe në thellimin e bashkëpunimit me strukturat e **NATO-s** dhe partnerët strategjikë.

Pjesëmarrja në këtë aktivitet ndërkombëtar konfirmon angazhimin e Forcave të Armatosura Shqiptare për të qenë pjesë aktive e përpjekjeve të përbashkëta në fushën e mbrojtjes kibernetike dhe sigurisë kolektive.





TIRANË, U MBAJT MINISTERIALI I KORRIDORIT VIII

Zëvendësministria Abrazhda thekson rëndësinë strategjike për sigurinë rajonale

Në Tiranë u zhvillua Ministeriali i Korridorit VIII, një takim i nivelit të lartë që mbledhi përfaqësues të vendeve të rajonit dhe partnerë institucionalë për të diskutuar mbi përparimin dhe koordinimin e projekteve që lidhen me këtë korridor strategjik. Në këtë aktivitet mori pjesë edhe zëvendësministria e Mbrojtjes, Blerina Abrazhda, e cila theksoi se Korridori VIII përbën jo vetëm një projekt të rëndësishëm infrastrukturor dhe ekonomik, por edhe një komponent kyç në arkitekturën e sigurisë rajonale. Sipas saj, zhvillimi i infrastrukturës moderne rrugore, hekurudhore dhe portuale përgjatë këtij korridori forcon

ndërlidhjen strategjike mes vendeve të rajonit, rrit ndërveprueshmërinë dhe kontribuon drejtpërdrejt në mobilitetin ushtarak, në përputhje me standardet e NATO-s dhe Bashkimit Evropian.

Korridori VIII, që lidh Detin Adriatik me Detin e Zi përmes Shqipërisë, Maqedonisë së Veriut dhe Bullgarisë, konsiderohet një nga projektet më të rëndësishme për integrimin ekonomik dhe sigurinë kolektive në Evropën Juglindore.

Gjatë ministerialit, pjesëmarrësit diskutuan mbi sfidat aktuale të sigurisë në rajon, nevojën për koordinim më të ngushtë ndër-institucional, si dhe përsheptimin e investimeve strategjike që mbështesin zhvillimin e qëndrueshëm dhe rrisin kapacitetet mbrojtëse.

Zëvendësministria Abrazhda nënvizoi se në një mjedis sigurie gjithnjë e më kompleks, bashkëpunimi rajonal dhe projektet e përbashkëta infrastrukturore janë elementë thelbësorë për stabilitetin, zhvillimin dhe rritjen e reziliencës kombëtare.

Ministeriali i Korridorit VIII në Tiranë konfirmoi angazhimin e vendeve pjesëmarrëse për të avancuar këtë projekt strategjik, duke e konsideruar atë si një investim afatgjatë në sigurinë dhe prosperitetin e rajonit.





GJENERALLEJTËNANT ARBEN KINGJI

merr pjesë në Takimin e 13-të të

Konferencës së Shefave të Shtabit të

Përgjithshëm të nismës “DECI” në Budapest

Budapest, Hungari – Shefi i Shtabit të Përgjithshëm të Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë (FARSH), gjenerallejtënant Arben Kingji, mori pjesë në Takimin e 13-të të Konferencës së Shefave të Shtabit të vendeve pjesëmarrëse në nismën “DECI” (Defense Cooperation Initiative). Konferenca u zhvillua në Budapest, nën drejtimin e gjeneral Gabor Borondi, shef i Shtabit të Përgjithshëm të Forcave të Armatosura të Hungarisë, dhe gjeneral Luciano Portolano, shef i Shtabit të Përgjithshëm të Forcave të Armatosura të Italisë.

Punimet e konferencës u fokusuan në analizën e dinamikave të reja të sigurisë rajonale dhe globale, të cilat karakterizohen nga sfida të ndërlikuara, kërcënime hibride dhe rreziqe në rritje. Diskutimet synuan forcimin e bashkëpunimit, identifikimin e zgjidhjeve të përbashkëta dhe përmirësimin e mekanizmave të reagimit, për të shmangur që sfidat e sotme të kthehen në kërcënime të nesërme. Në fjalën e tij, gjenerallejtënant Kingji theksoi se nisma “DECI” mbetet një platformë thelbësore për shkëmbimin e ideve, praktikave më të mira dhe forcimin e bashkëpunimit mes vendeve pjesëmarrëse. Ai shprehu mirënjohjen për përfaqësuesit e Gardave Kombëtare të Shteteve të Bashkuara të Amerikës për angazhimin e tyre afatgjatë në mbështetje të kësaj nisme.

“Shqipëria mbetet plotësisht e angazhuar në rritjen e bashkëpunimit, qëndrueshmërisë dhe prosperitetit rajonal. Ne jemi të vendosur të mbështesim çdo nismë që forcon sigurinë kolektive dhe aftësinë për menaxhimin e krizave, si me vendet aleate të NATO-s, ashtu edhe me partnerët tanë rajonalë”, – u shpreh gjenerallejtënant Kingji, duke theksuar gjithashtu se Shqipëria po vijon me vendosmëri përmirësimin e objektivave të integritetit në Bashkimin Europian. Gjatë punimeve u nënvizua rëndësia e vazhdimin e angazhimeve në kuadër të nismës “DECI”, e cila synon rritjen e ndërveprueshmërisë, bashkëpunimit dhe forcimin e sigurisë së përbashkët ndërmjet vendeve pjesëmarrëse.



Gjenerallejtënant Kingji falënderoi në mënyrë të posaçme shefin e Shtabit të Përgjithshëm të Forcave të Armatosura të Italisë, gjeneral Portolano, si dhe shtetin italian, për rolin udhëheqës dhe mbështetës në avancimin e objektivave të kësaj nisme.

Në përfundim të takimit, shefat e Shtabeve të Forcave të Armatosura të Italisë, Hungarisë, Kroacisë, Maqedonisë së Veriut, Malit të Zi, Sllovenisë dhe Austrisë nënshkruan “Deklaratën e Përbashkët”, duke rikonfirmuar angazhimin e tyre për forcimin e bashkëpunimit dhe sigurisë rajonale në kuadër të nismës “DECI”.

Shqipëria, pritëse e konferencës së ardhshme

U bë e ditur se **vitin e ardhshëm Shqipëria do të presë Konferencën e Shefave të Shtabeve të vendeve pjesëmarrëse të nismës “DECI”**, një forum shumëpalësh i rëndësishëm për forcimin e bashkëpunimit, koordinimit dhe ndërveprimit ushtarak mes vendeve aleate dhe partnere.

Forcat e Armatosura thellojnë bashkëpunimin me Italinë në fushën e mjeteve ajrore pa pilot (UAV)

Vijon bashkëpunimi i Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë me palën italiane edhe në fushën e mjeteve ajrore pa pilot (UAV), në kuadër të forcimit të kapaciteteve operacionale dhe rritjes së nivelit të profesionalizmit të personelit. Në këtë kuadër, një delegacion i Forcave të Armatosura shqiptare, i kryesuar nga kolonel Sulo Mustafaraj dhe nënkolonel Eljo Buçka, zhvilloi një vizitë pune në Qendrën e Ekselencës për Mjetet Ajrore të Komanduara në Distançë të Forcave të Armatosura italiane. Gjatë takimeve dhe prezantimeve të realizuara, fokusi kryesor ishte shkëmbimi i përvojave dhe njohurive profesionale, si dhe njohja me praktikat më të avancuara të trajnimit dhe përdorimit të sistemeve UAV. Palët diskutuan mbi standardet bashkëkohore të trajnimit, procedurat operative dhe mundësitë për përfshirjen e personelit shqiptar në programe të specializuara trajnuese në këtë fushë. Bashkëpunimi



me Italinë në këtë sektor strategjik vlerësohet si një hap i rëndësishëm në procesin e modernizimit të Forcave të Armatosura dhe në përafrimin e mëtijshëm me standardet e NATO-s, duke rritur aftësitë për vëzhgim, zbulim dhe mbështetje operacionale. Forcat e Armatosura të Republikës së Shqipërisë mbeten të angazhuara në forcimin e partneriteteve strategjike me vendet aleate, në funksion të garantimit të sigurisë kombëtare dhe rritjes së ndërveprueshmërisë në misione të përbashkëta.

SHSHPFA, gjenerallejtënant Arben Kingji mori pjesë në takimin e Komitetit Ushtarak të NATO-s

Shefi i Shtabit të Përgjithshëm të Forcave të Armatosura, **gjenerallejtënant Arben Kingji**, mori pjesë në ditën e parë të takimit të **Komitetit Ushtarak të Shefave të Shtabeve të vendeve anëtare të NATO-s**, ku u zhvilluan diskutime të rëndësishme mbi mbrojtjen kolektive dhe sfidat aktuale të sigurisë.

Gjatë punimeve, vëmendja u përqendrua në vlerësimin e mjedisit të sigurisë, rritjen e aftësive ushtarake dhe luftarake, si dhe nevojën për **inovacion dhe përshtatje të shpejtë** për t'u përballur me sfidat e së ardhmes.

Në diskutime u theksua rëndësia e **gatishmërisë operacionale**, përmirësimit të **ndërveprueshmërisë ndërmjet forcave aleate dhe partnere**, si dhe menaxhimit proaktiv të rreziqeve, si elementë kyç për garantimin e sigurisë kolektive.

Gjenerallejtënant Kingji vlerësoi kohezionin e Aleancës së Atlantikut të Veriut, duke ritheksuar se **uniteti dhe**



solidariteti ndërmjet vendeve anëtare të NATO-s mbeten garanci për sigurinë e përbashkët, në një mjedis të karakterizuar nga sfida gjithnjë e më komplekse. Takimi i Komitetit Ushtarak të NATO-s përbën një forum të rëndësishëm strategjik për koordinimin e qëndrimeve dhe forcimin e rolit të Aleancës në ruajtjen e paqes dhe stabilitetit euroatlantik.





Takim trepalësh në Shkodër: Intensifikohet bashkëpunimi ushtarak Shqipëri-Kroaci-Kosovë

Shefi i Shtabit të Përgjithshëm të Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë, gjeneralletënant Arben Kingji, priti në qytetin e Shkodrës takim trepalësh në nivel të Shefave të Shtabeve të Përgjithshëm, me pjesëmarrjen e gjeneralletënant Tihomir Kundid, Shef i Shtabit të Përgjithshëm të Republikës së Kroacisë, si dhe gjeneralletënant Bashkim Jashari, Komandant i Forcës së Sigurisë së Kosovës.

Takimi u zhvillua në kuadër të forcimit të bashkëpunimit rajonal dhe adresimit të sfidave të reja të sigurisë, në një mjedis strategjik gjithnjë e më kompleks. Bashkëpunimi ushtarak ndërmjet tre vendeve konsiderohet i konsoliduar dhe përfshin fusha si stërvitjet, trajnimet, operacionet dhe pjesëmarrjen në iniciativa rajonale.

Në fokus të diskutimeve ishte nevoja për intensifikimin e këtij bashkëpunimi përballë kërcënimeve hibride në rritje dhe rreziqeve të tjera që mund të cenojnë stabilitetin rajonal, evropian dhe ndërkombëtar. Në këtë kuadër, u theksua domosdoshmëria e gjenerimit dhe shfrytëzimit të sinergjive ndërmjet forcave të armatosura të tre vendeve. Qëllimi i takimit trepalësh ishte identifikimi i fushave konkrete të bashkëpunimit që përmirësojnë ndërveprueshmërinë dhe gatishmërinë operacionale. Pjesë e diskutimeve ishte edhe vendosja e mekanizmave praktikë për koordinim dhe zhvillimin e stërvitjeve të përbashkëta, të cilat ndikojnë drejtpërdrejt në rritjen e efektivitetit operacional.

Një tjetër prioritet i rëndësishëm ishte zhvillimi i



kapaciteteve ushtarake në përputhje me Konceptin Strategjik të NATO-s, angazhimet që rrjedhin nga Samiti i Hagës 2025 dhe Busulla Strategjike e Bashkimit Evropian. Kjo nënkupton implementimin e planeve dhe projekteve që përforcojnë aftësitë operacionale dhe përgatitjen për misione të përbashkëta në kuadër të Aleancës dhe iniciativave evropiane të sigurisë.

Në përfundim të takimit, Shefat e Shtabeve të Forcave të Armatosura të Shqipërisë dhe Kroacisë, si dhe Komandanti i Forcës së Sigurisë së Kosovës, ranë dakord për vijimin e bashkëpunimit dhe zhvillimin e stërvitjeve trelaterale konkrete gjatë vitit 2026 dhe në vijimësi, si një hap i rëndësishëm drejt forcimit të sigurisë dhe stabilitetit në rajon.

SHSHP, gjeneralëjtënant Arben Kingji përcakton prioritetet e Forcave të Armatosura për vitin 2026: Fokus te kapitali njerëzor, modernizimi dhe gatishmëria operationale

Shefi i Shtabit të Përgjithshëm të Forcave të Armatosura, gjeneralëjtënant **Arben Kingji**, zhvilloi takimin e tij të parë për vitin 2026 me komandantët e forcave dhe njësitë, drejtorët në Shtabin e Përgjithshëm, si dhe komandantët e njësitë autonome.

Gjatë këtij takimi të rëndësishëm vjetor, gjeneralëjtënant Kingji shprehu mirënjohjen për punën, përkushtimin dhe angazhimin e të gjithë personelit të Forcave të Armatosura, duke vlerësuar përmbushjen me sukses të detyrave, objektivave dhe angazhimeve kombëtare dhe ndërkombëtare gjatë vitit 2025.

ARRITJET KRYESORE TË VITIT 2025

Në fokus të takimit ishin arritjet kryesore të vitit që lamë pas, ku u veçuan disa procese dhe zhvillime me rëndësi strategjike për Forcat e Armatosura të Republikës së Shqipërisë.

Një ndër arritjet kryesore ishte **miratimi i Strukturës së re të FARSH-së**, e cila synon rritjen e efektivitetit dhe përshtatjen me sfidat bashkëkohore të sigurisë. Kjo strukturë përfshin krijimin e **Komandës Kibernetike dhe të Ndërlidhjes**, riorganizimin e **Akademisë së Forcave të Armatosura** dhe **Kolegjit të Mbrojtjes dhe Sigurisë**, kalimin e **Shkollave të Trupës** në varësi të Komandës së Forcës Tokësore, si dhe kalimin e **Regjimentit të Operacioneve Speciale** në varësinë e Shtabit të Përgjithshëm.

Gjithashtu, u vlerësua **përmirësimi i ndjeshëm i bazës ligjore për trajtimin e personelit**, i cili ka dhënë efekte konkrete në rekrutim, mbajtjen e personelit dhe rritjen e motivimit.

Në këtë kuadër, gjatë vitit 2025 u miratuan disa akte të rëndësishme ligjore dhe nënligjore, ndër to:

- Ligji nr. 54/2025, për ndryshime dhe shtesa në ligjin “Për pushtetet dhe autoritetet e drejtimit dhe komandimit të Forcave të Armatosura”;
- VKM nr. 292/2025, për procedurat e rikthimit të ushtarakëve në shërbimin aktiv;
- VKM nr. 663/2025, për kriteret e pranimit dhe



gradimit të ushtarakëve rezervistë;

- VKM nr. 728/2025, për kriteret e dhënies së medaljes së shërbimit ushtarak.

STËRVITJE, MISIONE DHE MODERNIZIM

Gjatë takimit u theksua gjithashtu zhvillimi me sukses i **stërvitjeve kombëtare, bilaterale dhe në kuadër të NATO-s**, të cilat synuan rritjen e ndërveprueshmërisë dhe testimin e kapaciteteve operationale në të gjithë komponentët e Forcave të Armatosura.

Një vëmendje e veçantë iu kushtua edhe **aktivizimit dhe dislokimit të rezervave operationale** në kuadër të misioneve ndërkombëtare **KFOR** dhe **EUFOR**, si dhe vijimit të projekteve të modernizimit, të orientuara drejt rritjes së kapaciteteve operationale dhe përmirësimit të infrastrukturës stërvitore dhe akomoduese.

OBJEKTIVAT PËR VITIN 2026

Në përfundim të takimit, gjeneralëjtënant Kingji theksoi se **fokusi kryesor për vitin 2026** do të jetë zhvillimi i kapitalit njerëzor, përmes konsolidimit të mëtejshëm të arsimit ushtarak, kualifikimit dhe trajnimit të personelit. Paralelisht, do të vijojë puna për përmirësimin e mëtejshëm të bazës ligjore, ku një vëmendje e veçantë do t'i kushtohet **miratimit të “Statusit të Ushtarakut”**, si dhe fillimit të zbatimit të ligjit për **komponentin rezervist**.

Në kuadër të stërvitjeve, u bë e ditur se në **shtator 2026**, **Grup-Batalioni i Këmbësorisë së Lehtë** do të zhvillojë stërvitjen vlerësuese nga NATO për certifikimin **“CREVAL”**. Forcat e Armatosura do të vijnë në procesin e modernizimit, me fokus rritjen e kapaciteteve operationale, të mbështetur edhe nga **revitalizimi dhe zhvillimi i Industrisë së Mbrojtjes**.

Në mbyllje, Shefi i Shtabit të Përgjithshëm kërkoi nga të gjithë drejtuesit **angazhim maksimal, bashkëpunim të ngushtë dhe përgjegjshmëri të shtuar**, në përmbushjen e misionit kushtetues të Forcave të Armatosura, duke garantuar gatishmëri të plotë operationale në të gjitha detyrat që do t'u ngarkohen.



Kundëradmiral Arsen Mullaj merr detyrën e komandantit të Forcës Detare, ministri Vengu: Modernizimi, prioritet strategjik i qeverisë

Në një ceremoni të posaçme ushtarake, **kundëradmiral Arsen Mullaj** mori zyrtarisht detyrën e komandantit të **Forcës Detare**, pas dekretimit nga Presidenti i Republikës. Ai zëvendëson në këtë funksion **nënadmiral Adnan Agastra**, i cili përfundoi mandatin e tij në krye të Forcës Detare.

Në fjalën e tij, ministri i Mbrojtjes, **Pirro Vengu**, theksoi se zhvillimi dhe modernizimi i Forcës Detare përbën një përparësi strategjike të qeverisë shqiptare, e artikuluar vazhdimisht edhe nga Kryeministri, duke pasur në themel rikthimin e vendit në horizontin e tij detar dhe adriatiko-jonian.

“Kjo nuk mund të ndodhë pa mjete, pa anije, pa luftanije dhe pa anije logjistike. Për këtë arsye, qeveria shqiptare ka angazhuar jo vetëm financimin e nevojshëm, por edhe kuadrin e duhur ligjor për ringritjen e Pashalimanit si një kantier strategjik, jo vetëm në dobi të forcave tona, por edhe të forcave aleate”, – u shpreh ministri Vengu.

Ministri i Mbrojtjes nënvizoi se ringritja e **Bazës Detare të Pashalimanit** dhe investimet në kapacitetet detare janë pjesë e një vizioni afatgjatë për ndërtimin e një force detare moderne, profesionale dhe plotësisht të integruar në **Aleancën e Atlantikut të Veriut (NATO)**.

Në përfundim të ceremonisë, ministri Vengu i uroi suksese komandantit të ri, personelit të Forcës Detare dhe familjeve të tyre, duke theksuar synimin për ndërtimin e një force detare të aftë për mbrojtjen e interesave kombëtare, garantimin e sigurisë detare dhe rritjen e rolit të Shqipërisë në arkitekturën e sigurisë rajonale dhe ndërkombëtare.



Forca Tokësore me drejtim të ri: Vazhdimësi misioni dhe përgjegjësi ndaj atdheut

Në Forcën Tokësore të Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë u zhvillua ceremonia e ndërrimit të komandës, një moment me rëndësi institucionale që shpreh vazhdimësinë e misionit dhe përgjegjësinë e pandërprerë për mbrojtjen e vendit.

Ndërrimi i komandës nuk përfaqëson thjesht një akt formal, por është një proces natyror dhe funksional i strukturave ushtarake, ku përvoja, përgjegjësia dhe autoriteti kalojnë nga një dorë e sprovuar te një tjetër, duke garantuar stabilitet dhe koherencë në drejtimin e Forcës Tokësore.

Gjatë ceremonisë u shpreh mirënjohje për gjeneralmajor Ilir Xhebexhinë për shërbimin, përkushtimin dhe kontributin e dhënë në drejtimin e Forcës Tokësore, në një periudhë sfiduese për sigurinë kombëtare dhe rajonale. Nën drejtimin e tij, Forca Tokësore ka vijuar proceset e modernizimit, rritjes së gatishmërisë operacionale dhe përmbushjes së detyrimeve në kuadër të NATO-s.

Në të njëjtën kohë, detyra e komandantit të Forcës Tokësore i është besuar gjeneralmajor Petrit Çunit, të cilit iu urua suksese në këtë mision të rëndësishëm dhe të vazhdueshëm. Drejtimi i Forcës Tokësore kërkon vizion, profesionalizëm dhe vendimmarrje të përgjegjshme, në funksion të garantimit të sigurisë së Republikës së Shqipërisë dhe kontributit të saj në arkitekturën euroatlantike të mbrojtjes.

U theksua se çdo komandant ndërton mbi punën e paraardhësit, duke forcuar më tej kapacitetet njerëzore dhe operative të Forcës Tokësore, me synimin që ajo të jetë çdo ditë më e gatshme, më profesionale dhe më e besueshme përballë sfidave të sigurisë, si brenda vendit ashtu edhe në angazhimet ndërkombëtare.

Forca Tokësore mbetet një nga shtyllat kryesore të Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë, me rol të pazëvendësueshëm në mbrojtjen e sovranitetit dhe integritetit territorial, si dhe në përmbushjen e detyrimeve ndaj Aleancës së Atlantikut të Veriut.

Gazeta “Ushtria” do të vijojë të pasqyrojë me përgjegjësi dhe profesionalizëm zhvillimet institucionale në Forcat e Armatosura, duke vlerësuar kontributin e çdo drejtuesi dhe duke promovuar frymën e vazhdimësisë dhe shërbimit ndaj atdheut.



EMERGJENCAT CIVILE 2026

Shqipëria forcon kapacitetet për përballimin e krizave dhe fatkeqësive natyrore

Përballë sfidave gjithnjë e më komplekse që sjellin ndryshimet klimatike, urbanizimi i shpejtë dhe rreziqet natyrore e teknologjike, Shqipëria ka ndërmarrë një hap të rëndësishëm strategjik në forcimin e sistemit të emergjencave civile. Viti 2026 shënon një fazë të re konsolidimi për mbrojtjen civile, me theks të veçantë në koordinimin ndër-institucional, rritjen e kapaciteteve operacionale dhe përfshirjen aktive të Forcave të Armatosura në menaxhimin e krizave.

Programi “Emergjencat Civile 2026” përfaqëson një qasje gjithëpërfshirëse shtetërore, ku siguria e jetës së qytetarëve dhe mbrojtja e pronës e mjedisit janë prioritet kombëtar.

NJË SISTEM I INTEGRUAR PËR SIGURINË KOMBËTARE **Roli i institucioneve dhe Forcave të Armatosura**

Emergjencat civile nuk janë më vetëm çështje reagimi pas ndodhjes së një fatkeqësie, por një proces i vazhdueshëm planifikimi, parandalimi, përgatitjeje dhe ndërhyrjeje. Në këtë kuadër, Ministria e Mbrojtjes, Agjencia Kombëtare e Mbrojtjes Civile, Forcat e Armatosura, Policia e Shtetit, shërbimet zjarrfikëse dhe pushteti vendor veprojnë tashmë si një trup i vetëm operativ.

Forcat e Armatosura të Republikës së Shqipërisë mbeten një shtyllë kyçe e këtij sistemi. Me kapacitete të specializuara inxhinierike, mjete ajrore, njësi kërkim-shpëtimi dhe personel të trajnuar për operacione në kushte ekstreme, FA-të janë të gatshme të ndërhyjnë në çdo situatë emergjente, nga përmbytjet dhe zjarret masive, deri te tërmetet dhe emergjencat industriale.

Stërvitjet e përbashkëta, brenda dhe jashtë vendit, kanë rritur ndjeshëm ndërveprimin mes strukturave, duke

garantuar reagim të shpejtë dhe të koordinuar.

PËRGATITJE, TRAJNIM DHE TEKNOLOGJI

Investime për një reagim më të shpejtë dhe efikas

Një nga shtyllat kryesore të programit “Emergjencat Civile 2026” është modernizimi i mjeteve dhe teknologjisë. Sistemet e paralajmërimit të hershëm, hartëzimi i zonave të rrezikut, përdorimi i dronëve për monitorim dhe pajisjet moderne të kërkim-shpëtimit, janë tashmë pjesë e pandashme e reagimit ndaj emergjencave.

Në të njëjtën kohë, trajnimi i vazhdueshëm i personelit mbetet prioritet. Qindra efektivë nga FA-të, mbrojtja civile dhe shërbimet zjarrfikëse kanë marrë pjesë në kurse të specializuara për menaxhimin e krizave, operacionet në terrene të vështira dhe ndihmën humanitare.

Një rëndësi e veçantë i është kushtuar edhe ndërgjegjësimit të komunitetit. Qytetarët po informohen gjithnjë e më shumë për masat e vetëmbrojtjes dhe mënyrat e reagimit në rast emergjence, duke e kthyer sigurinë civile në përgjegjësi të përbashkët.





BASHKËPUNIMI NDËRKOMBËTAR

Shqipëria, pjesë aktive e mekanizmave rajonalë dhe euroatlantikë

Në një botë ku fatkeqësitë nuk njohin kufij, bashkëpunimi ndërkombëtar është thelbësor. Shqipëria është angazhuar aktivisht në mekanizmat rajonalë dhe në ato të Bashkimit Europian dhe NATO-s për mbrojtjen civile.

Pjesëmarrja në stërvitje shumëkombëshe dhe shkëmbimi i eksperiencave me vendet aleate ka rritur standardet e reagimit dhe ka forcuar kapacitetet kombëtare. Forcat e Armatosura shqiptare janë vlerësuar për profesionalizmin dhe gatishmërinë e tyre në operacione humanitare dhe emergjente jashtë vendit.

Ky bashkëpunim përkthehet në siguri më të madhe për qytetarët dhe në rritjen e besimit të institucionet shtetërore.

NJË VIZION AFATGJATË PËR SIGURINË E QYTETARËVE

Emergjencat Civile si pjesë e qëndrueshmërisë kombëtare

"Emergjencat Civile 2026" nuk është thjesht një plan veprimi për një vit të caktuar, por një vizion afatgjatë për ndërtimin e një shoqërie më të sigurt dhe më rezistente ndaj krizave. Përmes ligjeve të përmirësuara, investimeve strategjike dhe



forcimit të kapaciteteve njerëzore, Shqipëria po ndërton një sistem modern të mbrojtjes civile.

Roli i Forcave të Armatosura në këtë proces mbetet thelbësor, duke reflektuar misionin e tyre jo vetëm për mbrojtjen e sovranitetit, por edhe për shërbimin ndaj qytetarëve në momentet më të vështira.

Në një realitet ku emergjencat janë gjithnjë e më të shpeshta, gatishmëria, profesionalizmi dhe solidariteti institucional janë garancia më e fortë për sigurinë kombëtare.





MM dhe Urdhri Sovran i Maltës nënshkruajnë memorandum bashkëpunimi për forcimin e reagimit ndaj emergjencave civile

Ministria e Mbrojtjes e Republikës së Shqipërisë dhe Urdhri Sovran i Maltës nënshkruan një memorandum bashkëpunimi me synim rritjen e gatishmërisë dhe forcimin e mekanizmave të reagimit ndaj emergjencave civile, si dhe përmirësimin e mbështetjes mjekësore në situata krize. Marrëveshja parashikon një bashkëpunim të strukturuar në fushën e Emergjencave Civile, duke përfshirë ndërhyrje të përbashkëta në raste fatkeqësish natyrore apo situatash të tjera emergjente, mbështetje teknike, angazhimitin e ekspertëve përkatës, si dhe zhvillimin e trajnimeve dhe ndërtimin e kapaciteteve. Një tjetër shtyllë e rëndësishme e memorandumit është shkëmbimi i informacionit mbi praktikatat më të mira dhe koordinimi i veprimeve në fazën pas emergjencës.



Pas nënshkrimit të memorandumit, ministri i Mbrojtjes, Pirro Vengu, theksoi rëndësinë e këtij partneriteti strategjik, duke bërë të ditur se në këtë kuadër priti në një takim Josef D. Blotz, Hospitalierin e Madh të Urdhrit Sovran të Maltës. "Memorandumi i bashkëpunimit i firmosur sot nga Shqipëria përfaqëson një mundësi të rëndësishme për forcimin e gatishmërisë dhe mekanizmave të reagimit ndaj emergjencave civile, si dhe për mbështetjen mjekësore", – u shpreh ministri Vengu. Sipas tij, marrëveshja përcakton ndërhyrje të përbashkëta në raste emergjencash, zhvillimin e trajnimeve dhe programeve të ndërtimit të kapaciteteve, shkëmbimin e ekspertizës dhe praktikave më të mira, si dhe ofrimin e mbështetjes mjekësore në nivel civil dhe ushtarak. "Ky partneritet synon rritjen e kapaciteteve të përbashkëta dhe një reagim më efektiv, në shërbim të një të ardhmeje më të sigurt", – nënvizoi ministri Vengu. Në aspektin shëndetësor, memorandum i përfshin shkëmbimin e personelit mjekësor dhe teknik, organizimin e trajnimeve të përbashkëta për strukturat civile dhe ushtarake, përgatitjen dhe reagimin ndaj emergjencave shëndetësore në shkallë të gjerë, si dhe bashkëpunimin shkencor dhe teknologjik. Ky memorandum përfaqëson një hap të rëndësishëm në forcimin e bashkëpunimit ndërinstitucional dhe ndërkombëtar, duke kontribuar në rritjen e sigurisë dhe qëndrueshmërisë së vendit përballë sfidave të emergjencave civile dhe krizave shëndetësore.



Efektivët e Batalionit Komando, pjesëmarrës në stërvitjen ndërkombëtare "KFOR-36" në Gjermani

Efektivë të Batalionit Komando të Forcave të Armatosura shqiptare po marrin pjesë në stërvitjen paradisllokuese ndërkombëtare "KFOR-36", e cila po zhvillohet në qendrën ushtarake të Hohenfels, Gjermani.

Qëllimi i kësaj stërvitjeje është rritja e **ndërveprueshmërisë operative** me partnerët ndërkombëtarë, duke u fokusuar kryesisht në **menaxhimin e turmave dhe trazirave** gjatë misioneve paqeruajtëse dhe operacioneve të bashkëpunimit.

Pjesëmarrja e forcave shqiptare në "KFOR-36" synon gjithashtu **forcimin e kapaciteteve profesionale dhe bashkëpunimin me strukturat ushtarake të NATO-s**, duke kontribuar në standardizimin e procedurave dhe taktikave operative sipas normave ndërkombëtare.

Stërvitjet e tilla janë pjesë e angazhimit të vazhdueshëm të Shqipërisë për **pjesëmarrje aktive në operacionet paqeruajtëse** dhe për përmirësimin e aftësive të Forcave të Armatosura në skenarë komplekse ndërkombëtare.





Kontingjenti shqiptar mori pjesë në “Winter Festival” në Camp Butmir, në mbështetje të fëmijëve me aftësi ndryshe

Në ambientet e Bazës së EUFOR-it, Camp Butmir, në Sarajevë, Bosnjë dhe Hercegovinë, u zhvillua aktiviteti humanitar “Winter Festival”, me qëllim mbledhjen e fondeve për donacion në Qendrën e Fëmijëve me Aftësi ndryshe. Në këtë veprimtari me karakter solidariteti dhe bashkëpunimi ndërkombëtar morën pjesë trupa nga kontingjente të ndryshme të EUFOR-it, përfshirë edhe kontingjentin shqiptar, i cili u prezantua denjësisht me stendën e tij kombëtare. Stenda shqiptare u prit me interes nga pjesëmarrësit, duke ofruar produkte dhe elemente përfaqësues të traditës dhe kulturës shqiptare, ndërsa personeli i kontingjentit kontribuoi aktivisht në realizimin e qëllimit humanitar të aktivitetit. Pjesëmarrja në “Winter Festival” ishte një mundësi e mirë për të forcuar bashkëpunimin mes kontingjenteve partnere, si dhe për të promovuar vlerat e solidaritetit, humanizmit dhe përgjegjësisë sociale. Ky aktivitet dëshmon edhe një herë angazhimin e Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë në misionet paqeruajtëse ndërkombëtare, jo vetëm në aspektin operacional, por edhe në përmbushjen e rolit humanitar dhe social, në mbështetje të komuniteteve vendase ku shërbejnë. Forcat e Armatosura shqiptare vijojnë të përfaqësojnë vendin me dinjitet në misionin EUFOR ALTHEA, duke kontribuar në ruajtjen e paqes, sigurisë dhe forcimin e marrëdhënieve të bashkëpunimit ndërkombëtar.



Stërvitje e përbashkët me Forcat Speciale të SHBA-së në Zall-Herr

Forcat Speciale Shqiptare dhe Forcat Speciale të Shteteve të Bashkuara zhvilluan një stërvitje të përbashkët në Zall-Herr, e bazuar në skenarë realë për testimin e gatishmërisë për dislokim emergjent (EDRE). Qëllimi i aktivitetit ishte forcimi i aftësive operative, rritja e ndërveprueshmërisë dhe konsolidimi i besimit mes aleatëve të NATO-s për të reaguar shpejt dhe efektiv ndaj krizave. Stërvitja përforcon bashkëpunimin ndërkombëtar dhe tregon përkushtimin e Forcave të Armatosura Shqiptare për të mbështetur sigurinë kolektive dhe gatishmërinë në misionet ndërkombëtare.



Zall-Herr, stërvitje shumëkombëshe e ORF të KFOR-it për rritjen e gatishmërisë operacionale

Në Zall-Herr, Shtabi i Forcës së Rezervës Operacionale (ORF) të KFOR-it, i përbërë nga efektivë të Forcave të Armatosura të Shqipërisë, Bullgarisë, Greqisë dhe Rumanisë, po zhvillon një stërvitje të përqendruar në planifikimin, drejtimin dhe menaxhimin e operacioneve sipas skenarëve të ndryshëm në zonën e operacionit. Gjatë aktivitetit stërvitor, personeli shumëkombësh po trajnohet mbi procedurat e komandimit dhe kontrollit, koordinimin ndërmjet strukturave dhe reagimin operacional ndaj situatave të ndryshme, në përputhje me standardet e NATO-s. Këto stërvitje synojnë rritjen e ndërveprueshmërisë mes forcave pjesëmarrëse, forcimin e bashkëpunimit shumëkombësh dhe garantimin e një përgjigjeje të shpejtë, të koordinuar dhe efektive ndaj



çdo situatë të mundshme, në mbështetje të misionit të KFOR-it për ruajtjen e sigurisë dhe stabilitetit në Kosovë. Angazhimi i Forcave të Armatosura shqiptare në këtë stërvitje dëshmon profesionalizmin dhe kontributin e tyre të vazhdueshëm në operacionet paqeruajtëse ndërkombëtare dhe përkushtimin ndaj sigurisë rajonale dhe euroatlantike.

Forcat Speciale në aksion dimëror: ‘Shigjeta Ilire-26’ sfidon dëborën dhe temperaturat nën zero

Efektivët e Batalionit të Forcave Speciale po zhvillojnë stërvitjen dimërore 72-orëshe **“Shigjeta Ilire-26”**, në kushte të vështira malore, me dëborë dhe temperatura nën zero.

Kjo stërvitje ka për qëllim **forcimin e aftësive fizike dhe psikologjike në kushte mbijetese**, testimin e **armatimit dhe pajisjeve të reja**, si dhe rritjen e **gatishmërisë dhe qëndrueshmërisë operacionale** për të operuar në mjedise të vështira. Efektivët po praktikojnë manovra komplekse dhe teknike mbi mbijetesën në kushte ekstreme, duke u përgatitur për **përbushjen me sukses të çdo misioni**, me profesionalizëm të lartë dhe koordinim maksimal.

Stërvitja “Shigjeta Ilire-26” është pjesë e programit të trajnimeve intensive të Forcave Speciale, që synon të rrisë kapacitetet operative dhe përgatitjen për situata kritike në çdo skenar operativ.





FORCAT TOKËSORE NË MISSION: Ndërrim kontingjentesh në kuadër të misionit NATO eVA

Në bazën ushtarake të Novo Selos u zhvillua ceremonia zyrtare e ndërrimit të kontingjenteve të Forcave Tokësore, në kuadër të misionit shumëkombësh të forcës së përparuar (enhanced Vigilance Activities – eVA) të NATO-s. Gjatë ceremonisë, Kontingjenti i 6-të përmbylli me sukses detyrën e tij operacionale, duke demonstruar profesionalizëm të lartë, disiplinë, përkushtim dhe frymë të shkëlqyer bashkëpunimi me forcat aleate. Kontributi i tij u vlerësua si pjesë e rëndësishme e përpjekjeve të përbashkëta për garantimin e sigurisë dhe stabilitetit në rajon.

Stafetën e përgjegjësisë e mori Kontingjenti i 7-të, i cili shprehu gatishmëri të plotë për vijimin e misionit, duke ruajtur standarde të larta operacionale dhe një angazhim maksimal në përmbushjen e detyrave të ngarkuara.

Pjesëmarrja e Forcave Tokësore në misionin eVA dëshmon përkushtimin e vazhdueshëm të vendit tonë ndaj NATO-s dhe kontributin aktiv në forcimin e sigurisë kolektive, përmes bashkëpunimit të ngushtë me aleatët dhe partnerët strategjikë.



Shqipëria dhe Italia thellojnë bashkëpunimin ushtarak në takimin "ITA-ALB Army Staff Talks 2025"

Në kuadër të planit të bashkëpunimit midis Forcave të Armatosura të Shqipërisë dhe Italisë, në Itali u zhvillua takimi vjetor "ITA-ALB Army Staff Talks 2025". Ky aktivitet i rëndësishëm synon rritjen e bashkëpunimit ndërmjet dy Forcave Tokësore dhe përforcimin e partneritetit strategjik mes tyre. Gjatë punimeve të takimit, ekipi i Forcës Tokësore



të Shqipërisë zhvilloi bisedime dypalëshe me përfaqësuesit e ushtrisë italiane, duke analizuar arritjet e bashkëpunimit gjatë vitit 2025 dhe duke vlerësuar mundësitë për zgjerimin e tij në të ardhmen. Fokus i veçantë i diskutimeve ishte planifikimi i aktiviteteve për vitin 2026, ku të dyja palët shprehën vullnetin për të thelluar bashkëpunimin nëpërmjet trajnimeve të specializuara, shkëmbimeve profesionale dhe stërvitjeve të përbashkëta, me synim rritjen e ndërveprueshmërisë dhe aftësive operacionale. Takimi "ITA-ALB Army Staff Talks 2025" konfirmoi edhe një herë angazhimin e ndërsjellë për forcimin e partneritetit strategjik dhe për vijimin e bashkëpunimit të ngushtë mes dy vendeve aleate në kuadër të sigurisë dhe mbrojtjes.



Efektivët e Forcave Speciale zhvillojnë stërvitje të përbashkët me homologët turq

Efektivët e Forcave Speciale të Ushtrisë së Shqipërisë, në bashkëpunim me homologët e tyre të Forcave Speciale të Turqisë, kanë zhvilluar një stërvitje intensive të përbashkët, e fokusuar në module të avancuara operacionale. Gjatë ushtrimit u realizuan detyra komplekse dhe skenarë të shumëfishtë që simulojnë situata reale të fushës së veprimit.

Kjo stërvitje përbën një dëshmi të qartë të bashkëpunimit të ngushtë midis Forcave të Armatosura të dy vendeve dhe shërben për forcimin e mëtejshëm të koordinimit dhe ndërveprimit mes njësive elitare. Përmes këtyre aktiviteteve të përbashkëta, rritet ndërveprueshmëria, shkëmbimi profesional dhe gatishmëria për operacione të përbashkëta në të ardhmen.

Stërvitje të tilla mbeten thelbësore për zhvillimin e kapaciteteve dhe aftësive të specializuara, duke kontribuar njëkohësisht në forcimin e marrëdhënieve strategjike ndërmjet Shqipërisë dhe Turqisë.



NATO zhvillon stërvitjen “Stone Wall 25” në Bullgari, Shqipëria vlerësohet për profesionalizmin e trupave të saj

Stërvitja e përbashkët shumëkombëshe e NATO-s “Stone Wall 25” u zhvillua në Bullgari, duke bashkuar në ndërveprim njësitë ushtarake të tetë vendeve të Aleancës. Qëllimi i kësaj stërvitjeje madhore ishte forcimi i bashkëpunimit, rritja e gatishmërisë dhe përmirësimi i mbrojtjes kolektive në të gjithë krahun lindor të Aleancës. “Stone Wall 25” përbën një mundësi të rëndësishme për të konsoliduar integritetin shumëkombësh të njësive ushtarake pjesëmarrëse, si dhe për të rritur aftësitë operacionale të forcave të NATO-s, në kuadër të sfidave të sigurisë rajonale. Në Ditën e Vizitorëve të Shquar (DVD), ndër të ftuarit ishte edhe Gjeneralmajor Ilir Xhebexhia, komandant i Forcës Tokësore të Shqipërisë. Ai u mirëprit



nga drejtuesit e stërvitjes, si dhe nga pjesëtarët e kontingjentit shqiptar të dislokuar në Bullgari. Kolonel Mattia Scirocco, komandant i njësive shumëkombëshe, shprehu mirënjohjen dhe vlerësimin e lartë për performancën e trupave shqiptare, të cilët, siç u theksua, kanë kryer me përkushtim dhe profesionalizëm të gjitha detyrat e ngarkuara, duke u rreshtuar krah për krah me Aleatët dhe duke dëshmuar seriozitetin e angazhimit të Shqipërisë në NATO. Stërvitja “Stone Wall 25” konsiderohet një shembull i qartë i bashkëpunimit të ngushtë dhe të suksesshëm ndërmjet vendeve aleate, si dhe një investim i rëndësishëm në forcimin e sigurisë kolektive.





GRADIMI, NJË HAP I RI PËRGJEGJËSIE dhe lidershipi në Akademinë e Forcave të Armatosura

Në mjediset solemne të Akademisë së Forcave të Armatosura u zhvillua ceremonia e gradimit të nënoficerëve dhe oficerëve, një moment i rëndësishëm në jetën profesionale të ushtarakëve dhe në vazhdimësinë e forcimit të Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë. Ky akt përfaqëson jo vetëm një arritje personale për secilin prej tyre, por edhe një angazhim më të madh në shërbim të vendit, të sigurisë dhe të interesit kombëtar.

Ceremonia u zhvillua në prani të drejtuesve të lartë të Forcave të Armatosura, autoriteteve të Akademisë, instruktorëve, familjarëve dhe të ftuarve, duke krijuar një atmosferë dinjitoze dhe motivuese për të gjithë pjesëmarrësit. Gradimi shënoi kulmin e një rrugë të gjatë përgatitjeje akademike, profesionale dhe morale, të ndërtuar mbi disiplinën, sakrificën dhe vendime të vështira që formësojnë karakterin e ushtarakut.

Në fjalët e mbajtura gjatë ceremonisë, u theksua se grada nuk është thjesht një simbol autoriteti, por mbi të gjitha një barrë përgjegjësie. Ajo kërkon shembull personal, aftësi udhëheqëse dhe përkushtim të palëkundur ndaj misionit dhe vlerave të Forcave të Armatosura. Oficerët dhe nënoficerët e graduar u inkurajuan që të jenë liderë të drejtë, profesionistë të përgatitur dhe shërbëtorë të devotshëm të atdheut. Në sytë e të graduarve dallohej qartë krenaria për arritjen e sotme, por edhe vetëdija se nga kjo ditë e tutje çdo vendim dhe çdo veprim do të ketë peshë më të madhe. Grada e re nuk përfaqëson vetëm avancim në karrierë, por një angazhim të ri për të udhëhequr vartësit me ndershmëri, për të mbrojtur interesat e vendit dhe për të vepruar me profesionalizëm në çdo situatë, brenda dhe jashtë kufijve të Republikës së Shqipërisë. Akademia e Forcave të Armatosura vijon të mbetet institucioni kryesor



i formimit të elitës ushtarake shqiptare, duke përgatitur kuadro të afta për t'u përballur me sfidat bashkëkohore të sigurisë. Programet e saj mësimore synojnë jo vetëm zhvillimin e aftësive taktike dhe teknike, por edhe edukimin me vlerat e lidershipit, përgjegjësisë dhe bashkëpunimit ndërinstitucional e ndërkombëtar.

Ceremonia e gradimit ishte gjithashtu një moment reflektimi për rrugën e përbashkët të Forcave të Armatosura drejt modernizimit dhe përmbushjes së detyrimeve në kuadër të NATO-s. Oficerët dhe nënoficerët e rinj në gradë do të jenë pjesë aktive e këtij procesi, duke kontribuar në rritjen e kapaciteteve operacionale dhe në përforcimin e rolit të Shqipërisë si faktor stabiliteti në rajon. Në përfundim të ceremonisë, u përcollën urime për të gjithë të graduarit, me bindjen se besimi i dhënë sot do të shndërrohet në shërbim të ndershëm, profesionalizëm dhe përkushtim të vazhdueshëm. Gradimi i sotëm nuk është fundi i një etape, por fillimi i një përgjegjësie më të madhe për të udhëhequr, për të mbrojtur dhe për t'i shërbyer vendit me dinjitet dhe besnikëri ndaj flamurit.



Dy anijet e dhuruara nga Italia mbërrijnë në Shqipëri, Forca Detare forcon flotën dhe kapacitetet operative

Dy anijet e dhuruara nga qeveria italiane kanë mbërritur në Shqipëri më datë 6 dhjetor 2026, pas dy javëve trajnimi intensiv të efektivave të Forcës Detare Shqiptare në Itali. Mjetet lundruese do t'i bashkohen së shpejti flotës së Forcave Detare / Rojës Bregdetare, duke rritur ndjeshëm kapacitetet operative dhe aftësitë e reagimit në det.

Ky zhvillim përbën një hap të rëndësishëm në modernizimin e flotës sonë detare, si dhe në rritjen e sigurisë detare dhe kontrollit të hapësirës bregdetare shqiptare. Ndihma e qeverisë italiane shihet si një dëshmi e

fortë e bashkëpunimit të ngushtë dypalësh dhe e partneritetit strategjik midis dy vendeve.

Dhurimi i anijeve vjen gjithashtu si pjesë e angazhimit të Italisë për të mbështetur Shqipërinë në rrugën e saj drejt

integritit europian dhe forcimit të rolit në arkitekturën e sigurisë ndërkombëtare. Anijet e reja pritet të sjellin rritje të efikasitetit të operacioneve të kërkim-shpëtimit, patrullimit dhe mbrojtjes së kufirit detar. Me këtë kontribut të rëndësishëm, Forca Detare Shqiptare vijon modernizimin dhe zgjerimin e flotës, duke garantuar një nivel më të lartë të gatishmërisë dhe sigurisë në det.



Forca Ajrore Shqiptare dhe ajo Italiane thellojnë bashkëpunimin: Fokus, rritja e kapaciteteve dhe përgatitja për misionet e së ardhmes

Vullneti i përbashkët për të forcuar bashkëpunimin mes Forcës Ajrore Shqiptare dhe Forcës Ajrore Italiane u riafirmua gjatë takimit zyrtar të zhvilluar në Itali nga zëvendëskomandanti i Forcës Ajrore, kolonel Luan Sadiku. Takimi u fokusua në rritjen e kapaciteteve operative të FA-së dhe përgatitjen për misionet e së ardhmes, përmes bashkëpunimit të zgjeruar me Krahun e 36-të të Luftës të Forcës Ajrore Italiane.

Gjatë diskutimeve, palët vlerësuan rëndësinë e trajnimeve të përbashkëta, shkëmbimit të ekspertizës teknike dhe forcimit të ndërveprueshmërisë në operacionet ajrore. Ky bashkëpunim synon të rrisë nivelin e profesionalizmit dhe gatishmërisë së personelit shqiptar, duke garantuar standarde të larta të mbrojtjes ajrore.

Takimi konfirmoi edhe një herë mbështetjen e Italisë për modernizimin e Forcës Ajrore Shqiptare, si dhe angazhimin e ndërsjellë për të forcuar rolin e Shqipërisë në arkitekturën e sigurisë euroatlantike. Bashkëpunimi me Krahun e 36-të të Luftës pritet të sjellë rritje të kapaciteteve teknike dhe operative, duke përgatitur FA-në për sfidat dhe misionet e së ardhmes.





FORCA AJRORE SHQIPTARE

stërvitet me Forcën Ajrore amerikane, në fokus reagimi i shpejtë në kohë krize

Forca Ajrore shqiptare zhvilloi një stërvitje të përbashkët me **Forcën Ajrore të Shteteve të Bashkuara të Amerikës** në **Aeroportin Ndërkombëtar të Tiranës**, duke forcuar më tej ndërveprimin dhe gatishmërinë operacionale mes dy vendeve aleate në kuadër të **NATO-s**.

Stërvitja u fokusua në rritjen e aftësive për **reagim të shpejtë në kohë krize**, përmirësimin e ndërveprueshmërisë dhe përvetësimin e procedurave bashkëkohore operacionale sipas standardeve të Aleancës. Ajo u realizua në bashkëpunim me **Skuadronin e 102-të të Shpëtimit të Forcës Ajrore të SHBA-ve**, me qëllim trajnimin praktik të personelit të Forcës Ajrore shqiptare në procedurat e **furnizimit me karburant në zona të përparuara (Forward Area Refueling Point – FARP)**.

Gjatë stërvitjes, në pistën e Aeroportit Ndërkombëtar të Tiranës u realizua me sukses operacioni FARP, ku avioni ushtarak amerikan **HC-130J “Combat King”** furnizoi në tokë me karburant, në gjendje të ndezur, helikopterin **UH-60 “Black Hawk”** të Forcës Ajrore shqiptare, duke demonstruar një nivel të lartë profesionalizmi dhe koordinimi. Pilotët e helikopterëve UH-60 “Black Hawk” theksuan se stërvitja kontribuoi ndjeshëm në rritjen e aftësive operacionale. Toger **Fabio Bardho**, komandant ekuipazhi, u shpreh se bashkëpunimi me partnerët amerikanë ka qenë tejet i vlefshëm:

“Kjo stërvitje ka shërbyer për të rritur aftësitë tona pilotuese dhe për të qenë

gati sa më shpejt për operacionet luftarake që mund të ndodhin në fushëbetejë”.

Duke dhënë detaje mbi rëndësinë e këtij trajnimi, **nënkolonel Ervin Buzi**, komandant i Bazës Ajrore të Farkës, theksoi se stërvitja përbën risi për Forcën Ajrore shqiptare dhe hap një kapitull të ri në zhvillimin e kapaciteteve ajrore: *“Është një mundësi për rritjen e aftësive të ekuipazheve tona për të kryer operacione pa ndaluar helikopterin,*

duke garantuar vazhdimësi më të gjatë të misioneve dhe mbështetje efektive për trupat tona. Ky është një hap i rëndësishëm në bashkëpunim me aleatin amerikan dhe aleatët e NATO-s”.

Nga ana e tij, **nënkolonel Richard Bloom**, komandant i ekuipazhit të avionit amerikan HC-130J “Combat King”, vlerësoi profesionalizmin e Forcës Ajrore shqiptare gjatë stërvitjes:

“Kjo ishte hera e parë që Forca Ajrore shqiptare realizonte operacione FARP dhe performanca e tyre ishte absolutisht profesionale. Ishim vërtet me fat që punuam me ta”. Stërvitja përfaqëson një hap të rëndësishëm drejt **modernizimit të kapaciteteve ajrore** dhe forcimit të bashkëpunimit ndërkombëtar të Forcës Ajrore shqiptare, veçanërisht me aleatët strategjikë të NATO-s dhe **Bazën Ajrore të Avianos** në Itali.

Bashkëpunimi i vazhdueshëm mes Forcës Ajrore shqiptare dhe Forcës Ajrore amerikane dëshmon nivelin e lartë të partneritetit strategjik mes **Shqipërisë dhe Shteteve të Bashkuara të Amerikës** në fushën e mbrojtjes dhe sigurisë.





BASHKËPUNIM në aviacion dhe teknologji, FAj zhvillon vizitë në Turqi

Një delegacion i **Forcës Ajrore Shqiptare**, i kryesuar nga **gjeneralmajor Ferdinand Dima**, Komandant i Forcës Ajrore, zhvilloi sot një **vizitë zyrtare në Republikën e Turqisë**.


Gjatë vizitës, delegacioni shqiptar u prit nga **Shefi i Shtabit të Përgjithshëm të Forcave të Armatosura Turke**, si dhe nga **Komandanti i Forcës Ajrore Turke**, ku u zhvilluan takime në nivel të lartë dypalësh.

Bisedimet u përqendruan në **mundësi konkrete bashkëpunimi** në fushat e aviacionit ushtarak, teknologjive moderne dhe mbështetjes teknike, si dhe në rritjen e **ndërveprueshmërisë** dhe zgjerimin e **partneritetit strategjik** mes dy forcave ajrore.

Në kuadër të vizitës, delegacioni i Forcës Ajrore Shqiptare zhvilloi gjithashtu **vizita në kompani kryesore të industrisë së mbrojtjes**, ku u njoh nga afër me teknologjitë më të avancuara në fushën e aviacionit, sistemet pa pilot dhe mbështetjen logjistike.

Këto aktivitete krijojnë **mundësi konkrete për projekte të përbashkëta**, si dhe kontribuojnë në procesin e **modernizimit të kapaciteteve operacionale të Forcës Ajrore Shqiptare**, në përputhje me standardet dhe doktrinën e Aleancës së Atlantikut të Veriut.





Forcat e Armatosura përmirësojnë infrastrukturën: Përfundon ura metalike në Bleran

Batalioni i Xhenios në Komandën Mbështetëse vijon me intensitet detyrën për ndërtimin e urës metalike tip "Bailey" në fshatin Bleran, bashkia Shkodër.

Ura, me gjatësi 13 metra dhe seksion 1/1, ka një kapacitet mbajtës deri në 30 tonë dhe përfaqëson një investim të rëndësishëm për përmirësimin e infrastrukturës lokale. Ndërtimi i saj do të ndikojë drejtpërdrejt në lehtësimin e lëvizjes dhe rritjen e aksesit për rreth 1 000 banorë të zonës, duke përmirësuar ndjeshëm kryerjen e aktiviteteve të përditshme ekonomike dhe sociale.

Ky angazhim i Forcave të Armatosura dëshmon edhe një herë rolin e tyre të rëndësishëm në mbështetje të komuniteteve dhe në përballimin e nevojave infrastrukturore, veçanërisht në zonat rurale. Ndërtimi i urës pritet të përfundojë brenda afateve të planifikuara, duke garantuar standarde të larta sigurie dhe funksionaliteti.



Batalioni i Xhenios në mbështetje të autoriteteve civile në Lezhë dhe Elbasan

Batalioni i Xhenios vijon angazhimin e tij në mbështetje të autoriteteve civile, duke kontribuar në garantimin e sigurisë së komuniteteve në bashkitë **Lezhë** dhe **Elbasan**. Specialistët **EOD (Explosive Ordnance Disposal)** të Batalionit të Xhenios kanë kryer me sukses **vlerësimin, çaktivizimin dhe transportimin e municioneve ushtarake** të identifikuar në njësitë administrative **Kolsh** dhe **Mengël**, duke eliminuar rrezikun për banorët dhe mjedisin përreth.

Operacionet janë zhvilluar në koordinim të plotë me strukturat vendore dhe autoritetet përgjegjëse, në përputhje me procedurat dhe standardet e sigurisë në fuqi.

Batalioni i Xhenios vijon misionin e tij për **pastrimin e sipërfaqeve nga municionet e rrezikshme**, duke kontribuar drejtpërdrejt në rritjen e sigurisë publike dhe mbrojtjen e jetës së qytetarëve.



Kompania e Urave ndërton urë tip "Bailey" në Bashkinë Selenicë

Kompania e Urave, pjesë e Batalionit të Xhenios, ka nisur ndërhyrjen për ndërtimin e një ure metalike tip "Bailey" në territorin e Bashkisë Selenicë, në mbështetje të komunitetit lokal.

Ura me gjatësi 18 metra, seksion 2/1, do t'u shërbejë banorëve të fshatrave Bashaj, Matogjin, Vermik dhe Verbas, duke përmirësuar



ndjeshëm qarkullimin dhe duke garantuar akses më të sigurt drejt shërbimeve bazë, institucioneve arsimore, shëndetësore dhe tregjeve lokale.

Ndërhyrja e Batalionit të Xhenios vjen në kuadër të angazhimit të Forcave të Armatosura për t'u ardhur në ndihmë komuniteteve, veçanërisht në zonat ku infrastruktura është dëmtuar ose paraqet vështirësi për lëvizjen e mjeteve dhe këmbësorëve. Ndërtimi i urës tip "Bailey", e njohur për fleksibilitetin dhe efikasitetin në montim, përbën një zgjidhje të shpejtë dhe funksionale, duke rikthyer lidhjen ndërmjet zonave të prekura dhe duke përmirësuar jetën e përditshme të banorëve. Forcat e Armatosura vijnë në të dëshmojnë profesionalizëm dhe gatishmëri jo vetëm në përmbushjen e misioneve ushtarake, por edhe në mbështetje të zhvillimit dhe sigurisë së komuniteteve në të gjithë vendin.



BETIMI QË LIDH FJALËN ME ATDHEUN

ANJEZA MUSOLLARI,
Shefe e Sektorit të Botimeve

387 rekrutë, kadetë dhe studentë hedhin hapin e parë në shërbim të Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë

Një ceremoni solemne, e mbushur me emocion, krenari dhe përgjegjësi të lartë kombëtare, shënoi betimin ushtarak të 387 të rinjve dhe të rejave rekrutë, kadetë dhe studentë, të cilët zyrtarisht u rreshtuan në radhët e Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë. Ky akt solemn përbën jo vetëm nisjen e shërbimit ushtarak, por edhe një zotim të shenjtë për besnikëri ndaj flamurit, kombit dhe Republikës.

Ceremonia u zhvillua në praninë të **Presidentit të Republikës dhe Komandantit të Përgjithshëm të Forcave të Armatosura, Bajram Begaj, ministrit të Mbrojtjes, Pirro Vengu, shefit të Shtabit të Përgjithshëm të FA, gjenerallejtënant Arben Kingji**, si dhe drejtuesve të lartë ushtarakë, instruktorëve, pedagogëve, familjarëve të ushtarakëve të rinj dhe të ftuarve të tjerë.

Një ditë e shënuar për Forcat e Armatosura dhe për Shqipërinë

Në një atmosferë solemne dhe dinjitoze, të rinjtë shqiptarë shqiptuan fjalët e betimit ushtarak mbi flamur, duke marrë mbi supe barrën fisnike të mbrojtjes së sovranitetit, integritetit territorial dhe interesave kombëtare të vendit. Ky moment shënon një gur themeli në formimin e tyre profesional dhe moral si ushtarakë të Forcave të Armatosura, por njëkohësisht përfaqëson edhe një investim strategjik në të ardhmen e sigurisë kombëtare.

Të pranishëm në ceremoni ishin gjithashtu **kadedë dhe studentë nga Kosova**, të cilët po formohen sipas të njëjtave standarde profesionale dhe vlera euroatlantike, duke kontribuar në forcimin e bashkëpunimit, besimit dhe ndërveprueshmërisë rajonale.

Shefi i Shtabit të Përgjithshëm, gjenerallejtënant Arben Kingji: “Fjala e dhënë bëhet mision për gjithë jetën”

Mesazhe me peshë dhe përgjegjësi të lartë përcolli edhe shefi i Shtabit të Përgjithshëm të Forcave të Armatosura,

gjenerallejtënant Arben Kingji, i cili theksoi se betimi ushtarak është një akt që shkon përtej momentit solemn dhe shndërrohet në një mision jetësor.

“Ky akt mbart një peshë që zgjat gjithë jetën. Nga ky çast, fjala e dhënë nuk është thjesht premtim, por detyrim, përgjegjësi dhe mision, për t’i shërbyer me besnikëri Republikës së Shqipërisë, për të qenë të guximshëm, të disiplinuar dhe të denjë për uniformën ushtarake”, – u shpreh gjenerallejtënant Kingji.

Ai theksoi se për **ushtarët e rinj**, ky betim kurorëzon javë të tëra përkushtimi, stërvitjeje intensive dhe përshtatjeje me jetën ushtarake, ndërsa për **studentët dhe kadetët**, ai përfaqëson bashkimin e dijes profesionale me karakterin dhe disiplinën, duke e shndërruar formimin akademik në përgjegjësi konkrete ndaj Atdheut.

Gjenerallejtënant Kingji nënvizoi se Forcat e Armatosura kërkojnë njerëz të përgatitur jo vetëm fizikisht dhe profesionalisht, por edhe moralisht, të aftë për të përballuar sfidat e kohës dhe për të vepruar me vendosmëri në mbrojtje të interesave kombëtare.

Presidenti Bajram Begaj: “Betimi ushtarak është zotimi më i madh që një qytetar i bën atdheut”

Në fjalën e tij përshëndetëse, Presidenti i Republikës uroi ushtarakët e rinj për nisjen e këtij rrugëtimi fisnik, duke theksuar se shërbimi ushtarak është nder, krenari dhe përgjegjësi e lartë kombëtare.





“Sot është një ditë e veçantë për ju. Betimi ushtarak është një akt solemn, një zotim i qartë përpara flamurit dhe kombit, një premtim që shoqëron çdo ushtarak gjatë gjithë jetës së tij. Është zotimi më i madh që çdo qytetar mund t’i bëjë atdheut të vet”, – u shpreh Presidenti Begaj.

Ai theksoi se mbi supet e ushtarakëve të rinj bie barra e rëndë, por shumë fisnike, e mbrojtjes së Republikës së Shqipërisë, duke nënvizuar se ata përfaqësojnë **shpresën dhe forcën morale të institucionit të mbrojtjes.**

Presidenti vlerësoi procesin e stërvitjes dhe formimit, gjatë të cilit të rinjtë kanë ndërtuar disiplinën, karakterin dhe bindjen se shërbimi ndaj atdheut është i shenjtë.

Siguria nuk është e mirëqenë: Sfidat e reja gjeopolitike

Duke iu referuar zhvillimeve ndërkombëtare, Presidenti Begaj vuri theksin te situata e sigurisë në Europë dhe rajon, duke theksuar se paqja dhe siguria nuk mund të merren si të mirëqena.

“Lufta e Rusisë në Ukrainë ka vënë në pikëpyetje sigurinë europiane. Bota po përballlet me sfida të reja nga aktorë që nuk ndajnë vlerat e lirisë dhe demokracisë. As rajoni ynë nuk është i izoluar nga këto zhvillime”, – theksoi ai.

Presidenti nënvizoi rëndësinë strategjike të stabilitetit të Ballkanit Perëndimor, veçanërisht rolin e Kosovës, dhe kujtoi se si anëtare e NATO-s, Shqipëria ka jo vetëm përfitime, por edhe detyrime.

Forcat e Armatosura shqiptare, sipas tij, kanë dëshmuar profesionalizëm dhe besueshmëri përmes kontributit aktiv në misionet e NATO-s, BE-së dhe OKB-së.

Ministri Pirro Vengu: Fuqia luftarake ndërtohet mbi kapitalin njerëzor

Në fjalën e tij drejtuar ushtarakëve të rinj, ministri i Mbrojtjes, Pirro Vengu, vlerësoi vendimin e tyre vullnetar për t’u bashkuar me Forcat e Armatosura në një kontekst sfidues për sigurinë rajonale dhe evropiane.

Ai theksoi se fuqia e një ushtrie nuk matet vetëm me teknologji dhe pajisje, por mbi të gjitha me njerëzit që e përbëjnë atë: karakterin, disiplinën, profesionalizmin dhe aftësinë për të vepruar nën presion.

“Arsimi ushtarak është themeli i forcës së Forcave të Armatosura. Ushtria që kërkon NATO dhe që meriton Shqipëria ndërtohet mbi njerëz të përgatitur dhe struktura funksionale”, – u shpreh ministri Vengu.

“Mbrojtja 2030” – vizioni për një ushtri moderne dhe të besueshme

Ministri Vengu nënvizoi se Programi Strategjik “Mbrojtja 2030” mbështetet mbi dy shtylla themelore:

- **Kapitalin njerëzor,**
- **Infrastrukturën kritike dhe kapacitetet operacionale**

Ai theksoi se investimet në Akademinë e Forcave të Armatosura, qendrat stërvitore, laboratorët, poligonet dhe sistemet moderne të trajnimit nuk janë luks, por domosdoshmëri për ndërtimin e një ushtrie moderne, të ndëreveprueshme me aleatët dhe të besueshme për qytetarët. Në përmbyllje, ministri theksoi se sot Forcat e Armatosura janë më shumë se një ushtri: ato janë shtyllë e mbrojtjes kombëtare, përfshirë dimensionin kibernetik, si dhe një rezervë strategjike e kapitalit njerëzor për qëndrueshmërinë e vendit.

Një betim për Atdheun, një vokacion për jetën

Gjatë ceremonisë, 387 të rinjtë dhe të rejat u betuan për besnikëri ndaj Republikës së Shqipërisë, duke shprehur angazhimin për të mbrojtur atdheun me nder, disiplinë dhe sakrificë.

Ky betim nuk premtim rehati, por **i jep kuptim jetës;** nuk garanton lehtësi, por **ndërton dinjitet;** nuk është thjesht një zgjedhje profesionale, por **një vokacion.** Sot, këta të rinj janë garantët e besimit se **siguria, stabiliteti dhe e ardhmja e Shqipërisë** mbështeten mbi përkushtimin dhe profesionalizmin e Forcave të Armatosura.






NËN DY FLAMUJ, NJË MISIION

**Rrugëtimi i një emigranti shqiptar drejt
komandës së anijes luftarake amerikane
në epokën e tensioneve globale**

Misioni që pati ndikimin më të madh tek unë ndodhi më 11 shtator 2001. Në moshën vetëm 19-vjeçare, isha caktuar në USS Bataan (LHD 5) në Virginia kur ndodhën sulmet. Të dy prindërit e mi po punonin në Manhattan në atë kohë; misioni u bë menjëherë personal teksa prisja lajme për sigurinë e tyre. Brenda katër orësh u nisëm dhe herët në mëngjesin e nesërm ishim pranë bregut të New York City, të gatshëm për të ofruar ndihmë mjekësore.



ANJEZA MUSOLLARI,
Shefe e Sektorit të Botimeve

Komandant Alban Dervishi është lindur në Tiranë dhe emigroi në Queens, Nju Jork, për të ndjekur 'Ëndrrën Amerikane'. Pas përfundimit të shkollës së mesme, ai u regjistrua në Forcat Detare në vitin 2001 dhe mori gradën 'oficer' në vitin 2009, përmes Shkollës së Kandidatëve për Oficerë (Officer Candidate School). Komandant Dervishi përfundoi studimet Master në Marrëdhënie Ndërkombëtare, me nënspecializim në Studime Rajonale Evropiane dhe Aleancën e NATO-s, në Webster University, në bashkëpunim me Army Command and General Staff College.

Përvoja Operacionale

Detyrat e tij operacionale përfshijnë:

- Shërbim në bordin e **USS BATAAN (LHD-5)** në mbështetje të operacioneve **Operation Enduring Freedom** dhe **Operation Iraqi Freedom** (2001–2004).
 - Shërbim në bordin e **USS CARTER HALL (LSD-50)** në mbështetje të operacionit **Operation Unified Response** në Haiti dhe operacioneve në zonën e përgjegjësisë së Flotës së 5-të (2009–2012).
 - Shërbim në bordin e **USS ASHLAND (LSD-48)** në mbështetje të operacioneve në zonën e Flotës së 7-të (2016–2018).
 - Shërbim në bordin e **USS MOUNT WHITNEY (LCC-20)** në mbështetje të disa stërvitjeve të NATO-s, Flotës së 2-të dhe Flotës së 6-të të SHBA-së në Detin Baltik, Detin e Zi dhe Detin Mesdhe (2018–2020).
- Detyra e tij më e fundit ishte Zëvendës-komandant (Executive Officer) i **USS PEARL HARBOR (LSD-52)**.

Shërbimi në Tokë

Në detyra në tokë, ai ka shërbyer si Zëvendësudrejtor i Watchfloor në Qendrën e Komandës së Flotës së Gjashtë. Ai ka fituar titullin 'Amphibious Warfare Tactics Instructor' dhe ka shërbyer si oficer N4 në Amphibious Squadron Eight.

Gjithashtu, duke treguar fleksibilitet në strukturat e shtabit, ai mori përkohësisht detyrën e Zëvendëskomandantit të **USS MESA VERDE (LPD-19)**. Ai përfundoi turin e tij të përbashkët në NATO si Oficer Operacionesh në Komandën Detare Italiane, në mbështetje të disa operacioneve shumëkombëshe TRI-CARRIER.

Dekorata dhe Vlerësime

Komandant Dervishi është nderuar me:

- Medaljen e Shërbimit të Merituar në Mbrojtje (Defense Meritorious Service Medal);
- Medaljen e Lavdërimit të Marinës dhe Trupave Detare (5 herë);
- Medaljen e Arritjeve të Marinës dhe Trupave Detare (3 herë);
- Si dhe dekorata të ndryshme njësisht dhe medalje shërbimi/fushate.



Në qershor 2025, Komandant Alban Dervishi mori komandën e **USS PEARL HARBOR (LSD-52)**.

Prejardhja dhe përvoja personale

Komandant Dervishi, si e kujtoni fëmijërinë tuaj në Tiranë dhe çfarë ndikimi patën rrënjët tuaja shqiptare në formimin tuaj si oficer?

Vitet 1990 në Tiranë ishin një shkollë e vërtetë qëndrese. Përballimi i ndërprerjeve të energjisë elektrike, ndërprerjeve të shkollës, një mjedisi me burime të kufizuara dhe kolapsit të plotë të rendit gjatë ngjarjeve të vitit 1997 më mësuam të lulëzoj në kaos dhe të përshtatem kur burimet janë të pakta. Këto sfida bënë më shumë sesa thjesht të formonin karakterin tim; ato farkëtuan aftësitë drejtuese që përdor çdo ditë si oficer i marinës. Mbi të gjitha, mbështetja te rrethi im familjar gjatë atyre viteve më mësoi se asnjë mision nuk fitohet vetëm një mësim që përkthehet drejtpërdrejt në kulturën “të gjithë së bashku” të Marinës.

Sa sfidues ishte emigrimi në Shtetet e Bashkuara 25 vite më parë për ju dhe familjen tuaj, dhe me çfarë vështirësish u përballët në ndjekje të “ëndrrës amerikane”?

Emigrimi në New York, 25 vite më parë, ishte një tronditje e thellë kulturore kalimi nga Tirana në një metropol global kërkonte një përshtatje të shpejtë. Viti i parë ishte veçanërisht i vështirë, ndërsa përballesha me barrierën gjuhësore dhe ritmin e vrullshëm të qytetit. Megjithatë, mbështetja e komunitetit shqiptaro-amerikan në Queens ishte thelbësore. Ata ofruan bazën që na nevojitej për të kapërcyer hendekun midis trashëgimisë sonë dhe shtëpisë sonë të re. Ndjekja e “Ëndrrës Amerikane” nuk kishte të bënte vetëm me përpjekjen individuale; kishte të bënte me shfrytëzimin e mbështetjes së komunitetit për të kapërcyer pengesat fillestare të identitetit dhe integritetit.

A ka pasur një moment të veçantë apo një person që ndikoi në vendimin tuaj për t’iu bashkuar Forcave të Armatosura të Shteteve të Bashkuara?

Vendimi im për t’iu bashkuar Marinës u bazua në një kombinim të trashëgimisë familjare dhe admirimit të hershëm. Si babai im ashtu edhe gjyshi im patën shërbyer në ushtrinë shqiptare, ndaj koncepti i shërbimit ishte pjesë e rritjes sime. Për më tepër, ndërsa jetoja ende në Shqipëri, pashë nga afër praninë e forcave të SHBA-së dhe

të NATO-s, dhe fillova t’i idealizoja si një forcë superiore profesionistësh që vepronin për të mirën globale. Mbërrita në SHBA duke e ditur tashmë se doja t’i bashkohesha asaj force për të nderuar trashëgiminë ushtarake të familjes sime dhe për të synuar standardet elitare të ekselencës që përfaqësojnë Shtetet e Bashkuara.

Karriera Ushtarake dhe Përvoja Profesionale

Ju iu bashkuat ushtrisë amerikane menjëherë pas mbërritjes në SHBA. Si ishte ajo periudhë dhe sa e vështirë ishte të përshtateshit me strukturën ushtarake të një force të huaj?

Periudha fillestare ishte jashtëzakonisht kërkuese. Po përballesha me një sfidë të dyfishtë: të zotëroja gjuhën angleze ndërsa njëkohësisht mësoja “gjuhën” e specializuar të Marinës Amerikane. Megjithatë, detyrimi i vendosur për shërbim ofroi një përfshirje 24/7 që përshpejtoi përshtatjen time. Nuk kisha zgjedhje tjetër veçse të përshtatesha shpejt. Zbulova se struktura dhe disiplina e Marinës vepronin si një stabilizues i rëndësishëm; megjithëse kultura ishte e re, pritshmëritë e qarta dhe standardet profesionale ofruan një kornizë që më ndihmoi të integrohesha në jetën amerikane shumë më shpejt se sa do të mundesha në një mjedis civil.

Gjatë viteve, keni marrë pjesë në disa nga operacionet më të rëndësishme të SHBA-së. Cili nga këto misione pati ndikimin më të madh personal dhe profesional tek ju?

Misioni që pati ndikimin më të madh tek unë ndodhi më 11 shtator 2001. Në moshën vetëm 19-vjeçare, isha caktuar në USS Bataan (LHD 5) në Virginia kur ndodhën sulmet. Të dy prindërit e mi po punonin në Manhattan në atë kohë; misioni u bë menjëherë personal teksa prisja lajme për sigurinë e tyre. Brenda katër orësh u nisëm dhe herët në mëngjesin e nesërm ishim pranë bregut të New York City, të gatshëm për të ofruar ndihmë mjekësore. Pasi prania jonë nuk duhej më aty, lundruam gjysmën e botës për të treguar fuqinë mbi Afganistan. Në ato pak ditë, u rrita shumë shpejt; kuptova misionin dhe qëllimin e vërtetë të shërbimit tim. Nuk ishte thjesht një punë ishte një domosdoshmëri personale dhe kombëtare.

Si do të vlerësonit përvojën tuaj në Operacionet “ENDURING FREEDOM” dhe “IRAQI FREEDOM”, gjatë një periudhe kaq kritike të historisë bashkëkohore?

Unë e vlerësoj përvojën time në Operacionet

“ENDURING FREEDOM” (Liri e Qëndrueshme) dhe “IRAQI FREEDOM” (Liri në Irak) si furrën ku u formësua identiteti im profesional. Shërbimi gjatë një periudhe kaq kritike më mësoi se Marina nuk ka të bëjë vetëm me anijet dhe teknologjinë, por me qëndrueshmërinë operacionale dhe elementin njerëzor të luftës. Profesionalisht, ishte një shkollë e thellë në logjistikë dhe precizion; personalisht, forcoi “idealin” që kisha si i ri në Shqipëri—se Marina Amerikane është një forcë stabilizuese e aftë për prezencë të qëndrueshme globale. Këto operacione më mësoan se udhëheqja kërkon fokus të qartë në mision, ndërkohë që ruan mirëqenien e Marinës që e zbatojnë atë në kushtet më sfiduese. Ato më transformuan nga një marinar 19-vjeçar i përqendruar te “si” të kryej detyrat, në një oficer të ardhshëm që kupton “pse” dominimi ynë detar është thelbësor për sigurinë globale.

Ju keni shërbyer në Flotën e 6-të Amerikane dhe atë të 7-të, në zona strategjike si Deti Baltik, Deti i Zi dhe Mesdheu. Çfarë mund të na thoni për rëndësinë


operacionale të këtyre rajoneve?

Kam pasur gjithmonë një lidhje të veçantë me Europën, gjë që duket qartë në rrugën time profesionale, pasi jam rikthyer në Flotën e 6-të Amerikane disa herë. Ka një kënaqësi të thellë profesionale dhe personale në veprimtarinë në Mesdhe dhe në Detin Baltik. Për mua, këto nuk janë thjesht linja strategjike në një hartë; ato përfaqësojnë një rajon që e kuptoj thellësisht.

Profesionalisht, e shoh shërbimin tim të përsëritur në këto rajone si një angazhim për forcimin e sigurisë transatlantike dhe për çuarjen para të interesave tona kombëtare përmes një pranie të qëndrueshme detare. Për mua, veprimtaria në Mesdhe nuk është thjesht të jesh aty; është ndjekja aktive e ndërveprueshmërisë me aleatët tanë të NATO-s dhe mbrojtja e palëkundur e nyjave kritike detare. Besoj se duke ruajtur një forcë detare të besueshme dhe të dukshme, ne jemi rojet kryesore të sovranitetit të partnerëve tanë dhe të stabilitetit të vazhdueshëm të teatrit evropian.



Në mjedisin aktual të sigurisë globale, unë e shoh rolin e Marinës Amerikane përmes këndvështrimit të “Paqes përmes forcës”. Siç e ka theksuar lidershpi ynë, ne jemi në një periudhë konkurrence strategjike, ku dominimi detar nuk është vetëm një preferencë, por një domosdoshmëri për stabilitetin global.



Roli i Ri si Komandant i “USS Pearl Harbor”

Çfarë do të thotë për ju personalisht dhe profesionalisht marrja e komandës së “USS Pearl Harbor”?

Personalisht, marrja e komandës së “USS Pearl Harbor” (LSD 52) është vlerësimi maksimal i “Ëndrrës Amerikane”. Të kalosh nga një adoleshent që mbërrin në qytetin e New York-ut nga Tirana, në komandimin e një anije lufte të Shteteve të Bashkuara është një dëshmi e mundësive pa kufij të këtij vendi. Profesionalisht, udhëheqja e një anijeje me një emër kaq historik ka një peshë të thellë. “Pearl Harbor” është një emër sinonim i qëndrueshmërisë amerikane dhe vendosmërisë për të kapërcyer vështirësitë. E shoh si detyrën time më të lartë të siguroj që ekuipazhi im të mishërojë të njëjtin shpirt gatishmërie dhe këmbënguljeje, duke nderuar trashëgiminë e atyre që shërbyen para nesh dhe duke qëndruar të gatshëm për çdo sfidë moderne.

Cilat janë prioritetet tuaja ndërsa merrni komandën e një anije lufte kaq të rëndësishme të Marinës Amerikane?

Pas shtatë muajsh në komandë dhe shpërndarjes në të gjithë Paqësorin, prioriteti im kryesor ka qenë ruajtja e një niveli të lartë gatishmërie për misionin, ndërsa forcoj rezistencën e jashtëzakonshme të ekuipazhit tim. Kam qenë dëshmitar i performancës së tyre në çdo rast, dhe nuk mund të jem më krenar për punën e tyre. Një moment i veçantë i kësaj komande ka qenë misioni ynë humanitar gjatë “Pacific Partnership 2025”, ku demonstruam anën e mëshirshme të fuqisë detare amerikane. Megjithatë, ne kurrë nuk humbasim nga syri qëllimin tonë kryesor: të ruajmë gatishmërinë më të lartë, duke siguruar që “USS Pearl Harbor” të qëndrojë si një simbol i dukshëm i forcës amerikane, i gatshëm për t’u përgjigjur çdo sfidë në teatrin e Paqësorit.

Nga roli i Zëvendës Komandantit në atë të Komandantit – cilat janë ndryshimet më të mëdha në përgjegjësi dhe marrje vendimesh?

Komanda në det është një përvojë unike, që ndryshon plotësisht perspektivën tuaj mbi udhëheqjen. Kalimi në rolin e Oficerit Komandues përcaktohet nga një ndjesi e thellë dhe e pakthyeshme e përgjegjësisë përfundimtare. Ka momente në mes të Paqësorit, nën yje, kur shikon pajisjet elektronike dhe kupton se nuk ka asnjë jetë tjetër njerëzore ose tokë për 600–700 milje detare në çdo drejtim. Në atë hapësirë të pafund, siguria e mbi 500 marinarëve varet plotësisht mbi supet tuaja.

Përtej kësaj peshe, ekziston një ndjesi e thellë e pasjes së një qëllimi në kryerjen e misionit, ndërsa këshillon gjeneratën e ardhshme. Të shohësh marinarët e rinj që ndodhen pikërisht aty, ku isha unë 25 vite më parë, të rriten në udhëheqës të qëndrueshëm dhe luftëtarë profesionistë është ndoshta pjesa më shpërblyese e të qenit në “karrigen qendrore”.

Çfarë sfidash kryesore prisni të përballeni gjatë komandimit të “USS Pearl Harbor” në këtë periudhë të re të tensioneve globale?

Komandimi i “USS Pearl Harbor” në Indo-Paqësor përfshin menaxhimin e një mjedisi kompleks sigurie, të fokusuar në interesat kombëtare detare. Sfida kryesore është krijimi i një mbrojtjeje të qëndrueshme dhe të besueshme përgjatë “First Island Chain” – (Zinxhirin e parë të ishujve, arkipelagëve të mëdhenj të Paqësorit që dalin nga bregu kontinental i Azisë Lindore), përballë presionit të vazhdueshëm ushtarak. Balancimi i misioneve humanitare me gatishmërinë për betejë shihet si një strategji e dyfishtë; misione si “Pacific Partnership 2025” ndërtojnë kapacitet dhe përgatitin për krizë, ndërsa “USS Pearl Harbor” duhet të mbetet një platformë e aftë për veprime luftarake.

Arsimimi dhe Kualifikimi Akademik

Ju keni përfunduar studime të avancuara në Marrëdhënie Ndërkombëtare dhe NATO. Si ju ka ndihmuar kjo bazë akademike në detyrat tuaja ushtarake?

Përvoja ime akademike vepron si një lente strategjike përmes së cilës unë shoh operacionet taktike. Studimi

për Marrëdhënie Ndërkombëtare dhe NATO më kanë dhënë një kuptim më të thellë të “pse”-së pas pranisë sonë në ujërat e kontestuara. Më lejon të parashikoj valët gjeopolitike të lëvizjeve tona dhe të komunikoj më mirë rëndësinë e misionit tonë tek ekuipazhi im.

Në Marinë, ne nuk operojmë në zbrazëti; çdo manovër është një mesazh diplomacie dhe parandalimi. Studimet e mia më ndihmojnë të siguroj që “USS Pearl Harbor” të mbetet një instrument i saktë i politikës kombëtare.

Sa e rëndësishme është për një oficer të Marinës të ketë një bazë të fortë akademike, përveç përvijës praktike në terren?

Në Marinën moderne, përvoja dhe rigoroziteti akademik janë të pandashëm. Është një kërkesë profesionale që çdo Oficer Komandues të ketë një diplomë Masteri, sepse kompleksiteti i misionit tonë kërkon më shumë se thjesht aftësi taktike. Një bazë e fortë akademike është thelbësore për të menduar strategjikisht dhe për angazhimin diplomatik që kërkohet kur veprojmë pranë marinave të huaja në ujëra ndërkombëtare. Qoftë për të kuptuar nuancat e ligjit detar, qoftë për të menaxhuar sistemet teknike të sofistikuara të një anijeje lufte moderne, arsimi ynë siguron që mund të përpunojmë informacion kompleks dhe të marrim vendime të duhura nën presion. Për mua, studimet kanë qenë “timoni” intelektual që më lejon të navigoj sfidat gjeopolitike dhe teknike të komandës me saktësi.

Shqipëria, Identiteti dhe Lidhja me Atdheun

Si e ruani lidhjen tuaj me Shqipërinë, ndërsa shërbeni në nivele të larta në ushtrinë amerikane?

Ruajtja e lidhjes me rrënjët e mia është një prioritet natyral si për mua, ashtu edhe për gruan time, pasi të dy jemi rritur në Shqipëri. Si shumë të tjerë në diasporë, pushimet tona na çojnë instinktivisht sërish në atdhe. Kurrë nuk duket se kemi mjaftueshëm kohë; gjithmonë largohemi duke dëshiruar më shumë. Megjithatë, ato vizita janë thelbësore për t'u rikthyer tek familja dhe miqtë dhe për të siguruar që fëmijët tanë — të lindur në Amerikë — të mbeten të lidhur me trashëgiminë e tyre. Të shohësh që ata presin me padurim çdo udhëtim në Shqipëri është një burim krenarie të madhe. Edhe duke shërbyer në nivele të larta në ushtrinë amerikane, ato vizita më kujtojnë se identiteti im si oficer amerikan forcohet nga vlerat dhe historia e rritjes sime në Shqipëri.

Si e vlerësoni imazhin e shqiptarëve në ushtrinë amerikane dhe kontributin e komunitetit shqiptaro-amerikan në forcimin e marrëdhënieve midis dy vendeve?

Komuniteti shqiptaro-amerikan vepron si një “urë e gjallë” thelbësore midis dy vendeve tona. Duke shërbyer në nivele të larta në Forcat e Armatosura të SHBA-së, ne forcojmë besimin që ekziston midis SHBA-së dhe Shqipërisë, si një aleat i qëndrueshëm i NATO-s. Kontributi ynë nuk qëndron vetëm në punën tonë, por edhe në aftësinë për të përkthyer vlerat e të dy kulturave në një mision të përbashkët për stabilitet global. Ky identitet i dyfishtë unik na lejon të jemi disa nga avokatët më pasionantë për forcimin e vazhdueshëm të lidhjes transatlantike.

A keni një mesazh për të rinjtë shqiptarë që ëndërrojnë një karrierë në forcat e armatosura ose në diplomaci?

Mesazhi im për të rinjtë shqiptarë është i thjeshtë: Në forcat e armatosura, do të gjeni mundësi të pakufizuara, por çdo pozicion udhëheqës duhet të fitohet përmes punës së palodhur dhe përkushtimit. Ju mund të jeni të sigurt se do të gjeni një organizatë vërtet bazuar në merita — një që vlerëson performancën mbi çdo gjë tjetër. Nuk ka rëndësi nga ku keni nisur; ajo që ka rëndësi është disiplinimi juaj dhe përkushtimi ndaj misionit. Përdorni qëndrueshmërinë e trashëgimisë suaj si karburant. Nëse jeni të gatshëm të punoni me përkushtim dhe të ruani integritetin tuaj, ky profesion do t'ju ofrojë një rrugë drejt suksesit që bazohet tërësisht në cilësinë e karakterit tuaj dhe rezultatet që arrini.

Çmimet dhe Nderimet

Ju jeni vlerësuar me Medaljen e Shërbimit të Merituar në Mbrojtje dhe disa medalje të tjera të rëndësishme. Çfarë domethënie kanë këto nderime për ju?

Ishoh medaljet e mia si një portal; kur i shoh, më kthejnë në momente specifike sakrifice dhe përkushtimi, si të miat ashtu edhe të marinarëve që kam udhëhequr. Ato nuk janë thjesht dekorime, por kujtesa të dislokimeve të gjata dhe vështirësive të përbashkëta që kemi duruar për të përfunduar misionin. Çdo nderim është një dritare në vendosmërinë kolektive të një ekuipazhi që punon drejt një qëllimi të përbashkët. Në fund të fundit, këto çmime përfaqësojnë momentet kur angazhimi ynë ndaj njëri-tjetrit dhe ndaj kombit u vu në provë dhe ne fituam.

A ka patur ndonjë moment kur ndiet se të gjitha sakrificat tuaja ishin shpërblyer vërtet?

Vite më parë arrita në një pikë ku u ndjeva vërtet i shpërblyer dhe i realizuar në udhëtimin tim. Sot, pasi kam realizuar qëllimet e mia profesionale, fokusi im është zhvendosur tërësisht drejt një misioni të ri: detyrimit për të mbështetur brezin e ardhshëm të luftëtarëve. Shpërblimi më i madh që gjej tani është të sigurohem që të rinjtë dhe të rejtat që vijnë pas meje të kenë të njëjtat - ose më të mira - mundësi sesa unë.

Perspektiva Strategjike

Si e shihni zhvillimin e rolit të Marinës Amerikane në kontekstin e sfidave të sigurisë globale të sotme?

Në mjedisin aktual të sigurisë globale, unë e shoh rolin e Marinës Amerikane përmes këndvështrimit të "Paqes përmes forcës". Siç e ka theksuar lidershpi ynë, ne jemi në një periudhë konkurrence strategjike, ku dominimi detar nuk është vetëm një preferencë, por një domosdoshmëri për stabilitetin global. Ne ruajmë gatishmërinë luftarake

të nevojshme për parandalim. Ne veprojmë përpara në mënyrë që të mund të parandalojmë konfliktin para se të fillojë, por mbetemi të përgatitur për të luftuar dhe për të fituar nëse interesat tona kombëtare ose aleatët tanë kërcënohen. Në fund të fundit, Marina është themeli i sigurisë globale, duke siguruar mjedisin e qëndrueshëm të nevojshëm për lulëzimin e diplomacisë dhe prosperitetit ekonomik.

Sa i rëndësishëm është bashkëpunimi i SHBA-së me NATO-n në operacionet detare dhe cilat janë sfidat më urgjente për aleancën?

Bashkëpunimi i SHBA-së me NATO-n është themeli i strategjisë sonë detare; e shoh Aleancën jo vetëm si një partneritet, por si shumëfishuesin tonë më të madh strategjik të forcës. Në përputhje me misionin e Flotës së 6-të Amerikane, fuqia jonë buron nga aftësia për të operuar si një forcë e bashkuar, shumëkombëshe. Megjithatë, Aleanca është më e fortë kur të gjithë Aleatët e saj janë të fortë individualisht. Sfidat më urgjente me të cilën përballemi është përmbushja e angazhimeve për shpenzimet e mbrojtjes dhe operacionalizimi i tyre për të siguruar ndërveprueshmëri të qetë aftësinë e vendeve të ndryshme për të komunikuar, ndarë të dhëna dhe për të kryer manovra komplekse si një njësi e vetme.

Cilat janë qëllimet tuaja afatgjata për karrierën tuaj ushtarake pas komandimit të anijes "USS Pearl Harbor"? Çfarë këshille do t'u jepnit emigrantëve që kërkojnë sukses në një vend të ri, siç keni bërë ju?

Pas kohës sime në "USS Pearl Harbor", qëllimi im është të kaloj në një rol të lartë si staf, duke u rikthyer specifikisht në Flotën e 6-të të Shteteve të Bashkuara, për të marrë një rol kyç në planifikimin e operacioneve detare në Europë dhe Afrikë. Kjo do të më lejojë të aplikoj përvojën time operationale në sfidat më të gjera strategjike të rajonit. Më pas, do të synoj Komandën Madhore, me ambicien për të udhëhequr një anije amfibe me kuvertë të madhe, duke komanduar mijëra marinarë dhe një flotë të integruar ajrore. Këshilla ime për emigrantët që kërkojnë sukses në një vend të ri është e thjeshtë: Përqafoni sfidën e integritit pa humbur esencën e identitetit tuaj. Kërkoni organizata që vlerësojnë meritën dhe performancën, si Marina e Shteteve të Bashkuara, dhe punoni më shumë se të gjithë rreth jush. Suksesi në një vend të ri nuk jepet; fitohet përmes këmbënguljes, përkushtimit ndaj të mësuarit të vazhdueshëm dhe respektit të thellë për vlerat e shtëpisë së re.





MAJOR LLAHA:

RRUGËTIMI I NJË OFICERI, PESHA E NJË GRADE, FORCA E NJË FAMILJEJE

**Intervistoi: ANJEZA MUSOLLARI,
Shefe e Sektorit të Botimeve**

GRADIMI, MOMENT INSTITUCIONAL DHE PËRGJEGJËSI E SHTUAR

Ceremonia e gradimit në Akademinë e Forcave të Armatosura përfaqëson një nga momentet më domethënëse në jetën profesionale të çdo oficeri. Ajo nuk është vetëm një akt formal, por një vlerësim institucional i punës, disiplinës dhe përkushtimit shumëvjeçar në shërbim të Forcave të Armatosura dhe Republikës së Shqipërisë. Në këtë kuadër, gradimi i Major Adriatik Llahe shënon një etapë të rëndësishme në karrierën e tij ushtarake.

Major Llahe, çfarë përfaqëson për ju ky gradim?

Gradimi në gradën 'major' përfaqëson një moment reflektimi të thellë profesional dhe përgjegjësie të shtuar. Nuk është thjesht një hap në hierarkinë ushtarake, por një vlerësim institucional i përpjekjeve shumëvjeçare, i sakrificave personale dhe familjare, si dhe i përkushtimit të vazhdueshëm ndaj detyrës dhe misionit të Forcave të Armatosura. Ky gradim më bën të reflektoj mbi rrugëtimin tim profesional, mbi sfidat e përballuara dhe mbi besimin që institucioni ka treguar ndaj meje. Njëkohësisht, ai rrit ndjeshëm barrën e përgjegjësisë, sepse çdo gradë më e

lartë kërkon më shumë maturi, vizion dhe angazhim në shërbim të vendit.

Çfarë ndjesish përjetuat gjatë ceremonisë së gradimit?

Ceremonia e gradimit ishte një përjetim i mbushur me emocione. Ndjeva krenari, jo vetëm për veten time, por edhe për familjen, kolegët dhe vartësit që kanë qenë pjesë e këtij rrugëtimi. Ishte një moment solemn, ku ndërthureshin ndjenja gëzimi dhe mirënjohjeje, por edhe vetëdija e plotë se kjo gradë përfaqëson fillimin e një angazhimi edhe më të madh. Çdo simbol i gradës mbart mbi vete historinë e shërbimit, të sakrificës dhe të besimit institucional.

Një nga momentet më prekëse dhe simbolike të ceremonisë së gradimit ishte çasti kur njëra prej gradave të Majorit iu vendos nga bashkëshortja e tij. Ky akt, i thjeshtë në formë, por jashtëzakonisht i thellë në domethënie, përfaqësonte jo vetëm mbështetjen familjare, por edhe sakrificën e heshtur që qëndron pas çdo karriere ushtarake. Në atë moment, grada



nuk ishte vetëm një simbol hierarkik, por një dëshmi e përbashkët e një rrugëtimi të ndërtuar me përkushtim, durim dhe besim reciprok.

Vendosja e gradës nga bashkëshortja juaj ishte një moment shumë simbolik. Sa e rëndësishme ka qenë mbështetja e familjes në rrugëtimin tuaj profesional dhe çfarë përfaqëson ajo për ju sot?

Mbështetja e familjes ka qenë thelbësore. Pas çdo uniforme qëndron një familje që përballon mungesat, pasiguritë dhe sakrificat e kësaj karriere. Vendosja e gradës nga bashkëshortja i dha ceremonisë një dimension njerëzor dhe emocional, bashkoi detyrën me ndjenjën, profesionin me familjen, duke e kthyer atë në një ngjarje jo vetëm institucionale, por edhe thellësisht personale. Suksesi në shërbimin ushtarak është gjithmonë fryt i një përpjekjeje të përbashkët.

AKADEMIA E FORCAVE TË ARMATOSURA, SHKOLLË PROFESIONALIZMI

Si e vlerësoni formimin tuaj akademik në Akademinë e Forcave të Armatosura?

Akademia e Forcave të Armatosura ka qenë baza institucionale e formimit tim si oficer, por rrugëtimi im ka qenë që në fillim i ndërthurrur me arsimin civil dhe përvojën ndërkombëtare. Studimet në Akademinë e Forcave të Armatosura, të përfunduara në vitin 2012, u zhvilluan paralelisht me studimet në Inxhinieri Elektronike në Universitetin Politeknik të Tiranës, ku u diplomova në vitin 2011. Ky kombinim ka ndikuar ndjeshëm në ndërtimin e një qasjeje analitike, teknike dhe sistematike ndaj çështjeve të sigurisë dhe mbrojtjes.

Akademia nuk ka qenë vetëm një institucion arsimor, por një shkollë e disiplinës, e përgjegjësisë dhe e formimit të karakterit, ku mësohet të mendosh dhe të veprësh si lider, si oficer.

Sa ka ndikuar përvoja ndërkombëtare në formësimin tuaj profesional?

Në mënyrë vendimtare. Trajnimet ushtarake në Shtetet e Bashkuara të Amerikës, përfshirë *Officer Candidate School* në *New Jersey National Guard*, *Infantry Basic Officer Leader Course* dhe *Maneuver Captain Career Course* në *Fort Benning, Georgia*, kanë pasur një ndikim të drejtpërdrejtë në zhvillimin tim si lider dhe oficer. Këto programe kanë forcuar aftësinë për vendimmarrje nën presion, udhëheqje me shembull personal dhe menaxhim efektiv të burimeve njerëzore në mjedise komplekse operacionale ku përballen mjediset konflikteve të sotme.

Cili ka qenë roli i stërvitjeve dhe misionëve paqeruajtës?

Stërvitjet kombëtare dhe ndërkombëtare, si dhe pjesëmarrja në misione paqeruajtëse, përfshirë misionin në Afganistan, kanë qenë etapa kyçe në pjekurinë profesionale dhe njerëzore. Aty teoria përballlet me realitetin dhe oficeri vlerësohet jo vetëm për profesionalizmin, por edhe për karakterin, maturinë dhe aftësinë për të punuar në struktura shumëkombëshe.

Cilat kanë qenë sfidat më të mëdha gjatë karrierës suaj ushtarake?

Një nga sfidat kryesore ka qenë balancimi midis detyrës dhe jetës personale. Karriera ushtarake kërkon gatishmëri të vazhdueshme, sakrificë dhe përgjegjësi të lartë. Largimet e shpeshta dhe ngarkesa emocionale janë pjesë e realitetit të këtij profesioni, sidomos në fillim të karrierës ushtarake, ku vlen të theksoj se në afërsisht 13 vite si oficer aktiv, rreth 4 vite kam shërbyer larg vendbanimit në repartin ushtarak 1010, Vau Dejës, Shkodër.

Sfida të rëndësishme gjatë karrierës sime kanë qenë të lidhura ngushtësisht me sfidat që Forcat e Armatosura kanë përjetuar pas anëtarësimit të Shqipërisë në NATO. Angazhimi i drejtpërdrejt ose jo në përgatitjet dhe kontributin që njësitë tona ushtarake duhet të jepnin për të arritur certifikimet dhe vlerësimet sipas standardeve të NATO-s, një proces kërkues që ka imponuar rritje të nivelit të profesionalizmit, disiplinës dhe ndërveprueshmërisë me partnerët aleatë.

Një tjetër sfidë madhore kanë qenë misionet paqeruajtëse, ku përballja me realitete komplekse operative dhe mjedise shumëkombëshe kërkon jo vetëm përgatitje ushtarake, por edhe pjekuri profesionale, fleksibilitet dhe aftësi për bashkëpunim ndërkombëtar. Po ashtu, angazhimi në operacionet e emergjencave civile brenda vendit, veçanërisht gjatë situatave të zjarreve dhe përmbytjeve, ka përbërë një sfidë të veçantë, duke dëshmuar rolin thelbësor të ushtrisë në mbështetje të shoqërisë dhe institucioneve civile. Paralelisht me këto angazhime, një sfidë e vazhdueshme ka qenë balancimi midis detyrës dhe jetës personale. Karriera ushtarake kërkon gatishmëri të përhershme, sakrificë dhe përgjegjësi të lartë, ndërsa largimet e shpeshta dhe shërbimi jashtë vendbanimit kanë qenë pjesë e realitetit profesional, veçanërisht në vitet e para të karrierës sime, ku për rreth katër vite kam shërbyer larg vendbanimit, në repartin ushtarak 1010, Vau i Dejës, Shkodër.

Çfarë e mban të fortë një oficer përballë vështirësive?

Ndjenja e detyrës, besimi të misioni dhe mbështetja e kolegëve, janë elementë kyç. Po aq e rëndësishme është edhe mbështetja e familjes, e cila shpeshherë përfaqëson shtyllën morale që i jep forcë oficerit për të përballuar çdo vështirësi.

DIMENSIONI NJERËZOR I OFICERIT

Si e shihni rolin e oficerit në shoqëri?

Oficeri ka një rol të rëndësishëm jo vetëm brenda Forcave të Armatosura, por edhe në shoqëri. Ai duhet të jetë shembull i disiplinës, korrektësisë dhe integritetit moral, duke përfaqësuar vlerat e shtetit në çdo veprim dhe komunikim. Roli ynë është të ndërtojmë besim dhe të kontribuojmë në stabilitetin dhe sigurinë e vendit dhe jo vetëm, duke konsideruar impaktin global të NATO-s.

Sa e rëndësishme është etika profesionale në shërbimin ushtarak?

Etika profesionale dhe integriteti, do të shtoja, janë themeli mbi të cilin ndërtohet shërbimi ushtarak. Pa etikë dhe integritet nuk mund të ketë besim, dhe pa besim nuk mund të ketë lidhshmëri të vërtetë. Vendimarrja e drejtë, respekti për ligjin dhe për dinjitetin njerëzor janë parime që duhet të udhëheqin çdo oficer në çdo nivel drejtimi.

LIDERSHIPI DHE PËRGJEGJËSIA E GRADËS 'MAJOR'

Si e përkufizoni lidhshmërinë ushtarake?

Lidhshmëria ushtarake është aftësia për të udhëhequr me shembull personal, për të frymëzuar vartësit dhe për të marrë vendime të drejta edhe në situata të vështira. Ai kërkon përgjegjësi të plotë dhe prani të vazhdueshme pranë bashkëpunëtorëve të tu.


Cilat janë prioritetet tua në këtë fazë të karrierës?

Duke shërbyer aktualisht në Akademinë e Forcave të Armatosura si pedagog dhe koordinator i programeve master në fushën e sigurisë kibernetike dhe inteligjencës artificiale, prioritetet e mia fokusohen në forcimin e profesionalizmit ushtarak përmes integritetit të teknologjive të avancuara dhe ndërtimit të kapaciteteve njerëzore në mjedisin e sigurisë digjitale. Një vëmendje e veçantë i kushtohet zhvillimit të programeve akademike dhe trajnimeve të orientuara drejt kërcënimeve hibride dhe mbrojtjes kibernetike, në përputhje me standardet e NATO-s dhe nevojat reale operacionale. Paralelisht, prioritet personal kam ndjekjen e studimeve të doktoraturës në fushën e teknologjisë së informacionit, duke patur një koherencë mes vizionit strategjik, formimit akademik dhe zbatimit operacional në shërbim të sigurisë kombëtare.

MESAZH PËR BREZAT E RINJ

Çfarë mesazhi keni për të rinjtë që synojnë Akademinë e Forcave të Armatosura?

Akademia e Forcave të Armatosura përfaqëson sot një mjedis modern studimi dhe formimi profesional, ku të rinjtë kanë mundësinë të ndërtojnë një karrierë të sigurt dhe dinjitoze në shërbim të vendit. Ajo ofron programe studimi bashkëkohore, kampus të ri dhe infrastrukturë moderne, si dhe një trajtim serioz dhe të vlerësuar për studentët, si në aspektin akademik ashtu edhe në atë njerëzor. Të rinjtë që zgjedhin Akademinë përfitojnë një lidhje të drejtpërdrejtë me teorinë dhe praktikën, përmes përgatitjes ushtarake, angazhimeve praktike dhe bashkëpunimit ndërkombëtar në fusha si mbrojtja, marrëdhëniet ndërkombëtare dhe teknologjia e informacionit, sipas programeve që Akademia ofron. Paralelisht, studentët trajtohen në mënyrë dinjitoze edhe financiarisht gjatë periudhës së studimeve, duke pasur një perspektivë të qartë dhe të qëndrueshme për një karrierë të sigurt në Forcat e Armatosura dhe më gjerë. Akademia është një ftesë e hapur për të rinjtë me vullnet, integritet dhe ambicie, që dëshirojnë të investojnë tek vetja, të formohen profesionalisht dhe të kontribuojnë me përgjegjësi për sigurinë dhe të ardhmen e Republikës së Shqipërisë.



NJË TRASHËGIMI
QË FRYMËZON -
INTERVISTË ME
Z. ARBEN SKËNDERAJ,
DREJTOR I QENDRËS
SË KULTURËS, MEDIAS
DHE BOTIMEVE
NË MINISTRINË E
MBROJTJES

Arben Skënderaj:

MUZIKA DHE KULTURA, FORCA QË
BASHKON UNIFORMËN ME SHPIRTIN

Në një intervistë ekskluzive për shtypin ushtarak, **z. Arben Skënderaj**, Drejtor i **Qendrës së Kulturës, Medias dhe Botimeve** në Ministrinë e Mbrojtjes, sjell në vëmendje historinë, rolin dhe rëndësinë e këtij institucioni që prej themelimit të tij në nëntor të vitit **1949** e deri në ditët e sotme.

Dikur i njohur me emrin **SHQUP**, ky institucion ka qenë një vatër e rëndësishme e jetës kulturore dhe artistike të Forcave të Armatosura. Nën strukturën e tij funksiononin **Ansambli i Ushtrisë, Estrada e Ushtarit, Orkestra Frymore**, si dhe organizoheshin aktivitete metodike në garnizonin e Tiranës e ndihma metodike në shkallë ushtrie.

Në kulmin e veprimtarisë së tij, qendra numëronte mbi **300 punonjës artistë**, mes të cilëve një **kor me 60 këngëtarë**, një **kompleks vokal me 16 anëtarë**, një **grup vallesh me 12 çifte**, **orkestra me 33 instrumentistë**, **6 solistë** dhe një **sektor ndihmës me 8 punonjës**.

Në vijim, **z. Skënderaj** ndalet tek momentet më të rëndësishme të historikut të qendrës, kontributi i saj në jetën kulturore të ushtrisë dhe mënyra se si tradita artistike ushtarake po përshtatet me realitetin modern të Forcave të Armatosura.

Z. Skënderaj, Qendra e Kulturës, Medias dhe Botimeve ka një histori të gjatë që nis që në vitin 1949. Si do ta përshkruanit rrugëtimin e saj nga SHQUP-i i dikurshëm deri te QKMBM-ja e sotme?

Historia e kësaj qendre është, në fakt, historia e shpirtit krijues të ushtrisë shqiptare. Që nga themelimi në nëntor të vitit 1949, SHQUP-i ka qenë një qendër ku arti dhe kultura u ndërthurën me disiplinën dhe përkushtimin ushtarak. Aty u formuan breza të tërë artistësh që dhanë kontribut të jashtëzakonshëm në artin skenik, muzikor dhe koreografik të vendit. Sot, si Qendër e Kulturës, Medias dhe Botimeve, ne kemi ruajtur atë frymë, por e kemi përshtatur me kohën, me teknologjinë dhe me misionin modern të Forcave të Armatosura.

Cili ka qenë roli kryesor i këtij institucioni në formimin kulturor dhe shpirtëror të ushtarakëve ndër vite?

Kultura ka qenë gjithmonë një shtyllë e rëndësishme e moralit ushtarak. Përmes artit, ushtarakët kanë gjetur mënyra për të shprehur emocione, për të ndërtuar unitet dhe për të forcuar ndjenjën e përkatësisë. Në çdo kohë, aktivitetet tona kanë synuar të krijojnë një klimë pozitive dhe frymë bashkëpunimi mes efektivëve, duke i kujtuar se shërbimi ndaj atdheut nuk është vetëm detyrë, por edhe nder e dashuri.

Në përbërje të qendrës dikur ishin struktura të rëndësishme artistike si Ansambli i Ushtrisë, Estrada e Ushtarit dhe Orkestra Frymore. Si kujtohen këto trupa sot dhe çfarë ndikimi lanë në kulturën shqiptare?

Këto trupa ishin ambasadorë të kulturës shqiptare. Me performancat e tyre në qytete, fshatra, garnizone e madje edhe jashtë vendit, ata mbollën dashurinë për artin e pastër shqiptar. Shumë artistë të njohur kanë nisur rrugëtimin e tyre pikërisht në Ansamblin e Ushtrisë. Sot ne i kujtojmë me respekt, dhe përpiqemi t'i mbajmë gjallë ato tradita përmes festivaleve, ekspozitave dhe projekteve artistike që lidhen me trashëgiminë e tyre.

Si është përshtatur Qendra me kohën dhe me ndryshimet që ka sjellë modernizimi i Forcave të Armatosura?

Transformimi ka qenë i domosdoshëm. Sot kemi një qendër që jo vetëm prodhon veprimtari kulturore, por edhe menaxhon median, botimet dhe komunikimin institucional të Ministrisë së Mbrojtjes. Përdorim teknologjinë moderne në çdo aspekt të punës sonë. Qëllimi është që kultura të mos mbetet në të kaluarën, por të ecë paralelisht me zhvillimin e ushtrisë.

Kontributi i QKMBM-së dhe Ministrisë së Mbrojtjes në Zhvillimin e Talenteve të Fëmijëve të Ushtarakëve

Cili është roli i QKMBM-së në edukimin, formimin dhe trajnimin e fëmijëve të ushtarakëve?

QKMBM ka si mision kryesor të ofrojë edukim dhe trajnim të plotë për fëmijët e ushtarakëve. Qendra ofron programe kulturore, artistike dhe sportive, duke i ndihmuar fëmijët të zhvillojnë aftësitë e tyre dhe të integrohen në mënyrë aktive në komunitetin ushtarak dhe shoqëror.

Çfarë ofron kjo qendër për fëmijët e ushtarakëve?

Qendra ofron kurse muzike, pikturë, dhe sporte të ndryshme. Gjithashtu, organizon aktivitete kulturore, ekspozita, gara sportive dhe trajnime të specializuara, duke u siguruar që fëmijët të zhvillojnë talentet e tyre në një ambient mbështetës dhe profesional.

Si ka qenë ndihma e Ministrisë së Mbrojtjes për përkrahjen e këtyre talenteve?

Ministria e Mbrojtjes ka mbështetur QKMBM-në, duke siguruar fondet për materiale, mësues dhe trajnerë të specializuar. Ajo gjithashtu sponsorizon pjesëmarrjen e fëmijëve në konkurse dhe aktivitete jashtë vendit, duke i dhënë mundësi të rriten profesionalisht dhe të shfaqin talentet e tyre.

Si ka kontribuar Ministria e Mbrojtjes në zhvillimin e kurseve dhe ngritjen e nivelit të trajnimeve?

Ministria ka ndihmuar në përmirësimin e kurrikulave, trajnimin e stafit dhe pajisjen e qendrës me teknologji moderne. Kjo ka mundësuar që kurset të jenë më të strukturuar, profesionale dhe të përshtatura për zhvillimin maksimal të fëmijëve.

Cilat janë disa nga projektet apo aktivitetet më të rëndësishme që Qendra ka zhvilluar vitet e fundit për të ruajtur dhe promovuar traditën kulturore ushtarake?

Janë shumë, por do veçoja disa që kanë pasur ndikim të madh: rikthimin e ekspozitave me temë ushtarake, publikimin e monografive historike dhe organizimin e koncerteve me temë patriotike në bashkëpunim me ansamble e shkolla arti. Gjithashtu, kemi forcuar rolin e revistës ushtarake dhe mediave tona online, që sot janë platforma serioze për informacion dhe kulturë.

A ka bashkëpunime me institucione të tjera kulturore brenda dhe jashtë vendit, dhe sa ndihmojnë këto në forcimin e imazhit të ushtrisë shqiptare?

Po, dhe kjo është një pjesë shumë e rëndësishme e punës sonë. Ne bashkëpunojmë me institucione kulturore kombëtare, me Akademinë e Arteve, me arkivat dhe muzeumet e vendit, por edhe me partnerë ndërkombëtarë. Këto bashkëpunime na ndihmojnë të tregojmë fytyrën e vërtetë të ushtrisë shqiptare, një ushtri moderne, humane dhe e lidhur ngushtë me kulturën dhe vlerat kombëtare.

Cili është mesazhi juaj për artistët ushtarakë të rinj dhe për ata që duan të kontribuojnë në trashëgiminë kulturore të Forcave të Armatosura?

Do t'u thosha të mos ndalen së krijuari. Arti është një mënyrë e bukur për t'i shërbyer atdheut. Tradita që kemi trashëguar është e pasur, por ajo ka nevojë të ringjallet në çdo brez me frymë të re. Forcat e Armatosura nuk janë vetëm uniformë dhe detyrë, por janë edhe zemër, shpirt, ndjenjë. Dhe këto ndjenja i mbart arti më mirë se çdo gjë tjetër.

Biseda me z. Arben Skënderaj sjell një vështrim të çmuar mbi një nga institucionet më me traditë të kulturës ushtarake shqiptare. Nga rrënjët e saj në vitet e pasluftës, deri te roli bashkëkohor në promovimin e vlerave të artit dhe medias në Forcat e Armatosura, Qendra e Kulturës, Medias dhe Botimeve mbetet një urë lidhëse mes historisë dhe së ardhmes. Falë përkushtimit të stafit dhe mbështetjes institucionale, kjo qendër vazhdon të mbajë gjallë shpirtin krijues të artistëve ushtarakë dhe të promovojë kulturën shqiptare me dinjitet e profesionalizëm. Trashëgimia e dikurshme, tashmë shndërrohet në një frymë të re, atë të një institucioni modern që ruan kujtesën, por edhe ecën me ritmet e kohës.

FALEMINDERIT!



MIRËNJOHJE QË FORCON MISIONIN

Një nismë me vlerë institucionale dhe njerëzore

Në kuadër të kujdesit të vazhdueshëm për personelin e Forcave të Armatosura dhe familjet e tyre, ministri i Mbrojtjes, z. Pirro Vengu, ndërmori një vizitë të posaçme në Novo Selo, ku efektivë të Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë shërbejnë në mision ndërkombëtar. Kjo vizitë u shoqërua nga një udhëtim i organizuar për familjarët e efektiveve, prindër, bashkëshortë dhe fëmijë si shprehje mirënjohjeje për përkushtimin dhe sakrificën e tyre të vazhdueshme.

Nisma përfaqëson një qasje të konsoliduar institucionale, ku përkujdesja për familjen e ushtarakut konsiderohet pjesë përbërëse e forcimit të kapaciteteve morale dhe profesionale të trupave shqiptare në mision.

Forcat e Armatosura në mision: Profesionalizëm dhe përgjegjësi

Angazhimi i Forcave të Armatosura të Shqipërisë në misione ndërkombëtare është dëshmi e qartë e rolit aktiv të vendit tonë në arkitekturën e sigurisë kolektive. Trupat shqiptare në Novo Selo përfaqësojnë standarde të larta profesionale, disiplinë operative dhe bashkëpunim efektiv me partnerët aleatë.

Në këtë kontekst, prania e familjarëve në bazën ku shërbejnë efektivët solli një dimension të ri: **afërsinë njerëzore me realitetin e shërbimit ushtarak**, duke krijuar një urë komunikimi dhe mirëkuptimi ndërmjet misionit dhe jetës familjare.

Familja, shtyllë morale e efektivit

Pas çdo ushtaraku që shërben jashtë vendit, qëndron një familje që përballon ndarjen, ankthin dhe pritjen. Prindërit që rriten me sakrificë bijtë dhe bijat e tyre, bashkëshortët që mbajnë mbi supe përgjegjësitë e përditshme dhe

fëmijët që rriten me mungesën e prindit, janë pjesë e pandashme e këtij misioni.

Udhëtimi drejt Novo Selos u konceptua pikërisht për të:

- vlerësuar rolin e familjes në suksesin e misionit,
- forcuar mbështetjen morale për efektivët,
- rritur transparencën mbi kushtet e shërbimit.

Pamjet e takimeve, përqafimeve dhe komunikimit të drejtpërdrejtë dëshmojnë se morali i trupave rritet ndjeshëm kur familja bëhet pjesë e përjetimit të misionit.





Gjatë vizitës, ministri i Mbrojtjes, z. Pirro Vengu, theksoi se përkushtimi i efektivëve shqiptarë në misione ndërkombëtare është i lidhur ngushtë me mbështetjen që ata marrin nga familjet e tyre.

Ai nënvizoi se: "Forcat e Armatosura janë më të forta kur pas çdo efektivit qëndron një familje e mbështetur dhe e vlerësuar. Ky udhëtim është një shprehje respekti për sakrificën e përbashkët".

Ministri vlerësoi gjithashtu profesionalizmin e trupave në Novo Selo dhe rolin e tyre në forcimin e imazhit të Shqipërisë si një partner i besueshëm në misionet ndërkombëtare të sigurisë.

Novo Selo, realiteti i përditshëm i misionit

Baza ku shërbejnë trupat shqiptare në Novo Selo përfaqëson një mjedis operativ të ndërtuar mbi rregull, bashkëpunim dhe gatishmëri të lartë. Vizita e familjarëve u shoqërua me prezantimin e kushteve të jetesës dhe shërbimit, duke krijuar një panoramë më të qartë për realitetin e përditshëm të efektivëve.

Ky proces ndihmon në:

- uljen e pasigurive të familjarëve,
- rritjen e besimit ndaj institucionit,
- forcimin e lidhjes emocionale mes efektivit dhe familjes.

Një ushtri moderne, me fokus te njeriu

Forcat e Armatosura të Shqipërisë po konsolidojnë gjithnjë e më shumë modelin e një ushtrie moderne, ku zhvillimi profesional shoqërohet me kujdes social dhe njerëzor. Politikat e mbështetjes për familjet e ushtarakëve janë pjesë e strategjisë afatgjatë për rritjen e motivimit dhe qëndrueshmërisë morale të trupave.

Ky udhëtim për familjarët në Novo Selo përfaqëson një praktikë të mirë institucionale, e cila përforcon ndjenjën e përkatësisë dhe përgjegjësisë kolektive.

Mesazh për të ardhmen

Iniciativa të tilla përcjellin një mesazh të qartë: shteti shqiptar vlerëson jo vetëm shërbimin e efektivit në terren, por edhe sakrificën e familjes së tij. Në një realitet ku angazhimet ndërkombëtare kërkojnë përgatitje të lartë dhe përballje me sfida komplekse, mbështetja morale mbetet një faktor kyç i suksesit.

Vizita në Novo Selo dhe udhëtimi i organizuar për familjarët e efektivëve përbëjnë një akt domethënës mirënjohjeje dhe respekti institucional. Ajo dëshmon se Forcat e Armatosura të Republikës së Shqipërisë janë një institucion që ndërton fuqinë e vet mbi profesionalizëm, disiplinë dhe vlera njerëzore.



Sepse pas çdo misioni të suksesshëm, qëndron një sakrificë e përbashkët ajo e ushtarakut dhe e familjes së tij.

KAMPUSI I SË ARDHMES

Akademia e Forcave të Armatosura,
investimi strategjik që ndryshon
fytyrën e arsimit ushtarak shqiptar

Investimi strategjik që formëson elitën ushtarake dhe akademike të Shqipërisë së të ardhmes

Nga një akademi kombëtare drejt një qendre ekselence të NATO-s

Në periferi të Tiranës, në një hapësirë prej 10 hektarësh, ku gjelbërimi mbizotëron mbi betonin dhe vizioni mbi improvizimin, po shkon drejt përfundimit **Kampusi i ri i Akademisë së Forcave të Armatosura (AFA)**. Një investim madhor i qeverisë shqiptare, i konceptuar jo vetëm si projekt ndërtimor, por si **strategji afatgjatë për sigurinë kombëtare, arsimin e lartë dhe integrimin euroatlantik**.

I frymëzuar nga modeli i akademive më elitare në botë, veçanërisht **"West Point" – Akademia Ushtarake e Shteteve të Bashkuara**, kampusi i ri shënon një epokë të re për arsimin ushtarak shqiptar, duke e nxjerrë atë nga kufijtë tradicionalë dhe duke e pozicionuar si partner serioz në arkitekturën arsimore dhe ushtarake të NATO-s.

NJË KAMPUS QË NDËRTOHET ME STANDARDE TË NATO-S

Që në fazën e projektimit, kampusi është konceptuar sipas **standardeve më të larta të NATO-s**, si në aspektin e infrastrukturës, ashtu edhe në filozofinë e funksionimit. Çdo godinë, çdo hapësirë dhe çdo shteg është menduar

për të shërbyer një qëllim të vetëm: **formimin e oficerit modern**, të pajisur me dije akademike, aftësi teknologjike dhe karakter të fortë moral.

Në përbërje të kampusit përfshihen:

- godina mësimore inteligjente, të pajisura me teknologji digjitale dhe laboratorë modernë;
- konvikte bashkëkohore për studentët dhe kursantët;
- qendër shëndetësore me shërbim 24-orësh;
- kinema dhe ambiente kulturore për jetën sociale;
- palestër multifunksionale dhe pishinë e mbyllur;
- terrene sportive për futboll, volejbol, atletikë;
- poligone stërvitjeje ushtarake në natyrë;
- pistë profesionale vrapimi;
- kullë alpinizmi për stërvitje fizike dhe psikologjike.

Ky kompleks nuk është thjesht funksional; ai krijon **një mjedis jetese dhe formimi**, ku studenti nuk është vizitor, por pjesë e një komuniteti të strukturuar.

AKADEMIA, KU DIJA TAKON DISIPLINËN


Akademia e Forcave të Armatosura ka qenë historikisht institucioni që ka formuar shtyllën profesionale të ushtrisë shqiptare. Me kampusin e ri, ky rol jo vetëm forcohet, por **zgjerohet ndjeshëm**.

Në fazën e parë, Akademia do të ketë rreth **300 studentë**, të ndarë në programe bachelor dhe master, por kapacitetet infrastrukturore janë ndërtuar për zgjerim të mëtejshëm. Risia më e madhe lidhet me **hapjen e degëve të reja**, të orientuara drejt sfidave moderne të sigurisë.

Për herë të parë, në një akademi ushtarake shqiptare, do të ofrohen programe studimi në:

- Inteligjencë Artificiale
- Sisteme të avancuara të komandimit dhe kontrollit
- Siguri kibernetike dhe mbrojtje digjitale
- Teknologji të informacionit të aplikuara në fushën ushtarake

Këto programe do të realizohen edhe përmes **diplomave të përbashkëta me Universitetin Politeknik**, duke krijuar një urë të qëndrueshme mes arsimit ushtarak dhe atij civil-teknologjik.



BINJAKËZIMI NDËRKOMBËTAR, NGA ALEANCË NË EKSPERIENCË TË PËRBASHKËT

Një nga shtyllat kryesore të projektit është **binjakëzimi i Akademisë së Forcave të Armatosura me akademi të vendeve aleate të NATO-s**. Ky binjakëzim nuk është formal, por praktik dhe i matshëm.

Ai përfshin:

- shkëmbime studentësh dhe pedagogësh,
- programe të përbashkëta studimi,
- stërvitje dhe kurse të integruara,
- certifikime ndërkombëtare,
- harmonizim të plotë të kurrikulave akademike.

Në këtë mënyrë, Akademia shqiptare kalon nga një institucion kombëtar në një **aktor rajonal dhe aleat**, që prodhon dije dhe eksperiencë të përdorshme për misionet e përbashkëta të NATO-s.

NATYRA SI ALEATE E EDUKIMIT USHTARAK

Një veçori që e dallon këtë kampus nga shumica e institucioneve arsimore në Shqipëri është **dominimi i natyrës në tërësinë e pronës**. Arkitektura është e ulët, e hapur dhe e ndërthurur me gjelbërimin, duke krijuar një ambient ku stërvitja fizike dhe mendore zhvillohet në harmoni me mjedisin.

Ekspertët e projektit theksojnë se ky është ndër të paktët kampuse në vend ku:

- natyra nuk është zbulurim, por pjesë e konceptit,
- stërvitja në terren është pjesë e përditshmërisë,
- formimi fizik lidhet ngushtë me qëndrueshmërinë psikologjike.

Kjo qasje përputhet me doktrinën moderne ushtarake, ku oficeri nuk përgatitet vetëm në auditor, por edhe në mjedise reale, të ndryshueshme dhe sfiduese.

FORCAT E ARMATOSURA, PUNA QË NUK SHIHET, POR NDIHET

Në qendër të këtij investimi janë **njerëzit e Akademisë së Forcave të Armatosura**, që çdo ditë ndërtojnë profesionalizëm përmes punës së heshtur.

Akademia e re forcon më tej rolin e Forcave të Armatosura shqiptare si:

- institucion profesional dhe modern,
- kontribuues i besueshëm në misionet ndërkombëtare,
- faktor stabiliteti në rajon.

Puna që kryhet brenda mureve të kësaj Akademie nuk prodhon tituj të përditshëm, por **siguri afatgjatë**, standarde dhe dinjitet institucional.

INVESTIM STRATEGJIK, JO THJESHT INFRASTRUKTURË

Kampusi i ri i Akademisë së Forcave të Armatosura është një **mesazh i qartë politik dhe strategjik**:

Shqipëria investon tek dija, tek teknologjia, tek aleanca dhe tek brezi që do të mbrojtë të ardhmen e saj.

Ky projekt nuk ndërtohet vetëm me fonde publike, por me:

- vizion afatgjatë,
- përgjegjësi institucionale,
- orientim të qartë euroatlantik.

Ky kampus nuk është vetëm një hapësirë fizike. Është një **institucion i së ardhmes**, ku formohet mendimi strategjik, karakteri dhe profesionalizmi i atyre që do të mbajnë mbi supe sigurinë e Republikës së Shqipërisë.

105 VJET

ARMA E ARTILERISË SË
USHTRISË SHQIPTARE

1921 — 2026

***Nga topat e Luftës së Vlorës te arma
më teknike e mbrojtjes kombëtare***





Eduard Demo

17 Janar 1921 – Themeli i institucionalizimit të Artilerisë Shqiptare

Më 17 janar 1921, u shënua një nga momentet më të rëndësishme në historinë e Forcave të Armatosura Shqiptare: **krijimi zyrtar i Armës së Artilerisë si armë e veçantë e Ushtrisë Kombëtare Shqiptare**. Kjo datë nuk përfaqëson thjesht një akt administrativ, por **institucionalizimin e një arme kyçe**, që dëshmonte pjekurinë e shtetit shqiptar për të ndërtuar një ushtri të rregullt, funksionale dhe moderne sipas standardeve të kohës.

Krijimi i Artilerisë erdhi si rrjedhojë e drejtpërdrejtë e **Luftës Kombëtare të Vlorës (1920)**, ku përdorimi i artilerisë, ndonëse i kufizuar, rezultoi vendimtar. Po ashtu, ky akt u mbështet mbi konsolidimin e institucioneve shtetërore të dala nga **Kongresi i Lushnjës**, që riktheu sovranitetin politik, administrativ dhe ushtarak të Shqipërisë.

ARTILERIA NË LUFTËN E VLORËS, SHKOLLA E PARË LUFTARAKE

Lufta e Vlorës ishte prova e parë reale ku shqiptarët përdorën artilerinë në funksion kombëtar. Në radhët e forcave vullnetare veproun **oficerë artiljerë të formuar në Perandorinë Osmane**, ndër të cilët spikatën figura si:

- Abdurrahman Çiraku
- Azis Çami

Topat e përdorur ishin kryesisht **të kapur nga ushtria italiane**, si dhe armatim i vjetër osman. Megjithatë, rëndësia nuk qëndronte te teknologjia, por te **përdorimi i organizuar dhe profesional i zjarrit**, që ndikoi drejtpërdrejt në suksesin ushtarak dhe në largimin e forcave pushtuese.

Përvoja e fituar në Vlorë u shndërrua në bazë doktrinale për krijimin e artilerisë së rregullt shqiptare.

ARTILERIA E VITIT 1921 – MODESTE NË MJETE, MADHËSHTORE NË MISION

Në vitin 1921, Artileria e Ushtrisë Shqiptare ishte:

- e varfër në armatim,
- me personel të kufizuar,
- pa infrastrukturë moderne,
- pa akademi ushtarake të mirëfilltë.

Ajo përbëhej nga:

- topa fushorë të lehtë,
- topa të periudhës osmane,
- bateri artilerie pranë njësive këmbësore,
- karroca me kuaj për transport,
- trajnim praktik, bazik.

Megjithatë, **roli shtetformues i Artilerisë ishte i jashtëzakonshëm**. Ajo simbolizonte kalimin nga lufta popullore spontane në **ushtri kombëtare të organizuar**, me hierarki, komandë dhe rregullore.

KOMANDANTI I PARË, KAPITEN REXHEP MITROVICA

Komandanti i parë i Armës së Artilerisë ishte **Kapiten Rexhep Mitrovica**, një oficer me formim të plotë profesional.

- I diplomuar në Inxhinieri Mekanike në Universitetin e Stambollit;
- I përgatitur në shkollën e Artilerisë;
- Me përvojë në konfliktet e mëparshme.

Nën drejtimin e tij u hodhën themele:

- të strukturës komanduese,
- të disiplinës ushtarake,
- të përdorimit teknik të artilerisë.

Ai konsiderohet arkitekti i parë profesional i kësaj arme.

ARTILERIA NË LUFTËN NACIONAL-ÇLIRIMTARE

Gjatë Luftës së Dytë Botërore, Ushtria Nacional-Çlirimtare ndërtoi një **bërthamë solide të artilerisë**, e cila u trashëguar nga Ushtria Shqiptare pas vitit 1944.

Komandantë dhe komisarë të shquar:

- **Hulusi Spahiu**
- **Todi Naço**
- **Irfan Peshtani**
- **Abdurraman Guri**
- **Aleks Spiro**

Në janar 1945, **Hulusi Spahiu** emërohet Komandant i Komandës së Artilerisë pranë Komandës së Përgjithshme.

PERIUDHA 1945–1990 – FUQIZIMI DHE MODERNIZIMI

Në 45 vitet pas Luftës së Dytë Botërore, Artileria Shqiptare u shndërrua në **një nga armët më të fuqishme të ushtrisë**.

Armatimi:

- Topa 76 mm – 152 mm
- Mortaja 60 mm – 160 mm
- Topa kundërtank 75 mm
- Artileri vetëlëvizëse
- Raketa Tok–Tokë dhe Tok–Ajër

Organizimi:

- Top (mortajë)
- Bateri
- Grup Artilerie
- Brigadë Artilerie (6 grupe)
- Grupe Autonome në vartësi të Korpusit/Divizionit



ADZAKA

- Mbrojtje e objekteve strategjike

Artileria Bregdetare

- Distançë qitjeje deri në 30 km
- Aparatura moderne drejtimi
- Kontroll i hapësirës detare

FIGURA TË SHQUARA TË ARTILERISË MODERNE

Ndër emrat më të spikatur: Mustafa Novi, Sul Domi, Niko Hoxha, Baçella Havari, Rahim Allaçi, Dilaver Goxhaj, Rustem Peçi, Novruz Osmani, Petraq Kita, Nebi Çela, Arqile Lushnjari, Namik Çobo.

Këta oficerë kontribuan në:

- doktrinën luftarake,
- stërvitjen,
- profesionalizmin e artillerisë.

ARTILERIA – SOT, TRASHËGIMI DHE NDERIM

Arma e Artillerisë mbetet **simbol i fuqisë, profesionalizmit dhe mbrojtjes kombëtare**. Ajo ka kaluar nga topat e kapur të Vlorës në një armë të organizuar, të disiplinuar dhe teknike.

Grupimi i Ushtrakëve në Lirim dhe Rezervë e përkujton këtë 105-vjetor jubilar me aktivitete përkujtimore dhe minikonferencë historike.

Nderim dhe respekt për të gjithë artiljerët shqiptarë ndër breza!

Lavdi Armës së Artillerisë së Ushtrisë Shqiptare!



PROVOKACIONET E GUSHTIT 1949 – PROVA E ZJARRIT

Në gusht 1949, Artileria Shqiptare dëshmoi vlerën e saj luftarake reale gjatë provokacioneve të forcave **monarko-fashiste greke**.

Zjarri i saktë dhe i përqendruar i artillerisë:

- mbështeti kundërsulmin e forcave tona,
- siguroi fitoren,
- forcoi sovranitetin territorial.

ARTILERIA KUNDËRAJRORE DHE BREGDETARE

Artileria Kundërajrore

- Topa të kalibrave të vegjël
- Sisteme me drejtim zjarri





POLICIA USHTARAKE, 34 VITE NË SHËRBBIM TË RENDIT, LIGJIT DHE SIGURISË KOMBËTARE

Një histori profesionalizmi, sakrifice dhe përkushtimi në Forcat e Armatosura të Republikës së Shqipërisë

Policia Ushtarake e Forcave të Armatosura Shqiptare feston 33-vjetorin e krijimit të saj, një përvjetor domethënës që shënon jo vetëm rrugëtimin historik të një strukture elitare, por edhe kontributin e saj të pazëvendësueshëm në forcimin e rendit ushtarak, shtetit ligjor dhe sigurisë kombëtare.

Gjatë më shumë se tre dekadave, Policia Ushtarake (PU) ka dëshmuar profesionalizëm, disiplinë dhe besnikëri ndaj misionit kushtetues, duke u shndërruar në një nga repartet më elitare të Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë (FARSH).

THEMELIMI DHE VIZIONI FILLESTAR (1992–1994)

Policia Ushtarake e FARSH u formua, më **1 shkurt 1992**, në një periudhë transformimi të thellë politik, shoqëror dhe institucional të vendit. Pas viteve '90, Shqipëria nisi një proces reformash rrënjësore edhe në Forcat e Armatosura, duke synuar modernizimin dhe përafrimin e tyre me standardet e vendeve anëtare të NATO-s.

Në këtë kuadër, krijimi i Policisë Ushtarake u pa si një domosdoshmëri për:

- forcimin e disiplinës ushtarake,
- garantimin e zbatimit të ligjit në FA,
- vendosjen e një strukture profesionale të rendit ushtarak.



Fillimisht, objekti i punës së PU-së ishte kontrolli i trafikut ushtarak dhe ruajtja e rendit brenda FA-së, me synim rritjen e disiplinës dhe përgjegjshmërisë ushtarake.

KONSOLIDIMI INSTITUCIONAL DHE ZGJERIMI I MISIONIT (1994–1997)

Në dhjetor të vitit 1994, me **Urdhrin nr. 482, datë 10.12.1994 të Ministrisë së Mbrojtjes**, "Për organizimin e Policisë Ushtarake", strukturës së PU-së iu bashkëngjijtën:

- Policia Kriminale Ushtarake
- Mbrojtja nga Zjarri

Në fillim të vitit 1995, Policia Ushtarake u transformua në **Drejtori të PU-së**, me drejtor gjeneral brigade **Bajram Malaj**. Kjo periudhë shënoi një rritje të ndjeshme të kapaciteteve organizative dhe profesionale të strukturës.

Pas ngjarjeve të vitit 1997, drejtimi i Drejtorisë së PU-së iu besua kolonel **Piro Lutaj**, në një nga momentet më të vështira për shtetin shqiptar dhe Forcat e Armatosura.

RILINDJA DHE MODELI ITALIAN – BATALIONI I TIRANËS (1997–1999)

Pas krizës së vitit 1997, Policia Ushtarake përjetoi një rritje të jashtëzakonshme falë një projekti madhor me **Delegacionin Italian të Ekspertëve (DIE)**. Për herë të parë, me asistencën e specialistëve italianë, u krijua **Batalioni i Policisë Ushtarake në Tiranë**, i konceptuar sipas modelit të **Karabinierisë Italiane**.

Ky batalion u kompletua me:

- bazë moderne materiale dhe logjistike,
- automjete të blinduara **IVECO-90**,
- trajnim profesional të standardeve perëndimore.

Gjatë ngjarjeve të vitit 1998, PU tregoi qëndrueshmëri të jashtëzakonshme, duke marrë në ruajtje institucione kyçe të shtetit si:

- Radio Televizioni Shqiptar,
- Telekomi Shqiptar,
- Prokuroria e Përgjithshme,
- institucione ndërkombëtare.

Në këtë periudhë, PU ishte një nga institucionet më moderne dhe më funksionale në vend, duke luajtur rol të pazëvendësueshëm në rivendosjen e shtetit ligjor.

KRIZA E KOSOVËS – PROVA E MADHE (1999)

Viti 1999 shënoi një tjetër moment historik për Policinë Ushtarake gjatë krizës së Kosovës. PU mbajti peshën kryesore në:

- pritjen dhe shoqërimin e refugjatëve kosovarë,
- sigurimin e kampeve në Kukës, Tiranë, Durrës dhe qytete të tjera,
- mbajtjen nën kontroll të situatës në zonat kufitare Kukës–Tropojë,
- shoqërimin e autokolonave humanitare dhe personaliteteve të larta,
- kontrollin e rrjetit rrugor, veçanërisht në veri të vendit.

Ngjarjet e viteve **1997, 1998 dhe 1999** mbeten ndër më të rëndësishmet në historinë e Policisë Ushtarake.

KORNIZA LIGJORE DHE RIORGANIZIMI STRUKTUROR (2000–2008)

Veprimtaria e PU-së u mbështet fuqimisht në miratimin e: **Ligjit nr. 8404, datë 15.09.1998**, shtesë e Ligjit nr. 7978 “Për FARSH”.

Në fund të vitit 2000, me suprimimin e Drejtorisë së PU-së, u krijua **Regjimenti i Policisë Ushtarake** (Urdhër nr.1, datë 05.01.2001), me komandant nënkolonel **Namik Goga**.

Në vitin 2003, struktura u transformua në **batalion**, me komandantë radhazi:

- nënkolonel **Xhevahir Abdia** (2003–2005),
- nënkolonel **Drini Nikolla** (2005–2008),
- kolonel **Xhevdet Zeneli** (nga 2008).

PU NË EPOKËN E NATO-s DHE MISIONET NDËRKOMBËTARE

Me miratimin e Ligjit nr. 9069, datë 15.05.2003 “Për Policinë Ushtarake në FARSH”, PU pësoi një rishikim të plotë.

Personeli u arsimua dhe u trajnuar në vende anëtare të NATO-s si:

- Itali,
- Turqi,
- Gjermani,
- SHBA.

PU ka qenë pjesë aktive e:

NRF (NATO Response Force) – me një togë të certifikuar, operacionit **ISAF në Kabul, Afganistan**, me një kontingjent prej 22 efektivësh.

MISIONI DHE DETYRAT KRYESORE TË POLICISË USHTARAKE

Sot, Policia Ushtarake është e përgatitur të veprojë në të gjithë spektrin e misionit të saj, duke përfshirë:

- Ruajtjen e rendit ushtarak në FARSH;
- Zbulimin, parandalimin dhe ndjekjen e veprimtarisë kriminale;
- Luftën kundër terrorizmit në FA;
- Mbrojtjen e jetës, dinjitetit dhe pronës shtetërore;
- Sigurimin e stërvitjeve, ceremonive dhe veprimtarive ushtarake;
- Shoqërimin e personaliteteve të larta ushtarake dhe delegacioneve të huaja;
- Zbatimin e vendimeve të gjykatave dhe prokurorisë ushtarake;
- Mbështetjen e operacioneve humanitare dhe emergjencave civile;
- Mbështetjen e forcave shqiptare jashtë vendit dhe forcave të huaja në Shqipëri.

Në 34 vite ekzistencë, Policia Ushtarake ka ndërtuar një traditë solide profesionalizmi, besnikërie dhe sakrifice. Ajo mbetet një shtyllë e fortë e Forcave të Armatosura dhe një garant i rendit, ligjit dhe sigurisë kombëtare.

Policia Ushtarake, 34 vite nder, përkushtim dhe shërbim ndaj atdheut.





USHTRIA SHQIPTARE, Garanci e Sigurisë dhe Nderit

Koha nuk matet vetëm me vite dhe data. Ajo matet me prova, sakrifica dhe gjurmë që mbeten. Në historinë e shtetit shqiptar, pak institucione kanë lënë gjurmë kaq të dukshme dhe të qëndrueshme sa **Forcat e Armatosura të Republikës së Shqipërisë**. Ato kanë qenë dëshmitare dhe pjesëmarrëse aktive në çdo fazë të rrugëtimit tonë shtetformues, nga vitet e para të konsolidimit të shtetit, te sfidat e tranzicionit dhe deri në angazhimin dinjitoz në misionet ndërkombëtare të sigurisë.

Forcat e Armatosura nuk janë thjesht një strukturë ushtarake. Ato janë **pasqyra e kohës**, e ndryshimeve shoqërore, politike dhe strategjike që ka përjetuar vendi. Çdo brez ushtarakësh ka lënë gjurmën e vet, duke e ndërtuar këtë institucion mbi themele disipline, përkushtimi dhe besnikërie ndaj atdheut.

Ushtria si garant i ekzistencës shtetërore

Në momentet më të vështira të historisë, kur shteti shqiptar ka qenë i brishtë dhe i rrezikuar, Forcat e Armatosura kanë qenë një nga shtyllat kryesore të ruajtjes së sovranitetit dhe integritetit territorial. Ato kanë përfaqësuar forcën e organizuar të shtetit, por edhe vullnetin për të mbijetuar si komb.

Në dekada, ushtria shqiptare ka kaluar nga një model mbrojtjeje statike, në një forcë moderne, fleksibile dhe të ndërveprueshme me aleatët. Ky transformim nuk ka qenë i lehtë. Ai ka kërkuar reforma të thella, sakrifica njerëzore dhe një ndryshim rrënjësor të mentalitetit ushtarak.

Nga izolimi te integrimi euroatlantik

Një nga gjurmët më domethënëse në kohë është rrugëtimi i Forcave të Armatosura drejt NATO-s. Anëtarësimi i Shqipërisë në Aleancën e Atlantikut të Veriut nuk ishte vetëm një akt politik, por një provë konkrete e profesionalizmit dhe besueshmërisë së ushtrisë shqiptare. Sot, efektivët shqiptarë shërbejnë krah për krah me aleatët në misione ndërkombëtare, duke kontribuar në sigurinë kolektive dhe duke përfaqësuar me dinjitet flamurin kombëtar. Ky angazhim ka shndërruar Forcat e Armatosura nga një forcë mbrojtëse kombëtare, në një **aktor aktiv të sigurisë globale**.

Gjurmët e këtij transformimi lexohen në standarde, në doktrina, në trajnime dhe mbi të gjitha në mentalitetin e ushtarakut shqiptar të sotëm.

Ushtria dhe shoqëria një lidhje e pandashme

Një tjetër gjurmë e thellë në kohë është raporti i Forcave të Armatosura me shoqërinë civile. Ushtria shqiptare nuk ka qenë kurrë një institucion i shkëputur nga qytetari. Përkundrazi, në momentet më kritike – përmbajtje, zjarre, tërmete, emergjenca civile – ajo ka qenë në vijën e parë të ndihmës.

Ndërhyrjet për shpëtim jete, rindërtim infrastrukture, vendosje urash, evakuime dhe ndihmë humanitare kanë forcuar besimin e qytetarëve dhe kanë treguar se ushtria është jo vetëm mbrojtëse e territorit, por edhe **mbrojtëse e jetës**.

Kjo prani e vazhdueshme në shërbim të komunitetit ka lënë gjurmë të prekshme në kujtesën kolektive të shoqërisë shqiptare.

Faktori njerëzor gjurma më e fortë

Në qendër të çdo transformimi qëndron njeriu.

Oficerët, nënoficerët, ushtarët dhe punonjësit civilë të Forcave të Armatosura janë ata që e mbajnë gjallë institucionin. Çdo uniformë mban brenda saj histori personale sakrifice, përgjegjësie dhe përkushtimi.

Gjurmët më të forta nuk janë gjithmonë të dukshme në dokumente apo struktura, por në **etikën e shërbimit**, në gatishmërinë për të vepruar, në besnikërinë ndaj misionit dhe atdheut.

Breza të tërë ushtarakësh kanë kontribuar që Forcat e Armatosura të jenë sot një institucion modern, i respektuar dhe i besueshëm.

Gjurmë që vazhdojnë të shkruhen


Historia e Forcave të Armatosura nuk është një kapitull i mbyllur. Ajo vazhdon të shkruhet çdo ditë, në stërvitje, në misione, në emergjenca, në proceset e modernizimit dhe në përgatitjen e brezave të rinj.

Në një realitet të sigurisë gjithnjë e më kompleks, ushtria shqiptare mbetet një garanci stabiliteti dhe një faktor kyç i sigurisë kombëtare dhe rajonale. Gjurmët e saj në kohë janë dëshmi se ky institucion ka ditur të përshtatet, të rritet dhe të ecë përpara, pa humbur thelbin e misionit të tij.

Forcat e Armatosura të Republikës së Shqipërisë janë një histori e gjallë e shtetit shqiptar. Gjurmët që ato kanë lënë në kohë janë të gdhendura në sigurinë e vendit, në besimin e qytetarëve dhe në respektin e aleatëve.

Ato janë dëshmia se koha nuk e fshin shërbimin e ndershëm, por e forcon atë. Dhe sa herë që historia do të kthejë kokën pas, do të gjejë aty, në çdo moment kyç, ushtrinë shqiptare në shërbim të atdheut.





SHQIPNIA

100

VJET FORCË
DETARE
SHQIPTARE

TRADITA NË DETARI – RRËNJËT ILIRE

Tradita detare shqiptare i ka rrënjët në lashtësi, në periudhën e ilirëve. Fiset më të njohura për zhvillimin e detarisë ishin japodët dhe sidomos liburnët, të cilët ndërtuan anijet e famshme **liburne (liburnide)** – mjete të shpejta dhe të manovrueshme që dominuan Adriatikut. Nën sundimin e mbretërve ilirë si **Agroni, Teuta dhe Genti**, fuqia detare ilire arriti kulmin e saj, duke kontrolluar rrugët tregtare dhe ushtarake të rajonit.

PAVARËSIA DHE HAPAT E PARË TË FORCËS DETARE (1912–1939)

Me **Shpalljen e Pavarësisë, më 28 Nëntor 1912**, në Vlorë, nën drejtimin e **Ismail Qemalit**, u hodhën themelet e shtetit shqiptar dhe filluan përpjekjet e para për organizimin e Forcës Detare.

(Foto nga akti i Pavarësisë në Vlorë, Afërdita)

Fillimi i Luftës së Parë Botërore ndërpreu këto përpjekje, por procesi rifilloi në vitin 1925, me miratimin e Statutit të Shtetit Shqiptar (7 mars 1925) dhe krijimin e Komandës së Përgjithshme të Fuqive.

Më 25 dhjetor 1925, Parlamenti miratoi buxhetin për blerjen e dy anijeve ushtarake 190 tonëshe nga Italia, të emëtuara:

- “Shqipnia”
- “Skënderbeg”

Katër studentë shqiptarë u dërguan për studime në Itali për të përgatitur kuadro marine – një hap i rëndësishëm drejt profesionalizimit të flotës

RINGRITJA PAS ÇLIRIMIT (1945–1960)

Çlirimi i Shqipërisë në vitin 1944 e gjeti flotën në gjendje të mjerueshme. Më 23 shkurt 1945, u krijua Seksioni i Marinës Ushtarake Shqiptare.

Shef i parë u emërua Kapiteni i Parë i Marinës, **Abdi Mati**.

Më 15 gusht 1945, u hodhën në ujë dy motoskafe trofe të riparuar (MS-10 dhe MS-12). Kjo datë konsiderohet si dita e ringritjes së Marinës Ushtarake Shqiptare. Po atë ditë u ngrit për herë të parë pas çlirimit flamuri i Marinës Luftarake Shqiptare.

EPOKA E NËNDETËSEVE DHE ZHVILLIMI INTENSIV (1958–1980)

Në shtator 1958 mbërritën në bazën e Pashalimanit katër nëndetëset e para. Më 17 shtator 1958, u ul flamuri sovjetik dhe u ngrit flamuri shqiptar në to.

Në vitin 1960 Brigadës së Nëndetëseve iu shtuan edhe 8 nëndetëse të tipit Projekti 613 (klasi “Whiskey”), duke e bërë Shqipërinë një nga vendet me kapacitet të konsiderueshëm nëndetar në rajon.

Po në vitin 1960 u hap Shkolla e Marinës në Vlorë (sot Akademia e Detarisë), që përgatiti breza të tërë oficerësh.

Periudha 1961–1980 shënoi:

- Pajisjen me katër siluruese moderne
- Krijimin e Shërbimit Hidrografik

- Ngritjen e fenerëve përgjatë gjithë bregdetit
- Modernizimin e pikave sinjalo-vrojtimore me radiolokatorë
- Forcimin e Kantierit Detar të Riparimit në Pashaliman

TRANZICIONI DHE HAPJA NDAJ NATO-s (1990–1997)

Pas vitit 1990, me rënien e sistemit komunist, Forca Detare u përball me sfidën e ristrukturimit dhe integritetit në strukturat euroatlantike.

U intensifikua bashkëpunimi me flotat perëndimore, veçanërisht me vendet e NATO-s, përmes stërvitjeve të përbashkëta:

- AREX I & II
- MAREX I & II

Kuadrot shqiptare treguan profesionalizëm të lartë dhe përgatitje të denjë.



RINGRITJA PAS KRIZËS SË VITIT 1997

Ngjarjet e marsit 1997 shkaktuan dëme të mëdha në Forcën Detare. Anijet u strehuan në Itali dhe, pas riparimeve, u rikthyen në Shqipëri.

Me ndihmën e partnerëve ndërkombëtarë:

- Në 1998, SHBA dhuroi 5 motovedeta.
- Në 2002, pas miratimit të Ligjit të Rojës Bregdetare, Italia dhuroi 6 motovedeta.
- Në qershor 2004, Italia dhuroi edhe 6 të tjera.

Në gusht 2002, 14 anije morën pjesë në operacionin antitrafik "PUNA", duke arritur sukses në bllokimin e trafikut të paligjshëm.

MODERNIZIMI DHE INTEGRIMI NË NATO

Anijet:

- "Iliria" (2008)
- "Oriku" (2011)
- "Lisus" (2012)
- "Butrinti" (2014)

"Iliria" u prodhuan në Holandë dhe mbërriti në Portin e Durrësit në gusht 2008, ndërsa tre të tjerat u ndërtuan në Pashaliman.

Anëtarësimi i Shqipërisë në **NATO**, në vitin 2009 i dha një impuls të ri modernizimit dhe rritjes së kapaciteteve operacionale.

Anijet shqiptare morën pjesë në misionet e NATO-s në Detin Egje për parandalimin e emigracionit të paligjshëm dhe trafikimit të qenieve njerëzore. "Oriku" u nis për herë të parë në këtë mision, më 11 nëntor 2011, me 21 detarë në bord.

NJË HAP I RI STRATEGJIK – KORVETA "LIBRA" (2025)

Në kuadër të modernizimit të vazhdueshëm, në vitin 2025 Qeveria Italiane i dhuroi Forcës Detare Shqiptare korvetën "Libra" të klasit "Cassiopea".

- Patrullim i avancuar detar
- Operacione kërkim-shpëtimi
- Luftë kundër trafikeve
- Mbështetje në operacione ndërkombëtare

100 vjet Forcë Detare Shqiptare përfaqësojnë:

- Trashëgimi ilire
- Sakrificë dhe përkushtim
- Profesionalizëm ushtarak
- Integrim euroatlantik
- Modernizim të vazhdueshëm



Nga liburnet ilire tek korveta moderne "Libra", Forca Detare Shqiptare mbetet një shtyllë e sigurisë kombëtare dhe një kontribuuese e denjë në arkitekturën e sigurisë ndërkombëtare.





REZOLUTA 1325

DHE FORCAT E ARMATOSURA TË SHQIPËRISË

INTERVISTOI: ANJEZA MUSOLLARI,
Shefe e Sektorit të Botimeve

Gratë, Paqja dhe Siguria si komponent i sigurisë kombëtare dhe angazhimeve euroatlantike

Angazhimi institucional i Shqipërisë në zbatimin e Rezolutës 1325

Republika e Shqipërisë, si anëtare e Kombeve të Bashkuara dhe e Aleancës së Atlantikut të Veriut (NATO), ka përqafuar dhe zbatuar parimet e Rezolutës 1325 të Këshillit të Sigurimit të OKB-së, duke i integruar ato në politikat kombëtare të sigurisë dhe mbrojtjes. Për Forcat e Armatosura të Shqipërisë, Rezoluta 1325 përbën një **udhëzim strategjik** që orienton:

- zhvillimin e burimeve njerëzore,
- planifikimin operacional,
- pjesëmarrjen në misionet ndërkombëtare për paqe dhe siguri.

Ky angazhim reflekton vizionin e Ministrisë së Mbrojtjes për një ushtri moderne, profesionale dhe gjithëpërfshirëse.

Gratë në Forcat e Armatosura të Shqipërisë, pjesë aktive e strukturave operacionale

Në përputhje me standardet e NATO-s dhe OKB-së, FASH kanë rritur vazhdimisht përfshirjen e grave në radhët e tyre, duke i integruar ato në:

- struktura komanduese dhe shtabe,
- njësi logjistike dhe mbështetëse,
- misione jashtë vendit.

Gratë ushtarake shqiptare kontribuojnë në mënyrë aktive në përmbushjen e detyrave operacionale, duke dëshmuar se profesionalizmi ushtarak ndërtohet mbi aftësi, trajnim dhe disiplinë, pa dallim gjinor.

Rezoluta 1325 në praktikë: përvoja e FASH në misionet ndërkombëtare

Forcat e Armatosura të Shqipërisë kanë marrë pjesë ndër vite në një sërë operacionesh dhe misionesh paqeruajtëse, ku parimet e Rezolutës 1325 janë zbatuar konkretisht.

Në Afganistan, ku Shqipëria kontribuoi për një periudhë të gjatë në kuadër të misioneve të NATO-s, personeli ushtarak shqiptar, përfshirë edhe gra, u angazhua në:

- bashkëpunimin me komunitetet lokale,
- mbështetjen e popullsisë civile,
- krijimin e një ambienti më të sigurt për gratë dhe fëmijët.

Prania e grave ushtarake shqiptare në këto misione ka lehtësuar komunikimin me gratë vendase, duke rritur efektivitetin e ndërveprimit civil-ushtarak.

Kontributi në KFOR dhe siguria rajonale

Në misionin e NATO-s në Kosovë (KFOR), Forcat e Armatosura të Shqipërisë kanë dhënë një kontribut të vazhdueshëm për ruajtjen e paqes dhe stabilitetit rajonal.

Zbatimi i Rezolutës 1325 në këtë mision është reflektuar në:

- respektimin e plotë të mbrojtjes së civilëve,
- ndjeshmërinë ndaj nevojave të grave dhe vajzave,
- angazhimin profesional të personelit në përputhje me ligjin ndërkombëtar humanitar.

Kjo përvojë ka forcuar kapacitetet e FASH dhe ka rritur besueshmërinë e Shqipërisë si kontribuues serioz në sigurinë euroatlantike.

Trajnimi dhe përgatitja sipas standardeve të NATO-s dhe OKB-së

Ministria e Mbrojtjes dhe Forcat e Armatosura të Shqipërisë kanë integruar parimet e Rezolutës 1325 në programet e trajnimit ushtarak, duke përfshirë:

- edukimin mbi të drejtat e njeriut,
- ligjin ndërkombëtar humanitar,
- mbrojtjen nga dhuna me bazë gjinore në situata konflikti.

Këto trajnime synojnë përgatitjen e personelit për operacione komplekse, ku siguria ushtarake ndërthuret me mbrojtjen e dinjitetit njerëzor.

Rezoluta 1325 si pjesë e politikës së mbrojtjes shqiptare

Zbatimi i Rezolutës 1325 nga FASH përforcon lidhjen ndërmjet:

- mbrojtjes kombëtare,
- angazhimeve ndërkombëtare,
- promovimit të paqes dhe stabilitetit.

Ky proces kontribuon në ndërtimin e një kulture institucionale që vlerëson barazinë, përgjegjësinë

dhe profesionalizmin si elemente thelbësore të sigurisë moderne.

Një ushtri moderne në shërbim të paqes

Rezoluta 1325 është sot pjesë përbërëse e identitetit të Forcave të Armatosura të Shqipërisë. Ajo udhëzon veprimtarinë ushtarake drejt:

- rritjes së efektivitetit operacional,
- forcimit të besimit të publikut,
- dhe konsolidimit të rolit të Shqipërisë si faktor paqeje në rajon dhe më gjerë.

Forcat e Armatosura të Shqipërisë mbeten të angazhuara për të kontribuar në paqen dhe sigurinë ndërkombëtare, në përputhje me parimet e OKB-së, NATO-s dhe vlerat demokratike që udhëheqin shtetin shqiptar.

Statistika të integruara: Pjesëmarrja e grave në Forcat e Armatosura të Shqipërisë

Në kuadër të përpjekjeve për implementimin e Agjendës së OKB-së "**Gratë, Paqja dhe Siguria**", Forcat e Armatosura të Shqipërisë kanë arritur përmirësime të dukshme në përfaqësimin gjinor, me statistika konkrete që tregojnë progresin në përfshirjen e grave në strukturat e sigurisë kombëtare.

Përqindja e grave në Forcat e Armatosura

Sipas të dhënave të fundit të përmbledhura për vitin 2024:

- **15.7%** e totalit të personelit ushtarak të FASH përbëhen nga gra ushtuese, duke përmbushur apo tejkaluar standardet e NATO-s për përfshirjen e grave në Forcat e Armatosura.
- Kur gjithë stafi (ushtarakë dhe civilë) merret së bashku, **rreth 20.8%** e Forcave të Armatosura të Shqipërisë janë gra.

Këto shifra reflektojnë një trend rritës në pesë vitet e fundit, nga rreth **14.3% në vitin 2022** deri në 15.7% në 2024.

Përfaqësimi sipas gradave dhe roleve

Të dhënat tregojnë ndryshime të rëndësishme në strukturën gjinore të FASH:

- Rreth **22%** e oficerëve ushtarakë janë gra një indikator i rëndësishëm i avancimit të të drejtave udhëheqëse dhe profesionalizmit

gjinor.

- Në nivelet e nënoficerëve (NCO), gratë përbëjnë **rreth 13%**, ndërkohë që rreth **12.4%** e rekrutëve të rinj ushtarake janë gra, duke treguar një tendencë rritjeje edhe në radhët fillestare.

Përfshirja në misionet ndërkombëtare

Pjesëmarrja e grave shqiptare në misionet paqeruajtëse dhe operacionet ndërkombëtare reflekton punën e FASH për të integruar agjendën "**Gratë, Paqja dhe Siguria**" në praktikë:

- Gjatë vitit 2024, **rreth 8.57%** e personelit të pozicionuar në misionet jashtë vendit ishin gra, të përfshira në operacione të ndryshme të NATO-s, OKB-së dhe BE-së në rajone të tilla si **KFOR (Kosovë), Mali i Jugut, Letonia (eFP)**, Bosnjë e Hercegovinë dhe Detin Egje.

Edhe pse kjo përqindje është më e ulët se ajo e përgjithshme në forcë, ajo tregon një hap praktik drejt përfshirjes më të madhe të grave në pozicione operacionale ndërkombëtare.

Rritja e prezencës gjinore në kohë

Deri në vitin 2020, përfaqësimi i grave në Forcat e Armatosura të Shqipërisë ishte rreth **14.01%**, me rritje të gradual dhe të qëndrueshme nga viti 2019. Kjo paraqet një trend pozitiv të avancimit të barazisë gjinore, përmes politikave të trajnimit, rekrutimit dhe zhvillimit profesional brenda FASH.

Gratë në pozita komandimi dhe udhëheqjeje

Një tjetër tregues i rëndësishëm i integritetit është prezenca e grave në pozita vendimmarrëse:

Të dhënat tregojnë se Forcat e Armatosura të Shqipërisë po ecin përpara në zbatimin e parimeve të Rezolutës 1325, duke përmirësuar përfaqësimin dhe rolin e grave në ushtri, jo vetëm si mbështetje, por si anëtare aktive dhe profesioniste të strukturave ushtarake dhe operacionale.

Ky progres statistikor jo vetëm përmbush standardet ndërkombëtare, por edhe forcon **kapacitetin kombëtar të sigurisë dhe angazhimin e Shqipërisë në paqeruajtje dhe stabilitet global**, në përputhje me detyrimet e vendit ndaj OKB-së dhe NATO-s.



GJENERAL BRIGADE VEHIJE KUTI



GJENERAL BRIGADE RAZIJE MEHMETI

HISTORI QË SHKRUHET ME DINJITET: DY GRA NË GRADËN GJENERAL BRIGADE

GJENERAL BRIGADE RAZIJE MEHMETI

Forca e qetësisë dhe dinjiteti i një rruge të ndërtuar me punë

Në historinë e Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë, gradimi i Raziye Mehmetit '**Gjeneral Brigade**' përfaqëson një moment domethënës, ku profesionalizmi, përkushtimi dhe integriteti personal marrin vlerësimin më të lartë institucional. Ajo është një nga ato figura që nuk ka kërkuar kurrë protagonizëm, por e ka ndërtuar autoritetin përmes punës së vazhdueshme, korrektësisë dhe respektit ndaj uniformës që mban.

Një karrierë e ndërtuar hap pas hapi

Rrugëtimi i saj profesional është shembulli tipik i një oficerëje që ka ecur përpara jo me zhurmë, por me

rezultate. Çdo detyrë e besuar ka qenë një provë e re përgjegjësie, e përballuar me seriozitet dhe vetëpërmbytje. Në një institucion ku standardet janë të larta dhe presioni i vazhdueshëm, Raziye Mehmeti ka ditur të ruajë qetësinë, duke marrë vendime të balancuara dhe të argumentuara.

Ajo ka fituar respektin e vartësve dhe eprorëve jo për shkak të gradës, por sepse ka ditur të dëgjojë, të analizojë dhe të drejtojë me shembull. Për të, disiplina nuk është imponim, por kulturë pune.

Grua oficerë në një mjedis sfidues

Të ndërtosh një karrierë të suksesshme si grua në Forcat e Armatosura kërkon dyfish përkushtim. Gjeneral Brigadier Raziye Mehmeti e ka përballuar këtë sfidë pa e përdorur kurrë gjininë si argument, por vetëm profesionalizmin si mjet. Ajo është rritur në detyrë në një mjedis ku kërkohen



aftësi reale drejtuese, qëndrueshmëri emocionale dhe etikë e fortë institucionale.

Nëna, dimensionin njerëzor i uniformës

Pas figurës së oficerës së lartë qëndron një nënë e përkushtuar, që ka ditur të ndërtojë ekuilibrin mes detyrës shtetërore dhe përgjegjësisë familjare. Ajo përfaqëson modelin e gruas që edukon meshembull, duke transmetuar vlera si puna, ndershmëria dhe respekti për ligjin. Në rolin e nënës, ajo e sheh suksesin jo vetëm si arritje personale, por si përgjegjësi për të qenë shembull për brezin e ri.

Bashkëshorte dhe bijë, rrënjët e forta morale

Familja ka qenë gjithmonë mbështetja e saj kryesore. Si bashkëshorte, ajo ka ndërtuar një raport të bazuar në mirëkuptim dhe mbështetje të ndërsjellë, elementë thelbësorë për të përballuar kërkesat e një karriere ushtarake. Si bijë, ajo ruan respektin dhe mirënjohjen për edukimin dhe vlerat e trashëguara nga prindërit, të cilat i konsideron themelin e formimit të saj njerëzor dhe profesional.

Një mesazh për brezat e rinj

Gradimi i saj 'Gjeneral Brigade' është një mesazh i qartë: në Forcat e Armatosura vlerësohen aftësitë, puna dhe integriteti. Razije Mehmeti është sot një figurë frymëzuese për vajzat që zgjedhin karrierën ushtarake, duke dëshmuar se rruga drejt majës është e hapur për këdo që punon me përkushtim dhe ndershmëri.

GJENERAL BRIGADE VEHBİJE KUTI

Lidershipi që ndërtohet mbi dije, vendosmëri dhe vizion

Gjeneral Brigade Vehbije Kuti, zëvendës komandante e Forcës Tokësore, përfaqëson profilin e një drejtueseje moderne ushtarake, ku lidershipi nuk imponon, por udhëheq. Ajo është një figurë që mishëron transformimin dhe modernizimin e Forcave të Armatosura Shqiptare në epokën e NATO-s.

Autoritet profesional në nivelet më të larta

Në detyrën e saj aktuale, Gjeneral Kuti mban një rol kyç në drejtimin dhe koordinimin e Forcës Tokësore, një nga strukturat më të rëndësishme dhe komplekse të FARSH-së. Vendimarrja e saj karakterizohet nga qartësia, analiza



e detajuar dhe aftësia për të parë përtej momentit, duke ndërtuar zgjidhje afatgjata.

Ajo është e njohur për komunikimin e drejtpërdrejtë dhe korrekt, duke krijuar klimë besimi dhe bashkëpunimi brenda strukturave që drejton.

Lidership që buron nga shembulli

Gjeneral Brigade Vehbije Kuti është një drejtuese që nuk kërkon privilegje, por standarde të njëjta për të gjithë. Ajo ka ndërtuar autoritetin duke qenë gjithmonë e përgatitur profesionalisht, e informuar dhe e pranishme në vendimarrje. Ky stil drejtimi e ka bërë një figurë të besueshme dhe respektuar.

Grua dhe nënë, balanca mes forcës dhe ndjeshmërisë

Në jetën familjare, Gjeneral Kuti shfaq një dimension tjetër të personalitetit të saj: atë të nënës që di të dëgjojë, të kuptojë dhe të edukojë. Ajo beson se ndjeshmëria njerëzore nuk e dobëson lidershipin, por e pasuron atë, duke e bërë më të drejtë dhe më të ekuilibruar.

Roli i nënës i ka dhënë asaj një perspektivë më të gjerë mbi përgjegjësinë dhe pasojat e vendimeve, qoftë në familje apo në detyrë.

Bashkëshorte dhe bijë, mbështetja që jep forcë

Familja për Gjeneral Kutin mbetet boshti emocional që e mban të lidhur me vlerat themelore. Mbështetja familjare ka qenë thelbësore në përballimin e ritmit të lartë operacional dhe përgjegjësisë të shumta që shoqërojnë gradat e larta ushtarake.

Simbol i progresit dhe barazisë reale

Gradimi i saj në Gjeneral Brigade është dëshmi konkrete e progresit në Forcat e Armatosura, ku gratë jo vetëm marrin pjesë, por drejtojnë dhe ndikojnë në nivelet më të larta strategjike. Vehbije Kuti është sot një simbol i barazisë reale, të ndërtuar mbi meritë dhe profesionalizëm.

DY HISTORI, NJË SHEMBULL I PËRBASHKËT

Razije Mehmeti dhe Vehbije Kuti përfaqësojnë dy portrete të ndryshme, por të bashkuara nga të njëjtat vlera: përkushtimi ndaj atdheut, integriteti profesional dhe forca e karakterit. Ato janë dëshmi se Forcat e Armatosura Shqiptare ecin përpara, duke u mbështetur te njerëz të aftë, pa dallim gjinie.

TË JESH GRUA



KONTRIBUTII GRAVE DHE VAJZAVE OFICERE NË USHTRINË SHQIPTARE



Roli i grave dhe vajzave shqiptare në Luftën Antifashiste Nacionalçlirimtare (LANÇ) është i njohur, por më pak është folur për fatin e tyre pas çlirimit, sidomos për ato që synuan të vazhdonin rrugën si oficerë në ushtrinë e re shqiptare.

Me këtë material historik redaksia e shtypit ushtarak, hedh dritë mbi një periudhë të rëndësishme, të kontributit femëror në Forcat e Armatosura të Shqipërisë, duke u mbështetur plotësisht te dokumentet arkivore dhe dëshmitë e kohës.

Gra dhe vajza në radhët e Ushtrisë Nacionalçlirimtare

Gjatë LANÇ-it, mijëra gra dhe vajza iu bashkuan formacioneve partizane si luftëtare të armatosura, si instruktore, komisare rinie, përgjegjëse politike, lidhëse, mjeke, infermiere dhe në funksione të tjera drejtuese. Disa prej tyre shërbyen në shtabe brigadash, në shtabe zonash, madje edhe pranë Shtabit të Përgjithshëm të ushtrisë partizane. Kontributi i tyre shtrihet në të gjitha frontet: brenda kufijve të Shqipërisë, në trojet shqiptare jashtë kufijve administrativë të 1944-s, si dhe në operacione të përbashkëta me ushtritë aleate kundër gjermanëve.

Ky angazhim masiv, i paprecedentë për kohën, krijoi pritshmëri se vajzat dhe gratë do të kishin një rol domethënës edhe në ushtrinë e re të shtetit shqiptar.

Pengesat pas çlirimit, mentaliteti dhe politika shtetërore

Megjithëse shumë prej tyre shprehën dëshirën të vazhdonin karrierën ushtarake, realiteti ndryshoi shpejt. Vendimet politike të viteve të para pas çlirimit sollën reduktimin drastik të pranisë së grave në ushtri. Dokumenti më domethënës është fonogrami nr. 63, datë 13.11.1944, firmosur nga Koçi Xoxe, i cili urdhëronte largimin gradual të grave nga ushtria, me arsyetimin se “mund të kontribuonin më mirë në sektorë të tjerë civilë”. Ky qëndrim ishte i ndikuar edhe nga praktika e ushtrisë jugosllave të asaj kohe, me të cilën drejtuesit komunistë kishin marrëdhënie të ngushta.

U lejua vetëm një numër simbolik grash oficerë pa kompetenca reale ndërsa të tjera u orientuan drejt administratës civile, arsimit, kulturës e shëndetësisë.

Kursi i parë i oficerëve (1945) - Nëntë vajza nga fronti i luftës

Më 28 mars 1945, u hap Shkolla Ushtarake “Skënderbej”, në të cilën, krahas rreth 200 kadetëve djem, morën pjesë edhe 9 vajza partizane. Ato vinin nga brigadat sulmuese ku kishin luftuar që në moshën 14-15 vjeçare. Shtatë prej tyre kryen vitin e parë mësimor; vetëm gjashtë e përfunduan të plotë dhe u titulluan oficerë aktive.

Ndër to dallohen:

- **Valentina Murzaku** (Brigada e 23-të Sulmuese)
- **Xhevrije Golemi** (Brigada V Sulmuese)
- **Katerina Prifti** (Brigada I Sulmuese)

Dëshmia e Valentina Murzakut është një pasqyrë e gjallë e asaj periudhe. Ajo kujton se si vajzat e reja, ende me armë mbi shpatulla, u ulën në bankat e shkollës ushtarake, plot shpresë se do të ishin bërthama e brezit të parë të oficerëve të Shqipërisë. Por pas vitit të parë, një urdhër i Ministrisë së Mbrojtjes ndaloi vazhdimin e studimeve ushtarake për femrat.

Edhe pse të diplomuara, këto oficerë u dërguan në sektorë civilë, në arsim, shtyp, banka, shkencë e kulturë, ku dhanë kontribute të shquara. Rasti i Valentina Murzakut, gazetares, punonjëse në Bankën Qendrore dhe specialiste në Institutin e Shkencave, është tipik për fatin e shumë grave që nisën si luftëtare e oficerë, por karrierën e përfunduan jashtë strukturave ushtarake.

Kursi i dytë i oficerëve (1949-1951)

Në vitet 1949 – 1951, Ministria e Mbrojtjes organizoi një tjetër kurs formimi për oficerë, i përbërë prej rreth 10 vajzash, të cilat kishin qenë pjesëtare të LANÇ-it. Këto oficerë shërbyen për disa vite në funksione administrative dhe kulturore në ushtri, kryesisht në:



- Shkollën Ushtarake “Skënderbej”
- Shkollën e Bashkuar të Oficerëve
- Seksionet e kulturës dhe të edukimit ushtarak

Disa prej tyre ishin njëkohësisht edhe sportiste të klubit “Partizani”, pjesë e **ekipit të qitjes**, duke përfaqësuar ushtrinë në gara kombëtare dhe ndërkombëtare.

Figura kryesore të këtij kursi ishin:

- **Vitori Kondo-Fico** – Oficerë e kulturës në Shkollën “Skënderbej”, më pas funksionare civile
- **Naze Levendi-Dervishi** – Punoi në Shkollën e Bashkuar, pastaj në sektorin e shëndetësisë
- **Sofije Kristo** – Funksionare në administratën e mbrojtjes
- **Dhora Zenko** – Veprimtare dhe specialiste në institucionet shtetërore.

Megjithëse prania e tyre ishte e kufizuar në kohë dhe numër, ato u bënë femrat që mbajtën gjallë profilin e “oficerës shqiptare” në vitet më të vështira të ndalimit formal.

Gjurmët e lëna dhe rëndësia historike

Pavarësisht pengesave të shumta politike e shoqërore, këto gra lanë një trashëgimi të vyer:

- Ato përfaqësojnë brezin e parë të oficerëve shqiptarë.
- Dëshmojnë se gratë shqiptare ishin të afta, të zonja dhe të gatshme të mbanin detyra ushtarake.
- Ato krijuan modele të hershme frymëzuese për gjeneratat e mëvonshme.
- U bënë pjesë e historisë së emancipimit shoqëror të gruas pas Luftës së Dytë Botërore.

Rihapja e mundësive për vajzat, Brezi i 1967-s

Në vitin 1967, politika shtetërore ndryshoi. Mbi **70 vajza nga e gjithë Shqipëria** u pranuan në Shkollën e Bashkuar të Oficerëve në Tiranë. Ky vit shënon fillimin e integritetit real të grave në Forcat e Armatosura, tashmë në rrethana më të favorshme dhe me qëllim që të përgatiste oficerë karriere në funksione të ndryshme, nga artileria te komunikacionet e deri te shërbimi mjekësor ushtarak.

Ky brez trashëgoi rrugën e vështirë të atyre pak femrave që i paraprinë kohës së tyre në vitet 1945 dhe 1951.

Historia e oficerëve të para shqiptarë është një histori sakrifice, idealizmi dhe zhgënjimi, por edhe e një kontributi të jashtëzakonshëm që meriton të njihet dhe të vlerësohet. Ato ishin luftëtare, vajza të reja të rritura përpara kohe, që ndërtuan lirinë me armë në dorë dhe kërkuan të shërbenin njëloj si burrat në rindërtimin e atdheut.

Megjithëse rruga e tyre u ndërpre nga politika e kohës, puna, kujtimet dhe shembulli që lanë mbeten pjesë e identitetit institucional të ushtrisë shqiptare. Ato i hapën rrugën brezave të rinj të vajzave që më vonë do të bëheshin oficerë, instruktore, pilote, mjeke ushtarake, komandante dhe drejtues të rëndësishëm në Forcat e Armatosura.

Ky material shërben si një homazh për kontributin e tyre dhe si një rikthim i merituar në histori.



Editorial

ANJEZA MUSOLLARI,

Shefe e Sektorit të Botimeve

DREJTËSIA QË PO VIHET NË PROVË:

Rasti i ish-krerëve të UÇK-së dhe pesha e një vendimi të padrejtë

Në historinë e kombeve ka momente kur drejtësia dhe politika përplasen në mënyrë të tillë sa kufiri mes tyre bëhet i mjegullt. Rasti i ish-krerëve të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës: Hashim Thaçi, Kadri Veseli, Jakup Krasniqi dhe Rexhep Selimi, përbën pikërisht një nga këto momente delikate për Kosovën dhe për vetë ndërgjegjen ndërkombëtare. Aktakuza e konfirmuar më 26 tetor 2020 dhe dërgimi i tyre në paraburgim në Hagë, më 5 nëntor të atij viti, shënoi një kthesë të rëndë në historinë politike dhe juridike të Kosovës. Katër figura kyçe të luftës dhe shtetndërtimit u përballën me akuza për krime lufte dhe krime kundër njerëzimit, akuza të rënda, që prekin thelbin e moralit njerëzor dhe kujtesës kolektive të një populli.

Por sot, më shumë se kurrë, lind një pyetje thelbësore: *A po vihet në vend drejtësia, apo po ndërtohet një narrativë e padrejtë që rrezikon të deformojë historinë e luftës çlirimtare të Kosovës?*

Lufta për liri dhe pesha e historisë

UÇK-ja lindi në një kontekst të qartë represioni sistematik, spastrimi etnik dhe dhune shtetërore

ndaj popullit shqiptar të Kosovës. Lufta e viteve 1998–1999 nuk ishte një konflikt klasik për pushtet; ishte një përballje për mbijetesë dhe dinjitet kombëtar.

Të barazosh këtë luftë me narrativet e krimeve sistematike, pa e vendosur në kontekstin e një represioni të dokumentuar ndërkombëtarisht, është jo vetëm reduktim historik, por edhe padrejtësi morale.

Askush nuk është mbi ligjin. Ky është parim themelor i çdo shoqërie demokratike. Por po aq themelor është parimi se drejtësia duhet të jetë e barabartë, e paanshme dhe e çliruar nga ndikimet politike. Në rastin e ish-krerëve të UÇK-së, perceptimi i gjerë në opinionin publik shqiptar është se peshorja e drejtësisë nuk po qëndron në ekuilibër.

Dhomat e Specializuara, drejtësi e domosdoshme apo kompromis politik?

Dhomat e Specializuara dhe Zyra e Prokurorit të Specializuar u themeluan në vitin 2015 nga Kuvendi i Kosovës, nën presion të fortë ndërkombëtar. Ato janë formalisht pjesë e sistemit gjyqësor të Kosovës, por veprojnë në Holandë, me personel ndërkombëtar.

Ky konstrukt juridik i pazakontë ka ngritur që në fillim pikëpyetje serioze:

- Pse një gjykatë për Kosovën funksionon jashtë territorit të saj?
- Pse trajton vetë pretendimet për krime të supozuara nga pjesëtarë të UÇK-së?



- A krijon kjo perceptimin e një drejtësie selektive? Drejtësia selektive nuk është drejtësi. Ajo është kompromis politik i veshur me petkun e ligjit. Nëse krimet e luftës janë universale dhe duhet të hetohen pa dallim, atëherë çdo narrativë që fokusohet vetëm në njërën palë, duke lënë në hije krimet e dokumentuara të aparatit shtetëror serb, krijon një boshllëk të madh moral dhe juridik.

Prezumimi i pafajësisë dhe procesi i gjatë

Thaçi, Veseli, Krasniqi dhe Selimi janë deklaruar të pafajshëm. Sipas parimit themelor të drejtësisë, ata janë të pafajshëm derisa të provohet e kundërta. Megjithatë, procesi i gjatë, paraburgimi i zgjatur dhe ekspozimi i vazhdueshëm publik kanë prodhuar një dënim të heshtur para vendimit përfundimtar. Në opinionin publik ndërkombëtar, vetë fakti i akuzës shpesh perceptohet si provë e fajësisë. Kjo është një sfidë serioze për integritetin e procesit. Drejtësia nuk duhet të jetë spektakël. Ajo duhet të jetë e ftohtë, e matur dhe e bazuar vetëm në prova të pakontestueshme.

Reziku i rishkrimit të historisë

Një nga shqetësimet më të mëdha që ngrihet sot në Kosovë është frika se përmes këtij procesi po rishkruhet historia e luftës çlirimtare. Lufta e UÇK-së ishte përgjigje ndaj një regjimi që tashmë ishte dënuar ndërkombëtarisht për krime të rënda. Ndërhyrja e NATO-s në vitin 1999 ishte konfirmim i faktit se situata në Kosovë kishte kaluar çdo kufi humanitar. Në këtë kontekst, të trajtosh luftën çlirimtare si një ndërmarrje kriminale kolektive do të ishte një shtrembërim historik me pasoja të thella për brezat e ardhshëm. Askush nuk pretendon se në luftë nuk mund të ketë pasur shkelje individuale. Lufta është kaos. Por përgjegjësia individuale nuk mund të shndërrohet në përgjegjësi kolektive dhe as të përdoret për të njollësuar një lëvizje të tërë çlirimtare.

Dimensioni politik i çështjes

Nuk mund të injorohet fakti se të akuzuarit janë figura që udhëhoqën jo vetëm luftën, por edhe procesin e shpalljes së pavarësisë dhe ndërtimit të institucioneve të Kosovës.

Në këtë aspekt, procesi gjyqësor ka një dimension të pashmangshëm politik. Çdo vendim do të ketë ndikim të drejtpërdrejtë në stabilitetin e brendshëm të Kosovës dhe në marrëdhëniet ndërkombëtare. Nëse drejtësia perceptohet si e njëanshme, ajo rrezikon të prodhojë mosbesim afatgjatë ndaj institucioneve ndërkombëtare dhe vetë konceptit të drejtësisë tranzicionale.

Drejtësia nuk duhet të jetë hakmarrje

Që drejtësia të jetë e vërtetë, ajo duhet të jetë e ndarë nga çdo formë hakmarrjeje politike apo presioni diplomatik. Ajo duhet të bazohet vetëm në prova të qarta, në standarde të larta procedurale dhe në respektim të plotë të të drejtave të të akuzuarve. Çdo vendim që nuk i përmbush këto standarde do të mbetet i diskutueshëm në ndërgjegjen e popullit. Kosova ka sakrifikuar shumë për të ndërtuar një shtet të bazuar në sundimin e ligjit. Por sundimi i ligjit nuk nënkupton nënshttrim ndaj padrejtësisë. Përkundrazi, ai kërkon guxim për të kërkuar drejtësi të vërtetë pa standarde të dyfishta. Çështja e ish-krerëve të UÇK-së nuk është vetëm një proces gjyqësor. Ajo është një provë për mënyrën se si historia e Kosovës do të trajtohet në arenën ndërkombëtare. Nëse drejtësia do të jetë e drejtë, e balancuar dhe e bazuar në prova të pakundërshtueshme, atëherë ajo do të forcojë themelet e shtetit të Kosovës. Por nëse perceptohet si selektive apo e motivuar politikisht, do të lërë plagë të thella në ndërgjegjen kolektive. Kosova nuk kërkon imunitet për askënd. Ajo kërkon barazi. Ajo kërkon që drejtësia të mos bëhet instrument i narrativave të padrejta.

Një thirrje për drejtësi të vërtetë

Në fund, historia do të gjykojë jo vetëm të akuzuarit, por edhe vetë procesin. Do të gjykojë nëse drejtësia ndërkombëtare arriti të mbetet mbi politikën, apo u bë pjesë e saj. *Drejtësia duhet të jetë e plotë. Drejtësia duhet të jetë e paanshme. Drejtësia duhet të jetë e drejtë.* Vetëm atëherë vendimi do të pranohet si i tillë – jo si një akt formal juridik, por si një akt i vërtetë i së drejtës. *Sepse kur drejtësia vihet në provë, në provë vihet edhe vetë e vërteta.*



SEKTORËT QË DO TË UDHËHEQIN

industrinë e mbrojtjes në vitin 2026:

Industria globale, një epokë e re e sigurisë

Industria e mbrojtjes në nivel botëror po përjeton një transformim të thellë. Në vitin 2026, pritet që sektori të udhëhiqet nga teknologjitë e avancuara digjitale, inteligjenca artificiale, mbrojtja kibernetike, hapësira dhe dronët autonomë. Këto fusha nuk janë më thjesht shtesa në arsenalin tradicional, por po shndërrohen në shtyllat kryesore të sigurisë kombëtare dhe ndërkombëtare.

Inteligjenca artificiale dhe analiza e të dhënave

Inteligjenca artificiale (AI) është bërë zemra e operacioneve moderne. Ajo përdoret për të analizuar miliona të dhëna në kohë reale, për të parashikuar lëvizjet e kundërshtarëve dhe për të optimizuar logjistikën. Në vitin 2026, pritet që çdo ushtri e madhe të ketë sisteme të integruara të AI-së, që ndihmojnë komandantët të marrin vendime më të shpejta dhe më të sakta. Për shembull, algoritmet mund të identifikojnë anomali në komunikimet e armikut ose të parashikojnë sulme kibernetike përpara se ato të ndodhin.

Mbrojtja kibernetike – fronti i padukshëm

Sulmet kibernetike janë bërë po aq të rrezikshme sa armët tradicionale. Një shtet mund të paralizohet pa u qëlluar asnjë plumb, thjesht duke sulmuar sistemet e


tij digjitale. Për këtë arsye, mbrojtja kibernetike është prioritet absolut. Në vitin 2026, pritet që çdo ushtri të ketë një "komandë kibernetike" të dedikuar, e cila jo vetëm mbron, por edhe zhvillon kapacitete ofensive për të neutralizuar sistemet e kundërshtarëve.

Dronët dhe sistemet autonome

Dronët po revolucionarizojnë mënyrën e luftës. Nga dronët e vegjël për survejim deri te dronët e mëdhenj për transport dhe sulme, këto pajisje po zëvendësojnë misionet e rrezikshme për ushtarët. Në vitin 2026, pritet që dronët autonomë të jenë pjesë e përhershme e arseneleve moderne. Përparimi i teknologjisë ka bërë që dronët të jenë më të lirë, më të sofistikuar dhe më të lehtë për t'u përdorur, duke i dhënë avantazh edhe vendeve më të vogla.

Hapësira – arena e re strategjike

Satelitët ushtarakë përdoren për komunikim, navigim dhe survejim global. Kontrolli i orbitës është tashmë një garë mes fuqive të mëdha, dhe në vitin 2026 pritet të intensifikohet. Hapësira nuk është më thjesht një fushë shkencore, por një arenë strategjike, ku dominimi i informacionit dhe i teknologjisë është vendimtar. Kush



Inteligjenca artificiale (AI) është bërë zemra e operacioneve moderne. Ajo përdoret për të analizuar miliona të dhëna në kohë reale, për të parashikuar lëvizjet e kundërshtarëve dhe për të optimizuar logjistikën.

kontrollon hapësirën, kontrollon komunikimin global dhe aftësinë për të parashikuar lëvizjet e kundërshtarëve.

Energjia e gjelbër dhe logjistika e qëndrueshme

Industria e mbrojtjes po përshtatet me tranzicionin energjetik. Automjetet elektrike, sistemet e furnizimit me energji të rinovueshme dhe teknologjitë e kursimit të energjisë po bëhen pjesë e strategjive ushtarake. Kjo jo vetëm që ul varësinë nga karburantet fosile, por edhe rrit fleksibilitetin e ushtrive në terren. Në vitin 2026, pritet që shumë ushtri të testojnë tanke dhe automjete të blinduara me motorë elektrikë, duke kombinuar fuqinë ushtarake me qëndrueshmërinë mjedisore.

Shqipëria – një kapitull i ri në mbrojtje

Në Shqipëri, viti 2026 shënon një moment historik. Për herë të parë, buxheti i mbrojtjes arrin në 2,12% të PBB-së, duke reflektuar një rritje prej 12% krahasuar me vitin 2025. Ky investim i madh tregon se mbrojtja është vendosur në qendër të prioritetëve kombëtare.

Aviacioni ushtarak

Ringritja e shkollës së aviacionit në Vlorë, në bashkëpunim me kompani izraelite, është një hap i madh drejt krijimit të kapaciteteve ajrore. Përveç përgatitjes së pilotëve dhe kontrollorëve ajrorë, parashikohet edhe krijimi i flotës së avionëve zjarfikës për emergjencë civile. Kjo nismë e kthen Shqipërinë në një vend me kapacitete të qëndrueshme ajrore, duke e bërë më të aftë për të reaguar ndaj krizave të brendshme dhe për të kontribuar në operacionet ndërkombëtare.

Industria vendase e mbrojtjes

Projekti "Made in Albania" synon të zhvillojë kapacitete prodhuese të brendshme, duke e bërë Shqipërinë jo vetëm konsumator, por edhe prodhues të pajisjeve ushtarake. Kjo nismë ka potencial të ndikojë pozitivisht në ekonominë kombëtare dhe të krijojë vende të reja pune. Për më tepër, zhvillimi i industrisë vendase e bën vendin më pak të varur nga importet dhe më të aftë për të përballuar krizën globale të furnizimeve.

Mbrojtja kibernetike

Shqipëria po investon gjithnjë e më shumë në sigurinë digjitale, duke e parë këtë fushë si një element kritik për mbrojtjen kombëtare. Sulmet kibernetike ndaj institucioneve publike kanë treguar se kjo është një fushë ku nevojitet vigjilencë e vazhdueshme. Në vitin 2026, pritet që Shqipëria të krijojë struktura të dedikuara për mbrojtjen kibernetike, duke e bërë këtë sektor një nga shtyllat kryesore të sigurisë kombëtare.

Emergjencat civile

Flota e re kombëtare për emergjencat është një tregues se mbrojtja nuk kufizohet vetëm në fushën ushtarake. Përballja me fatkeqësi natyrore, zjarre apo kriza humanitare po bëhet pjesë e pandashme e strategjisë së mbrojtjes. Kjo qasje e gjerë e bën mbrojtjen më gjithëpërfshirëse dhe më

të lidhur me nevojat e qytetarëve.

Personeli ushtarak

Rritja e pagave dhe përmirësimi i kushteve të punës për ushtarakët është një tjetër element që tregon përkushtimin e shtetit ndaj forcave të armatosura. Motivimi i personelit është po aq i rëndësishëm sa pajisjet moderne, dhe në vitin 2026 pritet që Shqipëria të ketë një ushtri më të motivuar dhe më profesionale.

Rajoni dhe NATO, një kontekst i gjerë

Shqipëria nuk vepron e vetme. Si anëtare e NATO-s, ajo është pjesë e një strategjie më të gjerë rajonale dhe ndërkombëtare. Në Ballkan, ku tensionet historike shpesh rikthehen, investimet në mbrojtje janë të lidhura ngushtë me stabilitetin politik dhe sigurinë e përbashkët.

NATO ka vendosur si standard që vendet anëtare të arrijnë pragun e 2% të PBB-së për mbrojtjen. Shqipëria jo vetëm që e ka arritur këtë, por e ka tejkaluar, duke u pozicionuar si një partner i besueshëm dhe aktiv. Ky fakt e rrit peshën e saj në vendimmarrjet e Aleancës dhe e bën një aktor më të rëndësishëm në rajon. Ballkani mbetet një rajon i brishtë, ku siguria është e lidhur ngushtë me zhvillimet politike. Investimet në mbrojtje nuk janë vetëm për mbrojtjen kombëtare, por edhe për të kontribuar në stabilitetin e rajonit. Shqipëria, me kapacitetet e reja në aviacion, mbrojtje kibernetike dhe emergjencë civile, ka mundësinë të luajë një rol udhëheqës në bashkëpunimin rajonal. Bashkëpunimi në fushën e emergjencave civile dhe mbrojtjes kibernetike po bëhet gjithnjë e më i rëndësishëm. Shqipëria mund të ofrojë ekspertizë dhe kapacitete për të ndihmuar vendet fqinje, duke e pozicionuar veten si një qendër e besueshme e sigurisë në rajon.

Një vizion i ri për mbrojtjen

Në vitin 2026, industria globale e mbrojtjes do të udhëhiqet nga teknologjitë digjitale, mbrojtja kibernetike, dronët dhe hapësira. Ndërkohë, Shqipëria po hap një kapitull të ri me investime historike në aviacion, industri vendase dhe emergjencë civile. Ky është një moment ku mbrojtja nuk shihet më vetëm si një fushë ushtarake, por si një sistem i integruar që përfshin teknologjinë, ekonominë dhe sigurinë e qytetarëve. Shqipëria, duke rritur buxhetin e saj dhe duke investuar në sektorë strategjikë, po tregon se është e gatshme të përballlet me sfidat e kohës dhe të kontribuojë në sigurinë rajonale dhe ndërkombëtare. Në këtë mënyrë, viti 2026 nuk është thjesht një vit i rritjes së shpenzimeve, por një vit i transformimit të vizionit të mbrojtjes, nga një koncept tradicional drejt një qasjeje moderne, gjithëpërfshirëse dhe të qëndrueshme.

Ky shkrim synon të tregojë se mbrojtja nuk është më vetëm një çështje e ushtrisë, por një pjesë e pandashme e zhvillimit kombëtar dhe e rolit të Shqipërisë në botë. Në fund të fundit, siguria është themeli mbi të cilin ndërtohet prosperiteti i një kombi.

DËSHMORËT E FEKENIT

NË MEMORIEN E PËRJETËSISË

USHTARAKE DHE KOMBËTARE



Prof. Asoc. Dr. Zaho GOLEMI

Me rastin e 45-vjetorit të rënies së 11 dëshmorëve të Fekenit (6.2.1981-6.2.2026); kushtuar dëshmorëve të Atdheut të rënë në krye të detyrës dyzetë e pesë vjet më parë në një ditë tragjdie, heroizmi, solidariteti ushtarak: komandanti i batalionit të parë të këmbësorisë Dushan Fejzi Shameti (1952-1981) nga Dorëz i Tepelenës, Çlirim Halil Pulaj (1945-1981), shef i planëzimit, nga Tragjasi i Vlorës; Nikolla Naun Bero (1946-1981), pedagog taktike nga Berati; Aleko Thimio Gjoni (1958-1981), student dega prapavijë, nga fshati Nivcë Sarandë (me banim në Gjirokastrë); Besnik Sulo Shehu (1958-1981), student gjitharmësh nga Pëcari i Gjirokastrës; Bilbil Zoto Pashaj (1958-1981), student gjitharmësh, nga Kremenar, Mallakastër; Ilir Stefan Gramatikoi (1958-1981), student, dega prapavi-

jë, nga Tirana; Bujar Masar Ago (1958-1981), student dega prapavijë, nga Vishje Tirana; Pëllumb Hysen Rrapo 1958-1981, student, dega prapavijë, nga Poshnja e Beratit; Qemal Qazim Lika (1958-1981), student gjitharmësh, nga Selba e Tiranës, Nexhip Dervish Çoba (1960-1981) student viti i dytë nga Golemi, Kavajë, Durrës. Tre oficerët dhe tetë studentët e rënë në Feken janë shpallur me Vendim Nr. 2506/2 datë 1.9.1999 të Komisionit Qendror të Statusit “Dëshmor i Atdheut, që është vendim i përbashkët për të njëmbëdhjetë dëshmorët e ish-Shkollës së Lartë të Bashkuar të Oficerëve “Enver Hoxha”, që ranë dhe mbetën përjetësisht, më datën 6 shkurt 1981. Ata ranë për të shkruar pavdekësinë në memorien ushtarake dhe kombëtare shqiptare.

Stërvitja dimërore e shkurtit 1981 ishte dhe mbeti një ngjarje e shkruar në memorien e gjithë ushtarakëve shqiptarë, por edhe më gjerë. Ishin tre oficerë dhe tetë studentë të ish-Shkollës së Lartë të Bashkuar të Oficerëve, që në kujtesën shqiptare quhen “11 dëshmorët e Meçekut”. Stërvitja dimërore masive e trupës studentore dhe pedagogjike në një ditë tepër të vështirë u kthye në një ditë që në memorien ushtarake shqiptare dhe më gjerë është quajtur “Tragjedia e Fekenit”, rrëzë malit të Meçekut. Tashmë janë të rrallë ushtarakët që e kanë jetuar ditën e tragjedisë së ushtarakëve të ish-SHLBO dhe që militojnë në FASH. Megjithatë kujtesa e shqiptarëve nuk mund të harrojë ushtarakët, studentët e pedagogë, me në krye komandantin e shkollës Rustem Peçi, shefin e degës mësimore Hysen Shehu e shumë të tjerë, personalitete të shquar ushtarakë. Një unitet njerëzor, një simbolikë solidariteti ushtarak e njerëzor. Katër dekada e gjysmë kanë shkruar dhe Lapidarët e Fekenit si maja malesh lartësohen në të katër anët e Shqipërisë. Që të gjithë ranë në emër të një kauze të madhe në zemër të malit të Meçekut mbrapa malit të Dajtit në Tiranë. Kjo është dokumentuar në kujtesën e mijëra pjesëmarrësve në stërvitje dimërore studentë e oficerë, por edhe atyre që me zemër e shpirt ishin në stërvitjen dimërore të studentëve ushtarakë. Një korpus ushtarakësh në unitet vlerash njerëzore. Kështu është regjistruar tashmë jo vetëm në kujtesën e ushtarakëve ngjarja e rëndë tragjike, ku humbën jetën 11 pedagogë e studentë ushtarakë, gjatë një stërvitjeje dimërore në malin me borë përtej Dajtit. Në historikun e saj të pas Luftës së Dytë Botërore, ushtria shqiptare e ka memorizuar këtë si ndodhinë më të rëndë, me numrin më të madh të viktimave e të lënduarve. *Kaluan dyzetë vjet qysh atëherë, në opinionin publik është folur gjithmonë me rezerva për katastrofën që ndodhi*

gjatë atij demonstrimi, në kushte shumë të vështira të faktorëve ekstremë të natyrës sikurse janë ortejë. Madje, në periudhën kur ndodhi, autoritetet zyrtare ndaluan në mënyrë të prerë transmetimin e lajmeve në mediat e kufizuara të kohës. Fillimisht në vitet e para gjithë ngjarja ishte rrethuar me mister dhe asnjëherë nuk ka qenë përkujtuar ceremonialisht, përjashtuar takimin e përvitshëm të familjarëve të dëshmorëve studentë e oficerë në vendin e ngjarjes dhe përkujtesën e bashkë-studentëve e pedagogëve në mjediset e Akademisë Ushtarake dhe KDS-së. Vetëm pas 18 vjetëve nga rënia e tyre, në vitin 1999, të rënë e ortejë të Fekenit u shpallën “Dëshmorë të Atdheut”; ndërsa të mbijetuarit u dekoruan me medalje të ndryshme. Fekeni u bë në atë kohë qendër e rëndësishme e përgatitjes së luftëtarëve të ardhshëm të UÇK-së (1997-1999). Në librin “Dëshmorët e Atdheut”, të publikuar me rastin e 100-vjetorit të shtetit shqiptar më 2012-tën, midis rreshtave të dëshmorëve të të gjitha epokave janë shkruar edhe dëshmorët e Fekenit. Ata janë shpallur dëshmorë me vendim të Komisionit shtetëror të dëshmorëve nr. 2506/2, datë 1.9.1999. Por dëshmorët studentë e pedagogë ushtarakë janë një monument i kombit, që dhanë jetën për atdheun në përleshje me stuhitë e dy ortejëve të dëborës. Dy kolona gjigande ushtarake në fund janari ose në fillim të shkurtit të viteve '80 lëviznin për “stërvitje dimërore” nga Tirana e Zall-Herri drejt grykës së Tujanit, Zall-Bastarit dhe më tej rrugët ndaheshin: Shkolla e Bashkuar e zhvendoste aktivitetin e saj me marshim drejt qendrës stërvitore Feken, ndërsa Shkolla e Oficerëve Rezervistë Zall-Herr vijonte drejt Bizës së Martaneshit. Por kjo periudhë ishte e pamundur që mos të shoqërohej me reshje të shumta dëbore. Katër dekada e gjysmë më parë në atë ditë të ftohtë shkurti studentët e Shkollës së Lartë të Bashkuar të Oficerëve “Enver Hoxha” (emërtim i kohës), grupet mësimore që kishin në program mësimor “përgatitje fizike/ngjitje malore në terren me dëborë”, u goditën befasisht nga një ortejë i fuqishëm bore që përfshiu vetëm në pak sekonda 204 studentë. Ngjarja nga më shumë se mijëra dëshmitarë është treguar dhjetëra e dhjetëra herë në këto 45 vite. Është një tragjedi e vërtetë e pashoqe në historikun e gjithë ish-shkollave ushtarake të vendit. Edhe protagonistët kryesorë të organizimit shembullor, që kufizoi viktimat dhe pasojat katastrofike. Nuk ka qenë vetëm një goditje ortejë, por dy ortejë njeri pas tjetrit, që nuk vinin me rrokullisje por me shkarje masive dëbore si të rrëshqiste mali i tërë. Në imazhin e gjithë korpunit ushtarak pavarësisht se tashmë ajo është një ditë “e largët” dyzetë e pesë vjeçare, por dhe kaq pranë si ditë

e heroizmi e solidariteti ushtarak.

Tragjedi e paralajmëruar (data 5 shkurt 1981 “binjake” e datës 6 shkurt 1981)

Programimi dhe masat për stërvitjen dimërore niste që në verë. Në shtator gjithë planet dhe masat për stërvitjen dimërore të Fekenit kanë qenë gati. Protagonistët Petrit Murzaku, Mark Mici, Ramazan Zelija, Isa Tare, Bashkim Lika e shumë të tjerë të katedrës së Përgatitjes fizike por edhe specialistë nga MMP-ja dhe SHP kanë qenë udhëtreguesit e ngjarjes në dekada. Në fakt katedra e Përgatitjes fizike udhëhiqte në të vërtetë gjithë trupën studentore jo vetëm drejt majës së Meçekut, por edhe krejt aktivitetit stërvitor në Feken. Të gjithë ishin të bindur se kapja e lartësisë së pikës trigonometrike në majën e malit të Meçekut me lartësi 1827 metra, ishte edhe “objektivi”, ose “steka” e nivelit stërvitor në kushte dimërore krahas aktivitetit stërvitor të taktikës, qitjeve malore, zbritjes dhe ngjitjes alpinistike, mbijetesës në guvat e dëborës, xhenios, kimisë, ndërlidhjes, topografisë në kushte fushore dimërore etj. Duke qenë dëshmitar i kësaj ngjarje, sjell në kujtesë se një ditë para ngjarjes, më 5 shkurt 1981, tre grupe mësimore marshuan drejt malit të Meçekut, u rrotulluan nëpër mjegull, llohën e shiut nëpër majë-kreshtave të Malit me Gropa dhe zbritëm drejt Staneve të Bastarës, që ngjante si të zbrisje prej Ferrit. Ishte një itinerar i përcaktuar dhe i sanksionuar me program. Ndërkohë që “programi ishte ligj” dhe do të zbatohej në mënyrë të përpiktë. Mbi borën e parë që kishte ngrirë kishte rënë sërish dëborë dhe ishin krijuar dy breza dëbore, një si bazament dhe tjetri si “racion” për ne që stërviteshim në kushte ekstreme të dimrit. Vende-vende era “kishte ndihmuar”, që lartësia e borës të arrinte deri në dy metra e më shumë sidomos në vende ku erërat kishin grumbulluar togje me dëborë. Gjatë gjithë itinerarit rreth tetëdhjetë studentë të veshur me gjithë pajimet e ushtarit, me lopata këmbësore në dorë dhe të lidhur me litar përshkruan në një ditë nga më të egrat e viteve gjithë mjegull, erë, ngricë, e shumë dëborë. Shiu që “shkundej” nga retë nuk arrinte të zbriste në tokë sepse ngrinte në ajër e kthehej në mijëra gjilpëra akulli që na shponin fytyrën. Trupi nuk bindej me lehtësi, edhe pse Urdhri mbetej urdhër, pra nuk kishte diskutim. Kthenim kokën majtas e djathtas për të thërrmuar ato copëza akulli që kishte veshur pelerinën rreth qafës teksa marshonim. Në masë dërmuese nuk kishin provuar të tilla sfida edhe ne që vinim nga viset më të ashpra të malësive shqiptare në jug dhe në veri të vendit. Në mendjen tonë ngelën pedagogët e apasionuar dhe të talentuar Mark Mici dhe Ramazan Zelija që ishin zotëruar potencialë të kolonës studentore. Edhe kur ri-rrotulloheshim malit me gropa të Meçekut dhe dilnim sërish tek pika trigonometrike e majës së malit të Meçekut, askush nuk e humbi toruan por me besim se do t’ia dilnim dhe në fakt në këtë “ditë motër” të ditës së 6 shkurtit 1981, ne ja dolëm. Nga t1k2b2 këmbësor të drejtuar nga pedagogu Ramazan Zelija ishin: Rasim Qerim Balla, Zaho Ferhat Golemi, Kristo Thoma Rrapo, Gjet Mark Bushi, Behar Halit Salillari, Avdi

Bahri Larti, Aleksandër Ali Lamçe, Adem Elmaz Klefti, Agron Zenel Papdeja, Beqir Halil Halili, Dhimitër Spiro Golemi, Fadil Teme Gucaj, Flamur Xhevdet Muskaj, Ilirian Muharrem Kolleshi, Kastriot Petro Goga, Kamber Fahri Zaimaj, Luljan Voisi Taullaj, Nikollaq Stavri Gjoka, Pandeli Petro Dema, Qemal Rifan Halilaga, Simon Kozma Stambolliu, Shpëtim Mustafa Bllaca, Ilir Rapo Mema, Thoma Kristaq Xoxa, Xheladin Shaban Dashllani dhe Isuf Ali Vllaso. Por në fakt marshimi i ditës stërvitore të 5 shkurtit 1981 përfundoi me sukses dhe të tre grupet mësimore u kthyen shëndoshë e mirë në qendrën stërvitore të fushimit në Feken, sipër Selitës së Malit, por nga ana tjetër ishte një paralajmërim për ditët që do të pasonin.

Befasia e ortekut përballë heroizmit masiv të studentëve dhe solidaritetit ushtarak

Heroizmin masiv të studentëve të Shkollës së Lartë të Bashkuar do ta “vinte në provë” edhe rrëshqitja e dy ortekëve nga faqja e Malit të Meçekut. Përpara kësaj ngjarjeje ajo ishte thjesht një zonë e ashpër malore, ku bora binte dimrave si në “shtëpinë e vet”. “Qetësinë” ia “prishi” gjallëria dhe vrulli studentor ushtarak i viteve '70-'80-të, që vijon edhe sot e kësaj dite. Askush nuk besonte se një pllakë mermeri do të përjetonte një ngjarje mjaft të rëndë tragjike, ku më 6 shkurt 1981, humbën jetën në krye të detyrës njëmbëdhjetë oficerë dhe studentë ushtarakë, tre oficerë dhe tetë studentë të Shkollës së Bashkuar, komandanti i batalionit të parë të këmbësorisë Dushan Fejzi Shameti 31-vjeçar nga fshati Dorëz i Tepelenës, Çlirim Halil Pulaj 36-vjeçar, shef i planëzimit, nga Tragjasi i Vlorës; Nikollaq Naun Bero 37-vjeçar, pedagog taktike nga Berati; Aleko Thimio Gjoni 23-vjeçar, student dega prapavijë, nga fshati Nivicë Sarandë; Besnik Sulo Shehu 23-vjeçar, student gjitharmësh nga Picari i Gjirokastrës; Bilbil Zoto Pashaj 23-vjeçar, student gjitharmësh, nga fshati Kremenar, Mallakastër; Bujar Masar Ago 23-vjeçar, student dega prapavijë, nga Tirana; Ilir Stefan Gramatikoi 23-vjeçar, student, dega prapavijë, nga Tirana; Pëllumb Hysen Rrapo 23-vjeçar, student, dega prapavijë, nga Berati; Qemal Qazim Lika 23-vjeçar, student gjitharmësh, nga Tirana, Nexhip Dervish Çoba 21-vjeçar student viti i dytë nga Kavaja. Ndërsa mbetën të dëmtuar më rëndë Përparim Veliu, student, dega prapavijë nga Saranda dhe Luan Muça student gjitharmësh, nga Peshkopia. Nga ngjarja kishte edhe rreth 70-80 studentë e oficerë që u plagosën rëndë ndërkohë që të plagosurit në total ishin rreth 360-400 studentë e oficerë. Dimri shumë i ashpër, koha me shi e dëborë, ka qenë e parapëlqyer për stërvitjet dimërore, ndërkohë që edhe një ekip inspektimi nga Ministria e Mbrojtjes Popullore ka qenë në fushim. Natën e 5 shkurtit duke u gdhirë 6 shkurti një shi i ftohtë me flokë dëbore trazuar, ra përgjatë gjithë natës dhe mbi dëborën që kishte rënë më përpara ra një shtresë e re dëbore, e cila dukej sikur “flinte”, por edhe në gatishmëri për të rrëshqitur. Kjo e vështirësoi shumë lëvizjen tonë për ngjitjen në malin hije rëndë të Meçekut. Mëngjesi i 6 shkurtit 1981,

ngjante një mynxyrë, por zbatimi i programit stërvitor nuk njihte tërheqje, as ndërrim destinacioni dhe as lehtësime. Kohë e mot i pabesueshëm dhe i pabesë. Si zakonisht në përditshmërinë e fushimit dimëror ishte rreshtimi i orës 8-të e më tej nga fushimi nën drejtimin e pedagogëve bëhej shpërndarja për stërvitje. Tek “ngjitja malore me teknika të alpinizmit në kushte të vështira të terrenit e të motit”, ishte edhe vëmendja më e madhe e strukturave. Kolona filloi lëvizjen drejt “Qafës së Topave”, ngjiti rrugën automobilistike me grupet mësimore me 204 studentë, një kolonë e gjatë dhe e ngjeshur, që marshimi bëhej duke ecur “në gjurmët e njeri-tjetrit”.

Në krye ishte pedagog Mark Mici pedagogu me përvojë të gjatë pune, me trup atleti, shumë i aftë nga ana profesionale, me një përgatitje fizike të lakmueshme. Instruktazi, teknikat e lëvizjes, masat për plotësimin me sukses të detyrës së alpinizmit, përdorimin i kazmës alpine, mbajtja e litarit kolektiv, përdorimi i çelësave shumë-përdorimesh alpinistikë, komunikimi etj. T1k2b2, i ndoqi me sy e rreshtuar si “togë e gatshme”, atë ditë tragjedi. Pjerrësia e shpatit të malit e vështirësonte shumë marshimin dhe ngjitjen. Por porositi e drejtuesve të ngjitjes malore “kujdes shokun!”, “Ndihmoni njeri-tjetrin!”, “Mos krijoni shkaputje!”, “Shkelni në gjurmët e shokut!”, “Mos lësho litarin për asnjë çast!” etj., ishin urdhëruese për cilindo pjesëtar të kolonës. Togat e këmbësorisë në krye dhe më tej toga e prapavijës, ndërlidhjes, AKA-së. Marshimi vijonte i sigurt përmes pyllit me ahishte. Kolona doli tek “tre pemët e vetmuara”, që ishin si pikë orientimi për kalimin e studentëve. Qetësi, ndërkohë që dëgjoheshin vetëm fëshfërimë degësh e shkurresh. Fjalët e studentëve i merrte era, era e ftohtë që u thante veshët si dhe fishkëllente pa pushim, si të njoftonte tragjedinë e asaj dite. Kur “koka” e kolonës ishte rreth 250-300 metra nga maja e malit, më shumë se gjysma e kolonës kishte dalë nga pylli në pjesën e zhveshur të malit por të mbuluar nga bardhësia e dëborës. Ndërkohë grupi i sigurimit të kolonës, devijoi majtas rreth njëqind metra, sepse i tillë ishte programi për ngjitjen, “duke krahë marrë malin”. Por ndërkohë gjurmët e studentëve prenë njëherazi edhe dëborën e re që ishte mbi dëborën e akullit (dhe dukej se kishte rënë një ditë më parë). Kështu shtresa e dëborës që nga maja u shkaput rrufeshëm dhe në fare pak sekonda goditi gjithë kolonën e marshimit. Gjithë faqja e malit me dëborë në gjithë gjerësinë rrëmbeu me vete çfarë gjeti përpara, duke u shndërruar kështu në një grumbull dëborë të fuqishëm dhe të rrezikshëm. Orteku mori përpara studentë e pedagogë, shkarpa, degë, trungje, gjithçka. Kishte filluar “përleshja” me dëborën për të shpëtuar jetën e tyre dhe jetën e shokëve. Uturima e dëborës zbriti shpatit të malit dhe u bashkua me thirret e studentëve që kërkonin shokët. Sigurimi i kolonës nuk kishte më vlerë i lidhur, por fati i ndihmoi të ndaleshin në një grumbull shkurresh e pemësh. Litarët kolektivë dhe çelësat e sigurisë nuk kryenin më punë. Fenomeni i ekstremi natyror i tipit “ortek”

kishte ligjësitë e veta. Mbështetja humanitare kishte dalë në plan të parë. Ishte më shumë se një gjëmë. Nga protagonistët e ngjarjes kemi shkaputur të dhëna nga Bashkim Lika (ish-pedagog i përgatitjes fizike) që ishte në marshimin e datës 6 shkurt, në ditën e tragjedisë: “Orteku i parë rrëmbeu më shumë se gjysmën e kolonës me një goditje të befasishme. Ajo ishte një gjëmë. Orteku rrëmbeu, sa hap e mbyll sytë, gati tërë kolonën e gjatë të studentëve që i ngjiteshin Meçekut, në atë fillim shkurti të acartë. Ishte demonstrim alpinistik mbi majëmalet e ngarkuara me dëborë...Ishte mëngjesi i 6 shkurtit i vitit 1981. Një ditë e ftohtë dhe me erë të rrëmbyeshme. Grupet mësimore (toga) me 204 studentë, atë ditë do të përpunonin ngjitjen malore me elementë të alpinizmit, në një terren të thyer dhe me trashësi të madhe bore. Nisja ishte e zakonshme, si në të gjitha ditët e tjera. Kolonën e marshimit e udhëhiqte, si gjithnjë në të tilla stërvitje, pedagogu i talentuar Mark Mici gjithmonë optimist dhe plot energji. Për çdo rast nevojë, ishin pesëmbëdhjetë pushkatarë të vendosur: pesë në krye të kolonës, pesë në mes dhe pesë të tjerë në fund të saj. Ata ishin garantuesit e jetës së shokëve nga çdo e papritur gjatë marshimit. Kështu veprohej gjithnjë në demonstrime që bënim jashtë fushimit e sidomos gjatë stërvitjeve në lartësi dhe në pyje, ku edhe gjatë verës nuk ka jetë. Na kishte ndodhur jo rrallë përballja me kafshë të egërsuara, maje edhe me arinj të uritur. Gjithsesi, vështirësive të kësaj natyre ua kishim marrë dorën dhe u paraprinim me masa sigurie të veçanta. Kur kreu i kolonës arriti tek vendi i quajtur “Tre pemët e vetmuara”, siç ishte koduar në hartë, na rrëshqiti nën këmbë me një shpejtësi të jashtëzakonshme e tërë faqja e malit, mbështjellë me një trashësi të madhe dëborë. Ishte një goditje e menjëhershme dhe e fuqishme, që ushtoi me një gjëmim shurdhues dhe rrëmbeu me vete sa hap e mbyll sytë gati gjysmën e kolonës. Për pak sekonda shokët “humbën” nën trashësinë e dëborës. Një mal i madh dëborë rrëshqiste me shpejtësi të rrufeshme shpatit të thepisur. Panik, ulërime, britma, thirrje dhe krisma armësh vijuan për pak çaste. Ata që mundën të dalin nga masivet e bardha të borës bërtisnin e kërkonin ndihmë, për të shpëtuar shokët e mbetur në rrënojat e ortekut, që kishte përfshirë më shumë se gjysmën e efektivit. Goditja e parë ishte vala e parë që çoi studentë e oficerë mes masivit të borës me trupa të gjymtuar, pajisje të shpërndara poshtë e lart, një gjëmë e vërtetë, pa mundësi bilanci të plotë mbi humbjet, gjymtime, dhe ata që prisnin me shpresë nën rrënojat e bardhësisë së ortekut të dëborës. Por mësimi nga tradita e zonave alpine shqiptare se, zhurmat dhe krismat shkaktojnë ortekë të tjerë ishte neglizhuar dhe për këtë u pagua rëndë me jetë njerëzish. Ndërkohë që “Tre pemët e vetmuara” në faqen e malit të Meçekut kanë ngelur prej 45 vitesh një stacion përjetësie, ku orteku i dytë “sulmoi” studentët dy herë atë fillim shkurti të vitit 1981.

Orteku i dytë në faqe të Meçekut, i fortë, i tmerrshëm dhe më tragjiku për shokët tanë

Sapo në komandë të Shkollës së Bashkuar (të transferuar

këto ditë në Feken), në qendër të fushimit ishte dhënë kushtrimi, pritej nga momenti në moment të vinin shokët e tjerë, për të kërkuar të humburit dhe për të transportuar të gjymtuarit. Nga Shtabi i Përgjithshëm, kishin ardhur edhe ushtarakë madhorë për të inspektuar demonstrimet stërvitore në kushtet e vështira të motit dhe terrenit. Fakt është se rreth dy orë pas orteikut të parë ra edhe orteiku i dytë që ishte më i fuqishëm, më i tmerrshëm dhe më tragjik. Në vendin e ngjarjes ishte grumbulluar një numër i konsiderueshëm studentësh nga efektivit i shkollës. Fill pas dhënies së sinjalit të kushtrimit nga togat që bënin ngjitjen malore ndër të parët që mbërritën aty ishin toga e gatshme e fushimit t1k2b2 e drejtuar nga Rasim Balla. Bashkë me togën e gatshme me makinën e gatshme u nis edhe Vasil Nathanaili dhe oficeri i degës së planëzimit Çlirim Pulaj, sot “Dëshmor i atdheut”. Makina nuk mund të ngjitej më tej prej rrugës me akull si dhe dëborë të ngjeshur të bërë si akull. Kështu që pas përpjekjeve makina ngeli disa metra mbi “Qafën e Topave”. Toga tonë e gatshme, u nis me këmbë, ndërkohë që drejt rrugës këmbësori direkt mbi godinat e Fekenit, ishte nisur i pari komandanti i batalionit Dushan Shameti. Mbërritja ishte e shpejtë dhe menjëherë filloi puna. Prezenca ishte masive si Petrit Murzaku, Abaz Çipi, Sali Xhakupi, Nikollaq Bero, Luftar Guri, Myzafer Kambo etj. Të gjithë kërkonin të ndihmonin të dëmtuarit dhe kërkonin trupat e shokëve nën rrënojat e dëborës. Goditja e furishme dhe në mënyrë të papritur shkaktoi edhe më shumë viktima. Kacafytja me përbindëshin e bardhë, pamjet rrëqethëse, zërat lemeritës të studentëve, nga plagët e shumta, dhimbja për shokët e vdekur, kishin sjellë një gjendje ankthi, një dramë të jashtëzakonshme. Dy orë gjermime në dëborë më shumë me duar. Stërvitja u ndërpre dhe mali kishte ndalur frymën. Në këtë operacion për të shpëtuar shokët, do të mbeteshin pishtarë të humanizmit dhe solidaritetit ushtarak. Befasia, tronditja, llahtaria e ditës së zezë të tragjedisë u mbyll pas tre ditësh, kur e gjithë shkolla po kërkonte viktimën e fundit të orteikut që e kishte rrëmbyer me thonjtë e vdekjes. Por në këtë rast pati dhe shumë të tjerë të gjymtuar me plagë të rënda. Të goditur më rëndë ishin Përparim Velu nga Saranda dhe Luan Muça nga Peshkopia. Media e kohës nuk mund të fliste asnjë fjalë për këtë tragjedi, asnjë botim a njoftim, për shkak të karakterit sekret stërvitor, por dhe për të mos përhapur panik, ndërkohë që ishte edhe psikologjia e vetë sistemit të kohës që për këto ngjarje nuk flitej kurrë në “mexhllis”. Edhe transportimi i trupave të viktimave ishte bërë në muzgun e natës në kushtet e mungesës së plotë të kontaktit me qytetarët e tjerë. Urdhri i Mehmet Shehut ishte që studentët e vdekur të visheshin me uniformën e ceremonialit të oficerit dhe pushteti vendor kishte marrë masa ekstreme të kujdesit dhe vigjilencës në gjithë ceremonitë mortore, kudo u përcollën të rënët. Ata ishin studentë e oficerë me shpirt, të rinj që e kishin të shenjtë dashurinë për vendin dhe për shokët deri në sakrificën supreme. Të japësh jetën për shokun, nuk ka asnjë mënyrë tjetër më dëshmuese për të vërtetuar sinqeritetin e dashurisë njerëzore dhe humanizmit njerëzor. Ishte një meritë e

shkollës, burim i pashtershëm përvojë për arsimimin ushtarak. Për përjetësimin e veprës së dëshmorëve, është ngritur një Memorial, një lapidar në lulishten kryesore të Garnizonit Ushtarak “Skënderbej”, është vendosur një copëz shkëmbi nga Mali i Meçekut. Në atë copëz shkëmbi memorialistik është vendosur një pllakë përkujtimore me emrat e 11 dëshmorëve. Dhe mbi të një shqiponjë si shpirti i bardhë i dëshmorëve ushtarakë, që qëndron përjetësisht në roje të tyre dhe duket se ka dalë nga zemra e flamurit tonë kombëtar. Shkrime të shumtë, proza, poezi e poema dhe një film dokumentar “Orteku”, veçanërisht në këto dy dekadat e fundit që sjellin shpirtin atdhetar e human, nga dëshira dhe pasioni për të përjetësuar veprën dhe emrin e madh të dëshmorit të Atdheut. Kadri Shameta ka publikuar librin “Bijtë e pavdekshëm të Shkollës së Bashkuar të Oficerëve”, një përshkrim njerëzor të natyrores orteik bore të malit të Meçekut. Vala e dytë e orteikut, kur ata shkuan për të shpëtuar shokët që i kishte zënë vala e parë, u bë skena ku u shpalosën në mënyrë madhështore cilësitë e larta morale dhe humane të oficerëve dhe studentëve ushtarakë. Peshë “plumb” e dhimbjes për humbjen e shokëve, ishte, është dhe gjithmonë do të jetë e madhe. Edhe mobilizimi i strukturave shtetërore si dhe vetë studentëve ishte i madh. Orteku nuk priste për porosi dhe amanete, por preu në besë jetë dhe ëndrra rinore. Dashuria njerëzore u shpalos në këtë ditë tragjike, kur të plagosurit rëndë u transportuan në “Qafën e Patates”, ku erërat e forta nuk lejonin uljen e helikopterëve të ardhur nga Farka. Guximi i pilotëve bëri që pranë efektivit të ishte vetë shefi i Shtabit të Përgjithshëm Veli Llakaj, me staf mjekësor nga Spitali Ushtarak (sot spitali i Traumës), të cilët filluan mjekimet në kushte fushore. Përparësi ishte shpëtimi i sa më shumë jetësh njerëzore prandaj edhe u fillua me të aksidentuarit më rëndë, që luftonin për jetën. Fakt është se stafi drejtues i Shkollës së Bashkuar të drejtuar nga komandanti Rustem Peçi sapo u informua për ngjarjen, vlerësoi në mënyrë të rrufeshme situatën e rëndë, bëri organizimin e menjëhershëm të të gjithë trupës komanduese, pedagogjike dhe studentore për të ndihmuar të dëmtuarit nga goditja e dy orteikëve. Gjithë komanduesit oficerë, pedagogë dhe studentë, ndërprenë stërvitjen dhe nga të gjitha drejtimet, nga fushimi, nga “Qafa e shefave”, “Shkëmbi i Selitës”, “Qafa e vdekjes”, qafa “Isuf Plloçi”, iu gjendën në mënyrë të menjëhershme në ndihmë të dëmtuarve nga orteiku në faqen e malit të Meçekut nga “tre pemët e vetmuara” e deri në rrugën automobilistike që lidhte qafën “Isuf Plloçi” me qendrën stërvitore të Fekenit. Por pavarësisht masave të menjëhershme dhe që në fakt u shpëtuan shumë jetë njerëzore, përsëri në shpatin e pjerrët të Meçekut ngelën dhe dhanë shpirt njëmbëdhjetë dëshmorë. Fakt është se përkujtimi i shokëve tanë dëshmor, në katër dekada e gjysmë nuk ka munguar kurrë. Kështu, Dëshmorët e Fekenit vetëm tre vite më parë, më 6 shkurt 2023, përbri Liqenit të Farkës në Tiranë, me kontributin financiar të ish-ushtarakut Agron Zerani, aktualisht biznesmen dhe bamirës u promovua memoriali kushtuar “11 Dëshmorëve të Atdheut”,

kushtuar tetë ish-studentëve dhe 3 ish-Pedagogëve të Shkollës së Lartë të Bashkuar të Oficerëve, të cilët ranë në krye të detyrës, gjatë zhvillimit të një Stërvitje ngjitje malore në Malin e Meçekut, në një mot të vështirë, ku një ortek i fuqishëm dëbore, u mori jetën në lule te rinisë djemve të shkollës burrërore të përgatitjes së oficerëve shqiptarë. Akti heroik i këtyre Dëshmorëve u përjetësua, në një Memorial të ri kushtuar heroizmit të tyre, ku në përrurimin e tij merrnin pjesë familjarët e studentëve dhe oficerëve të rënë në detyrë, personalitete shtetërore si ish-Presidenti i Republikës Bami Topi, ish-ministri i Mbrojtjes Niko Peleshi, zv/Shefi i Shtabit të Përgjithshëm, Zv/Kryetar i Bashkisë së Tiranës dhe qindra ish-Ushtarakëve si dhe oficerë aktivë të Forcave të Armatosura, të Policisë së Shtetit dhe banorë të Tiranës. Sa herë që do të kujtohen dëshmorët e Fekenit, nuk janë vetëm studiuesit e historiografisë ushtarake, por në një front me ta janë të përbashkuar edhe ushtarakë e ish-ushtarakë, që shkruanin dhe shkruajnë me zemër për këtë ngjarje që la gjurmë që nuk shlyhen edhe pas katër dekadash dhe nuk do të shlyhen për dhjetëra e dhjetëra dekada që do të vijnë. Prandaj për dëshmorët e Fekenit do të përkujtohen, do të shkruhet edhe në të ardhmen, sepse maksima proverbiale, kush kujtohet nuk harrohet, është vërtetuar në praktikën jetësore.

45 vite bashkë me ne, në çdo stërvitje, në çdo rreshtim, në çdo mision, në çdo apel...

Njëmbëdhjetë Dëshmorët e Fekenit, komandantë, pedagogë e studentë të ish-Shkollës së Bashkuar të Oficerëve, sot AFA, ranë në stërvitjen dimërore mbi kazermën e stërvitjes dimërore të Fekenit, duke u ngjitur në Meçek. Ushtarakët dhanë jetën për të shpëtuar jetë me një akt sublim, një simbolikë e papërsëritshme e formimit të lidërshiptit për të ardhmen ushtarake shqiptare. Një shëmbëlltëry motivimi, një forcë karakteri, me të harruarin "shembullin personal" në kufijtë e vetëmohimit. Ka qenë një forcë e brendshme e njerëzve nën uniformë të rreshtuar në armatën me palcë kombëtare, në armatën që diti të mposhtë e triumfojë mbi kushtet më ekstreme atmosferike të shkurtit të vitit 1981. Edhe sot motivi ushtarak i strukturave të Forcave të Armatosura është njësh me detyrimin madhor në përmbushje të misionit, në përballje me emergjencën civile të shkaktuar nga kushtet e rënda atmosferike. Kjo është e vërtetueshme përditë, sepse edhe sot Forcat e Armatosura mbajnë ndezur e forcojnë brez pas brezi procesin e arsimimit dhe trajnimit ushtarak. Stafeta vijon të pasohet nga brezi në brez dhe po kështu edhe historia e njëmbëdhjetë dëshmorëve. Kujtimi i të rënëve dëshmorë në Feken është frymëzim, një akt heroik e sublim, një "stacion" i rëndësishëm i historisë ushtarake, një stacion përjetësie, por dhe pjesë e pandarë e jetës së përditshme ushtarake. Në çdo apel ushtarak nuk mungojnë ata që shkruan histori sublime, më 6 shkurt 1981: Komandant Dushan Shameta, Shef i Planizimit Çlirim Pulaj, Pedagog Nikolla Bero si dhe studentët Aleko Gjoni, Besnik Shehu, Bilbil Pashaj, Bujar Ago, Qemal Lika, Pëllumb Rrapo, Nexhip Çopa, Ilir Gramatiko.

Dëshmorët emërndritur të barrikadës së sigurisë dhe

mbrojtjes shqiptare

Studentët ushtarakë dhe oficerët që ranë në faqen e malit të Meçekut janë pjesë e pandarë e vlerave më vitale të shkollës dhe të shoqërisë, janë vlera e përhershme frymëzuese e kombit. Ata ranë për Atdheun, për idealet e pastra të solidaritetit njerëzor, të unitetit ushtarak, prandaj mirënjohja për gjakun e derdhur është nderim në përjetësi, për aktin sublim të dhënies së jetës për atdhe. "Dëshmor" është një emër i ndritur për të gjithë kombet e botës. Kështu janë dhe dëshmorët Fekenit, për kombin shqiptar, pasi ata nuk janë thjeshtë numra, por vlera hyjnore, respekti, mirënjohjeje, kujtimi për ushtarakët dhe më gjerë. Ata nuk janë emra në varre, nuk janë lapidarë e memorialë, por vlera të përjetësisë kombëtare, të nderuar dhe respektuar në përjetësi. Dëshmorët e Fekenit janë, sikurse gjithë dëshmorët e tjerë të Shqipërisë, një pasuri e kombit që lidhin të djeshmen me të sotmen, janë trashëgimi e ndërgjegjes kombëtare, vlerë dhe virtyt i krenarisë familjare e krahinore, materie e ndërgjegjes së kombit që lidhin të djeshmen me të sotmen kur në gojë e popullit është materializuar me shprehjen tashmë të profetizuar se, "pa të shkruar nuk ka të ardhme". Njëmbëdhjetë dëshmorët e Fekenit janë simbol përbashkues, për të cilët mirënjohja rrjedh natyrshëm dhe në këtë kuadër respektimi i vlerave njerëzore, nuk mund të dekretohet e as të shpallet ligjërisht, sepse ka një të drejtë zakonore, një kanun e ligj që buron nga e drejta e ekzistencës së kombeve, kështu edhe për kombin shqiptar. Volteri thoshte se, "Trimëria është produkt i qartësisë", që kupton qartësinë e vetëflijimit për kauzën e kombit. Nga antikiteti latin vjen thënia proverbiale: "Gjaku është fara e lirisë". Gjaku i dëshmorëve të Fekenit që ranë në zemër të malit të Meçekut, ishte sakrificë sublime për sigurinë dhe mbrojtjen e popullit, dinjitet për brezat e rinj ushtarakë të Forcave të Armatosura. Ne, ish-studentët ushtarakë, që i përjetuam ato ditë tragjike të 6 shkurtit 1981 dhe më pas u "certifikuam" në kudhrën e mbijetesës dhe përkujtimit legjitim, ndërkohë që sjellim në vëmendje e kujtesë edhe masat e marra nga strukturat e MMP (sot Ministria e Mbrojtjes) dhe komanda e shkollës në përcjelljen e të rënëve pranë familjeve të tyre, për organizimin e ceremonive mortore, për t'iu dhënë lamtumirën e fundit shokëve tanë. Dhimbjes në përcjelljen e të rënëve në spitalin ushtarak, iu bashkua Ministri i Mbrojtjes Popullore Kadri Hazbiu dhe më tej të plagosurit e tragjedisë së Fekenit i vizitoi edhe kryeministri i kohës Mehmet Shehu. Fakt është se për katër dekada e gjysmë një lot i ngrirë ka ngelur në historikun e Shkollës së Lartë të Bashkuar të Oficerëve, një lot që nuk do të shkrijë kurrë në historikun e arsimimit ushtarak shqiptar, një lot që përkujton trimërinë, humanizmin, solidaritetin studentor ushtarak si burim frymëzimi për brezat e shkollës ushtarake shqiptare, për brezat e rinj të studentëve të AFA-së dhe më gjerë, për shokët e tyre ish-studentë që nuk do t'i harrojnë kurrë. Nderimi, respekti dhe mirënjohja për shokët tanë dëshmorë është i përjetshëm dhe për këtë ata do të jetojnë përgjithmonë në pavdekësi.

EUROPE AND RUSSIA ON THE BALKAN FRONT



BALLKANI midis “NDAA-2026” dhe operacioneve hibride ruse



KOLONEL HYSNI GJERGJI
IKSHU/AFA

Deklarimet e dokumentit të mbrojtjes të 18 dhjetorit 2025, të SHBA (National Defense Authorization Act – NDAA), sjellin një **ndryshim të dukshëm konceptual për Ballkanin**, i cili nuk shihet më vetëm si rajon për t’u stabilizuar, por si **hapësirë konkurrence strategjike**. Dokumentet e mëparshme amerikane të sigurisë gjatë dy dekadave të fundit e kanë trajtuar Ballkanin Perëndimor si **hapësirë post-konflikti**, ku prioritet ishte ruajtja e paqes dhe menaxhimi i tensioneve etnike. Ballkani ka qenë në periferi të interesave madhore strategjike, me theks të veçantë të roli i NATO-s, si garant stabiliteti dhe të dialogu politik si instrument kryesor sigurie.

Kosova përmendej kryesisht si çështje e pazgjidhur politike, nën ombrellën e KFOR-it dhe diplomacisë ndërkombëtare.

Në dokumentin NDAA-2026, stabiliteti i Kosovës dhe i Ballkanit Perëndimor trajtohet si faktor që ndikon drejtpërdrejt në sigurinë e krahut juglindor të NATO-s, në besueshmërinë e angazhimit amerikan në Evropë dhe në kufizimin e ndikimit rus. Ky ndryshim konceptual e integron rajonin në arkitekturën e përgjithshme të mbrojtjes kolektive, jo më si rast i veçantë, por si pjesë e planifikimit strategjik.

Në dokumentet e mëhershme, Kosova shihej kryesisht si **përfitues sigurie**, e varur nga prania ndërkombëtare. Në qasjen e vitit 2025, ajo trajtohet si partner i orientuar drejt NATO-s, faktor stabiliteti në terren, dhe pjesë e aleancës rajonale ndaj ndikimeve të jashtme. Dokumenti i dhjetorit 2025 e integron Kosovën si **nyje strategjike**, ku ndërthuren interesat euroatlantike dhe përpjekjet ruse për ndikim politik, informativ dhe të sigurisë. Dokumenti i 18 dhjetorit 2025 e pozicionon **mos ndryshimin e kufijve dhe integritetin territorial** si element të pa negociueshëm të stabilitetit rajonal.

Ballkani i vitit 2026 gjendet në një hapësirë tensioni të vazhdueshëm, ku frika dhe joshja bashkëjetojnë si dy forca paralele në marrëdhënien me Rusinë. Në një rajon historikisht të ndjeshëm ndaj ndikimeve të jashtme, Moska vazhdon të mbetet një aktor i pranishëm jo përmes pranisë fizike, por përmes narrativave, lidhjeve energjetike, afërsive kulturore dhe kalkulimeve gjeopolitike afatgjata. Frika buron nga perceptimi i destabilizimit. Përvoja e konfliktit në Ukrainë ka thelluar dyshimin se ndikimi rus nuk është thjesht diplomatik, por instrument strategjik që shfrytëzon dobësitë institucionale, ndarjet etnike dhe polarizimin politik në Ballkan. Për disa shtete, Rusia shihet si faktor që sfidon orientimin euroatlantik dhe ngadalëson proceset e integritetit evropian, duke ruajtur rajonin në një gjendje paqartësie të përhershme.

Megjithatë, paralelisht me frikën ekziston edhe joshja. Rusia ofron një narrativë alternative ndaj Perëndimit: sovranitet pa kushte, mbështetje politike pa reforma të dhimbshme dhe energji si mjet ndikimi ekonomik. Kjo qasje gjen terren në shoqëri ku zhgënjimi ndaj BE-së është rritur për shkak të zgjerimit të vonuar dhe premtimeve të pabarazuara. Për disa aktorë politikë ballkanikë, Moska përfaqëson jo domosdoshmërisht


një aleat strategjik, por një levë negociuese në raport me Brukselin dhe Uashingtonin.

Në vitin 2026, Ballkani nuk është as plotësisht nën orbitën ruse, as imun ndaj saj. Rajoni funksionon më tepër si hapësirë ndërmjetëse, ku ndikimi i Rusisë matet jo me kontroll territorial, por me aftësinë për të formësuar diskurse, për të ndikuar në vendimmarrje dhe për të mbajtur gjallë alternativën e Lindjes. Kjo e bën praninë ruse të vështirë për t'u identifikuar dhe akoma më të vështirë për t'u neutralizuar. Në fund, dilema ballkanike nuk është zgjedhja midis Rusisë dhe Perëndimit, por mungesa e një pozicioni të qartë dhe të qëndrueshëm rajonal. Frika nga ndikimi rus dhe joshja që ai ofron janë dy anë të së njëjtës pasiguri strategjike. Derisa Ballkani të konsolidojë institucionet e tij dhe të shohë perspektivë të besueshme evropiane, Rusia do të mbetet një prani e ftohtë, por e vazhdueshme, në sfondin politik të rajonit.

Ballkani, edhe një herë tjetër, vallëzoi në ritmin e një kënge të rrezikshme, një këngë e cila ngrohu duart e nacionalizmit, por e ftohu shpresën për paqe. Ngjarja e fundit e organizuar nga Partia Përparimtare Serbe dhe Lëvizja Socialiste më 26 tetor 2025, nuk ishte një aktivitet partiak i zakonshëm, por një demonstrim simbolik. Këngët nacionaliste, referencat ndaj “botës serbe” dhe mesazhet që mohojnë pavarësinë e Kosovës, përbëjnë një **akt me domethënie strategjike**, që shkon përtej kufijve të Serbisë.

Retorika e “botës serbe” krijon perceptimin e një projekti gjeopolitik që po sfidon rendin aktual rajonal. Në aspektin ideologjik, koncepti i “botës serbe” përkon me doktrinën ruse të “Russkiy mir”, e cila justifikon ndikimin kulturor e politik të Rusisë në hapësirat ku jetojnë popuj sllavë apo ortodoksë. Për Rusinë, Serbia vazhdon të mbetet **pikë mbështetjeje politike dhe informative** në rajon. Për Beogradin, afrimi me Moskën shërben si një **mjet presioni diplomatik** ndaj Bashkimit Evropian dhe SHBA-së. Kjo marrëdhënie e ndërsjellë e interesave krijon hapësirë për veprime hibride, propagandë mediatike dhe ndikim të drejtpërdrejtë në opinionin publik serb.

Rusia po e rindërton strategjinë e saj të ndikimit jo më përmes forcës ushtarake, përmes një **koalicioni të heshtur midis pushtetit politik (fronit), institucionit fetar (altarit) dhe emocionit kolektiv të kombit (nacionalizmit)**. Ky trekëndësh simbolik ka prodhuar një formë të re të “fuqisë së butë” serbe, **një ndërthurje politike, shpirtërore dhe propagandistike**, e cila synon të ruajë ndikimin serb në rajon dhe ta mbajë Ballkanin në një gjendje të tensionuar e të pasigurt. Në qendër të këtij



Për paqen
në Ballkan,
nacionalizmi nuk
është vetëm “retorikë
e brendshme”, por
edhe një instrument
gjeopolitik.
Në diskursin e
brendshëm serb,
“bota serbe”
paraqitet si
mbrojtje e identitetit
kombëtar, por në
praktikë, ajo shërben
si justifikim për
të vënë në lëvizje
elementë radikalë që
ushqejnë tensionet
ndëretnike.



trekëndëshi qëndron “froni”, pra **pushteti personal i Aleksandar Vuçiçit**. Ai ka arritur të ndërtojë një sistem të ngjashëm me “demokracitë e kontrolluara”, ku zgjedhjet ekzistojnë, por rezultati politik është i paracaktuar përmes kontrollit të mediave, administratës dhe drejtësisë. “Froni” përfaqëson **instrumentin e real-politikës**, i cili e përdor nacionalizmin për të forcuar pushtetin dhe për të legjitimuar politikën e jashtme të dyfishtë.

Nga njëra anë Serbia flet gjuhën e Brukselit, por nga ana tjetër mendon me kokën e Moskës. Me këtë qasje,

Vuçiç dëshiron të shfaqet si “stabilizuesi” i rajonit para Perëndimit, ndërsa në thelb kultivon retorikën e viktimës historike që mbrohet nga “bota serbe”. Kisha Ortodokse Serbe (jo vetëm e legjitimon politikisht vizionin e Vuçiçit, por e ushqen atë me mitologjinë e “misionit të shenjtë serb” një narrativë që lidh token, fenë dhe kombin në një “fat të përbashkët”. Në këtë trekëndësh, nacionalizmi aktivizohet përmes këngëve, simboleve, historive të betejave të humbura dhe figurave të krijuara, glorifikuara dhe të mitizuara. Në fakt, nacionalizmi serb i shekullit XXI është më i

përpunuar profesionalisht, i ambalazhuar me “kulturë dhe traditë”, por që në thelb mbart elemente të qarta ekspansionizmi kulturor.

Duke përdorur ndjeshmërinë fetare si një formë e diplomacisë publike, feja pozicionohet si një forcë për të kundërshtuar armiqtë e perceptuar ideologjikë, apo për të krijuar rrjete ndërkombëtare populiste fetare për të mbështetur regjimet në fuqi. Rusia e ka shfrytëzuar krishterimin ortodoks për të forcuar ndikimin e saj gjeopolitik, veçanërisht në Evropën Lindore dhe në Ballkan.

Armatosja e përshpejtuar e Serbisë përgjatë 2022-2025, në një rajon ku pothuajse të gjithë fqinjët janë anëtarë të NATO-s nuk është rastësi, por rezultat i një llogaritjeje strategjike shumëdimensionale. Beogradi synon të ruajë autonominë strategjike, duke mos u varur nga garancitë e sigurisë së Aleancës Atlantike dhe kërkon të projektojë imazhin e një aktori që nuk është i detyruar të përshtatet plotësisht me rendin euroatlantik. Armatosja shërben veçanërisht në raport me Kosovën dhe balancën e forcave në Ballkanin Perëndimor. Kapacitetet e reja ushtarake rrisin peshën negociuese të Serbisë dhe synojnë të krijojnë një perceptim fuqie që frenon presionin politik dhe diplomatik nga jashtë. Dimensionin e armatosjes lidhet me luftën hibride dhe ndikimin rus dhe e pozicionon Serbinë si një aktor balancues, por edhe si pikë potenciale tensioni në krahun juglindor të NATO-s.

Gjithashtu, kisha mbështet fraksionet pro ruse brenda kishave ortodokse, duke krijuar përçarje midis atyre që janë të lidhura me Moskën dhe atyre që njohin Patriarkanën Ekumenike në Stamboll. Për vendet anëtare të NATO-s dhe prezencën e saj në Ballkan, **modeli “hibrid i ndikimit” është po aq i rrezikshëm sa një operacion hibrid ushtarak**. Ai nuk vepron me tanke dhe raketa, por me **emocione, besim dhe narrativë patriotike kombëtare**. Aktivitete të tilla nuk janë të izoluar, por kanë një tendencë në rritje të **militarizimit të politikës serbe**, ku ushtria, kultura e luftës dhe mitet historike përdoren si instrumente frymëzuese, rekrutuese dhe mobilizuese. Këto mesazhe vështirësojnë bashkëpunimin rajonal në kuadër të NATO-s dhe PfP, duke e rritur **rrezikun e polarizimit** mes vendeve me orientim euroatlantik dhe atyre me lidhje tradicionale me Rusinë. Serbia

përballë një zgjedhjeje strategjike që shtrun (National Defense Authorization Act – NDAA i dhjetorit 2025), nuk mund të shmanget pafundësisht. Pyetja shtrohet: a do të mbetet ajo në kursin e neutralitetit formal, por me varësi politike nga Moska, apo do të afrohet realisht me strukturat euroatlantike? Narrativat nacionaliste dhe retorika anti-Kosovë e shtyjnë Beogradin në drejtimin e parë dhe e **largojnë perspektivën evropiane**, duke e pozicionuar Serbinë si një **aktor të paqëndrueshëm** në sistemin e sigurisë rajonale.

Për paqen në Ballkan, nacionalizmi nuk është vetëm “retorikë e brendshme”, por edhe një **instrument gjeopolitik**. Në diskursin e brendshëm serb, “bota serbe” paraqitet si mbrojtje e identitetit kombëtar, por në praktikë, ajo shërben si justifikim për të vënë në lëvizje elementë radikalë që ushqejnë tensionet ndëretnike. Në një kohë kur Rusia përpaket të ruajë ndikimin e saj përmes propagandës, energjisë dhe operacioneve informative, çdo gjest pro-rus i Serbisë kthehet në **fitore simbolike për Kremlinin** dhe në humbje për stabilitetin rajonal.

Manifestimet politike në Serbi dhe Bosnjë, nxisin frikën e ndarjes së re të entiteteve, ndërsa në Malin e Zi dhe Maqedoninë e Veriut, ushqejnë tensione etnike e fetare. Në një plan më të gjerë, ato vështirësojnë bashkëpunimin e vendeve të rajonit me NATO-n dhe strukturat euroatlantike, duke e vendosur **Ballkanin në frontin një lufte të re të ftohtë**, ku Rusia kërkon ndikim, ndërsa Perëndimi përpaket të ruajë kohezionin.

Serbia për 2026 dhe zhvillimeve SHBA-Rusi, gjendet përballë një dileme strategjike, të mbajë neutralitetin formal me prani ruse në thelb, apo të zgjedhë përfundimisht kursin euroatlantik. Unë besoj se ajo po pret, po punon dhe po lutet fort për një ndryshim të rendit botëror të kërkuar nga Rusia. Për ne fqinjët dhe për strukturat e sigurisë evropiane përfshirë NATO-n, mesazhi është i qartë, **stabiliteti i Ballkanit nuk mund të merret i mirëqenë**, pasi çdo “këngë e rrezikshme” mund të kthehet shpejt në sfida reale për paqen. Në një rajon që ende mban plagët e së kaluarës, tingujt e nacionalizmit janë gjithmonë më të zhurmshëm se zërat e diplomacisë. Kjo që po ndodh është një **luftë kulturore dhe psikologjike** për ndikim, e cila nëse nuk njihet dhe përballohet me inteligjencë strategjike, mund të prodhojë destabilizim afatgjatë.



MASAKRA E 4 SHKURTIT 1944

**NJË NGA KRIMET MË TË RËNDA
TË PUSHTIMIT NAZIST DHE
KUISLINGËVE NË TIRANË**

KUJTESË HISTORIKE

Më 4 shkurt 1944, Tirana përjetoi një nga netët më të errëta të historisë së saj. Nën pushtimin nazist dhe me pjesëmarrjen aktive të bashkëpunëtorëve shqiptarë, u krye një masakër e përmasave të jashtëzakonshme, që la pas 84 qytetarë të pushkatuar dhe rreth 300 të arrestuar brenda një nate. Kjo ngjarje, e njohur në kujtesën historike si “Nata e Shën Bartolomeut e Tiranës”, mbetet një nga aktet më të rënda të terrorit shtetëror ndaj popullsisë civile gjatë Luftës së Dytë Botërore në Shqipëri.

DUKE PËRKUJTUAR 4 SHKURTIN 1944, FORCAT E ARMATOSURA RIAFIRMOJNË QARTË SE MISIONI I TYRE ËSHTË MBROJTJA E JETËS, DINJITETIT DHE LIRISË SË QYTETARËVE, SI DHE REFUZIMI ABSOLUT I ÇDO FORME TERRORI, KOLABORACIONIZMI APO DHUNE SHTETËRORE NDAJ POPULLIT.

Masakra u krye nga forcat e xhandarmërisë, Regjimenti "Kosova" dhe formacione të Ballit Kombëtar, nën drejtimin e Gestapos gjermane dhe të Ministrit të Brendshëm të asaj kohe, Xhaferr Deva, me përfshirjen e figurave të tjera të administratës kolaboracioniste. Kjo ngjarje përbën një shembull tragjik të keqpërdorimit të strukturave të armatosura në shërbim të pushtuesit, në kundërshtim të plotë me interesin kombëtar dhe me parimet themelore të mbrojtjes së popullit.

Një aksion i planifikuar terrori kundër popullsisë civile

Në orët e natës së 4 shkurtit, grupe të armatosura hynë nëpër shtëpitë e qytetarëve tiranas, me lista të përgatitura paraprakisht. Burra dhe djem u rrëmbyen, u pushkatuan në rrugë, u masakruan barbarisht dhe trupat e tyre u lanë qëllimisht në hapësira publike, për të përhapur frikë dhe për të thyer rezistencën morale të popullsisë.

Raporti zyrtar i Komandës së Xhandarmërisë, i datës 5 shkurt 1944, pohon se gjatë kësaj nate u bastisën mbi 230 shtëpi, u arrestuan 478 persona dhe 84 prej tyre u ekzekutuan. Viktimat përfshinin qytetarë shqiptarë dhe të huaj, përfshirë edhe një hebre, fakt që e vendos këtë krim në të njëjtin kontekst me politikën e terrorit dhe shfarosjes të ushtruar nga nazizmi në gjithë Evropën.

Masakra si instrument pushtimi dhe kolaboracionizmi

Dokumentet arkivore gjermane tregojnë se masakra e 4 shkurtit nuk ishte një reagim spontan apo një hakmarrje personale, por pjesë e një strategjie të qëllimshme terrori për llogari të pushtuesit. Trupat

gjermane qëndruan formalisht jashtë aksionit, duke ua deleguar dhunën strukturave shqiptare, çka e rëndon edhe më tej dimensionin e tradhtisë kombëtare të kolaboracionizmit.

Deklaratat publike të Xhaferr Devës, ku terrori shpallej si mjet qeverisës, përbëjnë dëshmi të qarta të shndërrimit të forcës së armatosur në instrument represioni kundër popullit të vet. Përfshirja e forcave të Ballit Kombëtar dhe heshtja e institucioneve të kohës pas masakrës përbëjnë një njollë të rëndë historike, që nuk mund të relativizohet apo justifikohet.

Kujtesë historike dhe detyrim institucional

Nderimi i viktimave të Masakrës së 4 shkurtit është një detyrim moral, kombëtar dhe institucional. Për Forcat e Armatosura dhe Ministrinë e Mbrojtjes, ruajtja e kujtesës historike nuk është thjesht akt përkujtimor, por pjesë e sigurisë kombëtare. Shoqëritë që harrojnë krimet e së shkuarës rrezikojnë t'i përsërisin ato.

Duke përkujtuar 4 Shkurtin 1944, Forcat e Armatosura riafirmojnë qartë se misioni i tyre është mbrojtja e jetës, dinjitetit dhe lirisë së qytetarëve, si dhe refuzimi absolut i çdo forme terrori, kolaboracionizmi apo dhune shtetërore ndaj popullit.

**KUJTESA HISTORIKE
ËSHTË MBURROJË MORALE E
SHKETIT. MBROJTJA E SAJ
ËSHTË PJESË E MISIONIT TË
FORCAVE TË ARMATOSURA
SOT DHE NË TË ARDHMEN.**



DËSHMIA E ROMAN OLEKSIV, FËMIJA QË I MBIJETOI RAKETËS DHE I FOLI NDËRGJEGJES SË EVROPËS

Anjeza Musollari,
Shefe e Sektorit të Botimeve

Nga plagët e Vinitjas te heshtja që shpërtheu në lot në Parlamentin Evropian

Në sallën solemne të Parlamentit Evropian, ku zakonisht mbizotëron gjuha e ftohtë e diplomacisë, statistikave dhe fjalimit të kalkuluar, atë ditë heshtja kishte një peshë tjetër. Nuk ishte heshtje procedurale. Ishte heshtje njerëzore. Një

heshtje që u thye jo nga zhurma e debateve politike, por nga zëri i një fëmije, një zë i vogël, i thyer, por i mbushur me një forcë që rrallë dëgjohet në sallat e pushtetit.

Roman Oleksiv, vetëm 11 vjeç, qëndronte përballë përfaqësuesve më të lartë të Evropës, jo si simbol abstrakt i luftës, por si dëshmi e gjallë e saj. Trupi i tij mbante shenjat e raketës ruse që goditi qytetin ukrainas të Vinitjas në korrik të vitit 2022. Zëri i tij mbante mungesën e nënës. Dhe historia e tij mbante barrën morale të një kontinenti që po shikonte luftën përmes ekraneve.



Një sulm, një jetë e thyer, një fëmijëri e djegur

Më 14 korrik 2022, një ditë vere në Vinitjsja nisi si shumë të tjera. Roman dhe nëna e tij, Halyna Oleksiv, kishin dalë për një shëtitje në qendër të qytetit. Vinitjsja nuk ishte vijë fronti. Ishte një qytet i qetë në Ukrainën qendrore, larg përplasjes direkte ushtarake. Pikërisht kjo e bën edhe më tronditës sulmin.

Tre raketa ruse 'Kalibr' goditën zonën civile. Njëra prej tyre shpërtheu pranë Shtëpisë së Oficerëve, ku ndodheshin edhe fëmijë, prindër, kalimtarë të rastit. Brenda sekondave, qetësia u shndërrua në flakë, tym dhe britma.

Halyna u vra në vend. Roman u gjet i gjallë, por i djegur rëndë, me plagë të shumta, trupin e mbuluar nga shenjat e shkatërrimit. Mjekët do të thoshin më vonë se mbijetesa e tij ishte mrekulli.

36 operacione dhe një betejë për çdo frymëmarrje

Roman kaloi muaj të tërë në spitale. Trupi i tij iu nënshtua **36 operacioneve kirurgjikale**, ndërhyrje të dhimbshme për të shpëtuar jo vetëm jetën, por edhe funksionet bazë të trupit. Djegiet e shkallës së tretë, dëmtimet në fytyrë, duar dhe këmbë, e kthyen çdo ditë në një luftë të re. Rehabilitimi ishte po aq i ashpër. Dhimbja fizike shoqërohej nga trauma psikologjike: humbja e nënës, kujtimet e shpërthimit, frika nga zhurmat, nga flakët, nga errësira. Një fëmijë që duhet të mendonte për lojëra dhe shkollë, mësonte të duronte dhimbjen dhe të jetonte me mungesën.

Një fëmijë që u kthye në shkollë, jo në urrejtje

Megjithatë, historia e Romanit nuk është vetëm histori vuajtjeje. Është histori rezistence. Pas muajsh trajtimi, ai u kthye në shkollë. Me plagë të dukshme, me trup të ndryshuar, por me një vendosmëri që i habiti edhe mjekët. Presidenti i Ukrainës e nderoi Roman Oleksivin me një çmim për guxim dhe qëndrësë. Por vetë Roman, në fjalët e tij, nuk foli për heroizëm. Ai foli për nënën. Për dëshirën që lufta të ndalet. Për fëmijët që nuk duhet të përjetojnë atë që ai përjetoi.

Dokumentari dhe momenti që theu protokollin evropian

Në Parlamentin Evropian u shfaq një dokumentar kushtuar fëmijëve ukrainas të prekur nga lufta. Pamjet ishin të forta, por asgjë nuk përgatiti sallën për momentin

kur Roman mori fjalën.

Teksa fliste, asistentja e njërit prej nënkryetarëve të Parlamentit Evropian përkthente fjalët e tij. Zëri i saj u drodh. Sytë iu mbushën me lot. Ajo nuk arriti ta fshehë emocionin. Protokollu u shemb. Përkthimi u bë njerëzor, jo teknik.

Lotët e saj u bënë simbol i asaj që shpesh mungon në politikë: empatia reale.

“Unë nuk dua që fëmijët e tjerë të humbasin nënat e tyre”

Roman nuk kërkoi hakmarrje. Nuk kërkoi armë. Nuk kërkoi dënime. Ai kërkoi ndalim. Ndalesë të luftës. Mbrojtje për fëmijët.

Në sallë kishte deputetë që kishin votuar sanksione, rezoluta, paketa ndihme. Por përballë Romanit, të gjitha këto u dukën të pamjaftueshme.

Sepse për herë të parë, pas shifrave të raporteve, kishte një fytyrë. Një zë. Një fëmijë.

Dëshmia si akt politik dhe moral

Dëshmia e Roman Oleksivit nuk ishte thjesht rrëfim personal. Ishte akt politik në kuptimin më të thellë të fjalës. Ai e ktheu luftën nga koncept gjeopolitik në realitet njerëzor. Ai e zhveshi Evropën nga komoditeti i distancës. Në historinë e Parlamenteve, rrallëherë një fëmijë ka arritur të bëjë atë që shpesh nuk e bëjnë diplomatët: të detyrojë një sallë të tërë të ndiejë.

Evropa përballë pasqyrës së saj

Lotët e asaj përkthyesë nuk ishin dobësi. Ishin dëshmi se njerëzimi ende ekziston brenda institucioneve. Por pyetja që mbetet është: **a do të shndërrohet ky emocion në veprim?**

Roman u kthye në Ukrainë. Lufta vazhdon. Fëmijë të tjerë ende humbasin prindërit e tyre. Dhe dëshmia e tij qëndron si një thirrje e hapur për ndërgjegjen evropiane dhe botërore.

Një fëmijë, një nënë, një kontinent

Historia e Roman Oleksivit është histori e një fëmije që humbi gjithçka, përveç dinjitetit. Është histori e një nëne që nuk arriti të mbrojë djalë e saj nga raketat. Është histori e një kontinenti që po mëson, ndoshta me vonesë, se lufta nuk është lajm, është plagë.

Dhe sa herë që politika harron këtë, mjafton zëri i një fëmije për ta kujtuar.



KAPITEN FETI VOGLI

I përjetshëm në memorien e Forcave të Armatosura

20 shkurti: Dita e kujtesës dhe krenarisë

Prej 14 vitesh, 20 shkurti mbledh ushtarakët shqiptarë në një përkujtim solem, ku dhimbja dhe krenaria bashkëjetojnë në heshtje. Është dita kur Forcat e Armatosura përkulen me nderim para kujtimit të Kapiten Feti Vogli, i rënë në krye të detyrës, më 20 shkurt 2012, gjatë një misioni ushtarak në Afganistan.

Ai u nda nga jeta në shërbim të paqes, gjatë një detyre të marrë nga komanda amerikane për të shoqëruar një zyrtar të Shteteve të Bashkuara në një shkollë dhe në një spital në Afganistan. Në përmbushje të këtij misioni, kolona ushtarake u sulmua nga një taleban, i cili hapi zjarr me mitraloz në drejtim të efektivëve shqiptarë. Plumbat goditën kapitenin Voglin, i cili nuk mundi t'u mbijetojë plagëve të marra.

Në të njëjtin sulm mbeti i plagosur rëndë edhe ushtari **Aleksandër Peçi**, duke dëshmuar edhe një herë rrezikun e përhershëm që shoqëron misionet ndërkombëtare të paqes. Rënia e kapiten Voglit shënoi një moment të dhimbshëm për Forcat e Armatosura të Republikës së Shqipërisë, por njëkohësisht një kapitull nderi në historinë e tyre.

Rrugëtimi në FA i kapiten Feti Vogli

Kapiten Feti Vogli lindi, më 23 maj 1981, në fshatin Baldushk, rrethi i Tiranës. Që në rininë e hershme u dallua për karakterin e fortë, disiplinën dhe përkushtimin ndaj uniformës. Pas përfundimit të Akademisë Ushtarake në specialitetin Artileri Tokësore, ai u bë pjesë e Forcave të Armatosura me

detyrën e komandantit të togës në Brigadën e Stërvitjes së Bazës, Bunavi.

Rruga e tij profesionale mori një drejtim të qartë më 16 korrik 2005, kur pas përfundimit me sukses të Kursit Bazë të Forcave Speciale, iu bashkua Batalionit të Forcave Speciale me detyrën e Komandantit të Grupit.

Që nga 1 qershori 2010, kapiten Vogli kryente detyrën e Komandantit të Grupit të Parë Special në Kompaninë e Aksioneve Speciale Ujore, një nga strukturat më elitare të Forcave Speciale shqiptare.

Kolegët e tij e përshkruajnë si një ushtarak karriere të shkëlqyer, kërkues ndaj vetes, të vendosur në detyrë dhe të përkushtuar ndaj vartësve. Ai ishte një komandant që udhëhiqte me shembull personal, duke qenë gjithmonë në vijën e parë.

Medaljet e një karriere të ndritur

Për arritjet dhe profesionalizmin e treguar në detyrë, kapiten Feti Vogli ishte dekoruar disa herë:

- **Medalja e Karrierës (2007)** nga Komandanti i Forcës së Bashkuar;
- **Medalja për Shërbime Ndërkombëtare (2007)** nga Ministri i Mbrojtjes;
- **Medalja për Shërbime të Shquara (2010)** nga Ministri i Mbrojtjes.

Këto vlerësime nuk ishin thjesht simbole ceremoniale, por dëshmi e një rruge të ndërtuar mbi disiplinë, sakrificë dhe përkushtim ndaj misionit.

Misioni "Eagle 4", një kapitull krenarie

Misioni "Eagle 4" i Forcave Speciale shqiptare në Afganistan mbetet një nga angazhimet më të rëndësishme dhe më të kujtuara të kontingjentit shqiptar në operacionet

Heronjve u këndohen veç këngë

*“Shqipet mbjellin paqe në çdo prag,
Ata i kthejnë buzëqeshjen çdo fëmijë
Feti Vogli mbjell lule Shqipërie,
Skënderbegas të rriti ushtria,
Ku rrojnë bashkë nderi dhe lavdia.
O pishtar me dritë lirie,
Feti Vogli prej Shqipërie.”*



ndërkombëtare.

Pjesëtarët e Forcave Speciale që shërbyen në këtë mision e kujtojnë me krenari profesionalizmin dhe bashkëpunimin me partnerët strategjikë, si dhe nivelin e lartë të përgatitjes së efektivëve shqiptarë.

Edhe përfaqësues të lartë të shtetit dhe ushtarakë amerikanë kanë vlerësuar kontributin e Forcave Speciale shqiptare në operacionet e sigurisë dhe stabilizimit.

Në këtë mision, kapiten Feti Vogli nuk ishte thjesht një pjesëmarrës, ai ishte një komandant që mishëronte frymën e sakrificës dhe të detyrës deri në fund.

Dëshmori i Atdheut, një figurë që bashkon

Figura e kapiten Feti Voglit nderohet jo vetëm nga personeli i Forcave Speciale, por nga të gjitha strukturat e Ministrisë së Mbrojtjes dhe Shtabit të Përgjithshëm.

Veprat sublime të atyre që bien për idealet e larta të lirisë nuk harrohen. Ato jetojnë në memorien institucionale, në ceremonitë përkujtimore dhe në edukimin e brezave të rinj ushtarakë.

Kapiten Feti Vogli është shpallur Dëshmor i Atdheut – një titull që përmbledh jo vetëm aktin e rënies në detyrë, por

edhe jetën e jetuar me nder.

Çdo 20 shkurt, në ambientet ushtarake, në përkujtimore dhe homazhe, rikthehet kujtimi i tij. Emri i tij përmendet me respekt. Historia e tij u tregohet kursantëve dhe ushtarëve të rinj si model i përkushtimit maksimal ndaj flamurit dhe atdheut.

Sakrifica që nuk shuhet me kohën

Rënia e kapiten Feti Voglit në Afganistan nuk ishte vetëm një humbje për familjen dhe kolegët, por një plagë për gjithë Forcat e Armatosura. Megjithatë, nga kjo plagë lindi edhe një simbol.

Simboli i ushtarakut që përmbush misionin pa u tërhequr. Simboli i komandantit që qëndron në krye. Simboli i shqiptarit që shërben për paqen globale. Sakrifica e tij është pjesë e kontributit të Shqipërisë në misionet ndërkombëtare dhe në përpjekjet për siguri e stabilitet në botë.

Lavdi e përjetshme

E paharruar do të mbetet vepra e Dëshmorit të Atdheut, kapiten Feti Vogli, i rënë në krye të detyrës, më 20 shkurt 2012, në Afganistan.

Në memorien e Forcave të Armatosura ai mbetet një emër që frymëzon, një histori që edukon dhe një shembull që orienton brezat e rinj.

Heronjve u këndohen këngë.

Dëshmorëve u përkulen flamujt.

Ndërsa emrat e tyre shkruhen me germa të arta në historinë e kombit.

Lavdi dhe mirënjohje të përjetshme për sakrificën sublime të kapiten Feti Voglit dhe për të gjithë Dëshmorët e Atdheut që ranë në krye të detyrës, në shërbim të paqes, lirisë dhe nderit të Shqipërisë.



INDRIT CARA



"USHTAR KAVAJA",

NJË EMËR QË U BË

SIMBOL I LIRISË

Ai lindi në Kavajë, por sot i përket mbarë shqiptarisë. Jeta dhe rënia e **Indrit Carës** nuk janë thjesht një histori personale, por një kapitull i gjallë i kujtesës sonë kombëtare. I njohur me nofkën "Ushtar Kavaja", ai mbetet një figurë frymëzuese e guximit, përkushtimit dhe dashurisë për atdheun.

Në moshën 28-vjeçare, ai zgjodhi rrugën më të vështirë: t'i bashkohej radhëve të **Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës**, në kulmin e luftës për liri. Vendimi i tij ishte i qartë, i ndërgjegjshëm dhe pa kthim pas.

NGA KAVAJA NË FRONTIN E LUFTËS

Pas disa vitesh jetese në Angli, ku kishte ndërtuar një jetë të qetë dhe të qëndrueshme, Indriti u kthye, më 26 janar 1999, në shtëpinë e tij në Kavajë. Punonte, ndihmonte familjen dhe kishte krijuar stabilitet. Por brenda tij digjej një thirrje tjetër.

Atë mbrëmje janari, ai trokiti papritur në derën e prindërve. Malli ishte i madh. Qëndroi gjatë me ta, bisedoi, kujtoi kohët e fëmijërisë. Fotografitë e asaj nate tregojnë një djalë të qeshur, por me një vendim të prerë në zemër. Të nesërmen në mëngjes, ai u tha prindërve se do të shoqëronte dy gazetarë britanikë. Ishte një justifikim për të mos i shqetësuar. E vërteta ishte ndryshe: kishte vendosur të hynte në luftë. Më 27 janar 1999, ai përqafoi për herë të fundit nënën dhe babanë. U largua me premtimin se do të kthehej shpejt. Nga Tirana drejt Kukësit, e më pas drejt vijës së zjarrit.

NË MBROJTJE TË PASHTRIKUT
Indriti u vendos në vijën e parë të përballjes. Qëndroi i palëkundur



në betejat e ashpra të marsit 1999. Më 31 mars, gjatë luftimeve intensive në zonën e Pashtrikut, mori detyrën për të rimarrë dhe mbrojtur majën e malit të Gallushës, në mbrojtje të mijëra civilëve.

Misioni u realizua. Por një goditje nga minahedhësi i mori jetën.

Në moshën 28-vjeçare, "Ushtar Kavaja" ra në fushëbetejë. Rënia e tij nuk ishte fundi, por fillimi i përjetësisë në kujtesën e kombit.

NJË EMËR QË U KTHYE NË PËRJETËSI

Në tetor 1999, eshtrat e tij u kthyen në vendlindje. Kavaja e prit me dhimbje dhe krenari. Ai nuk u kthye më si djalë, por si simbol. Për veprën e tij, Presidenti i Republikës së Shqipërisë e dekoroi me "Shqiponjën e Artë", ndërsa Presidentja e Kosovës e nderoi me titullin "Hero i Kosovës". Institucionet vendore e shpallën "Dëshmor të Kombit dhe Atdheut". Bulevardi kryesor i qytetit dhe shkolla ku ai mësoi mbajnë sot emrin e tij.

NË TRADITËN E HERONJVE

Figura e Indrit Carës vendoset në një vijë historike që përfshin emra si **Adem Jashari**, **Ibrahim Rugova**, **Adem Demaçi** e shumë të tjerë që i dhanë formë përpjekjes për liri.

Në vargjet që i atribuohen "Ushtar Kavajës" ndihet fryma e kësaj trashëgimie:

"Tungjatjeta vëllezër, djemtë e Dardanisë
Jam Ushtar Kavaja, balli i trimërisë
Vëllai i Adem Jasharit, nip i Skënderbeut
Vetë do t'ia qepim hartën atdheut."
Këto rreshta nuk janë thjesht poezi;
janë deklarata të identiteti dhe besimi.

DY SHTETE, NJË KOMB

Sot Shqipëria dhe Kosova janë dy shtete të pavarura, por lidhja kombëtare mbetet e pandashme. Sakrifika e Indrit Carës shërben si kujtesë se liria nuk erdhi rastësisht.



Puthja e fundit e nënës

Ajo u fitua me mund, gjak dhe vendosmëri.

Identiteti shqiptar, i trashëguar ndër shekuj, kërkon ruajtje dhe përkushtim. Ai nuk është vetëm çështje historie, por përgjegjësi e përditshme.

NJË BUSULL PËR BREZAT


Historia e tij flet për integritet, kurajë dhe vendosje të interesit kombëtar mbi atë personal. Ai la pas një jetë të sigurt për t'iu përgjigjur një ideali. Për brezat që vijnë, shembulli i tij mbetet udhërrëfyes: një komb forcohet kur bijtë dhe bijat e tij veprojnë me ndershmëri, unitet dhe përgjegjësi. Integrimi në strukturat euroatlantike, zhvillimi dhe paqja janë aspirata që ndërtohen mbi themelet e sakrificave të tilla.

KUJTIM QË NUK SHUHET

Indrit Cara nuk është vetëm një emër në pllaka përkujtimore. Ai është pjesë e ndërgjegjes sonë kolektive. Kujtimi i tij jeton në zemrat e shqiptarëve, si një dritë që nuk zbehet.

**Lavdi Dëshmorit të Kombit,
Indrit Cara!**

**Lavdi të gjithë atyre që
sakrifikuan për lirinë!
Lavdi qytetarisë së Kavajës!**



Halil Huto Sullo



Tajar Shemsi Proda



Xhezo Dervish Proda

TRE DËSHMORË NGA OXHAKU “PRODA” KRENARI PËR SHQIPËRINË



PROF. ASOC. DR. ZAHO GOLEMI

Tre Dëshmorët e Fushëbardhës: Trupëzimi i Trimërisë dhe Atdhedashurisë

Në Fushëbardhë të Labërisë, një oxhak i lashtë i quajtur **Proda** ka lënë gjurmë të pashlyeshme në historinë e luftës për lirinë e Shqipërisë. Ky oxhak

ka dhuruar tre bij të tij për atdheun, të cilët u bënë simbol i sakrificës, trimërisë dhe idealit të lirisë:

- **Halil Huto Sullo/Proda (1862–1914)**
- **Xhezo Dervish Proda (1926–1944)**
- **Tajar Shemsi Proda (1924–1945)**

Të tre janë shpallur “Dëshmor të Atdheut” nga Komisioni Qendror i Statusit të Dëshmorëve në Ministrinë e Mbrojtjes, duke u vendosur në piedestalin e historisë së trimërisë labe dhe shqiptare.

Halil Sullo/Proda: Legjenda e Qafës së Skërficës

Halil Sullo/Proda lindi në qershor të vitit 1862, në Fushëbardhë dhe u rrit në një mjedis të mbushur me tradita luftarake e liridashëse. Në moshën 16 vjeçare, ai shërbeu për shtatë vjet si nizam në Anadoll (1880–1887), ku mësoi artin luftarak të kohës, përdorimin e

armëve, kamës dhe thikës. Ai rridhte nga një familje që historikisht kishte luftuar kundër pushtuesve.

Halil Sullo mori pjesë në **Kuvendin e Cepos, më 21 korrik 1911**, ku u zgjodh anëtar i komitetit me rreth 800 luftëtarë përfaqësues nga Gjirokastra, Përmeti, Tepelena, Delvina, Kurveleshi, Janina dhe Çamëria. Ai mori pjesë edhe në **Kuvendin e Shtëpëzit, më 10 prill 1914**, së bashku me luftëtarë të Fushëbardhës, ku vendosi që çdo pëllëmbë e tokës shqiptare të mbrohej me çdo kusht.

Si kryeplak dhe komandant i çetës së Fushëbardhës, Halil Sullo/Proda udhëhoqi **luftën e Skërficës**, një qëndresë heroike njëjavore. Ai luftoi trimërisht në Gurët e Bashe, kroi i Resule, Lisat e Skëndos, Shpella e Dhespinës, Vrahull dhe Qafë të Skërficës. Pas një beteje të përgjakshme, ra dëshmor, më **25 qershor 1914**, në hyrje të Shkëmbit të Skamanos në Kamenikë.

Poeti dhe patrioti Ramiz Harxhi përshkruan betejën e Skërficës:

“Në luftën e rreptë, q’u bënë Skërficë, Ku, kundër një tufe, luftoi një pakicë. Gryka e Skërficës, një grykë e keqe, Mbrohej prej ca burrash pa armë e fysheqe...”

Halil Sullo/Proda u shpall “Dëshmor i Atdheut” me **vendim nr. 162 datë 30.11.1979** të Komitetit Ekzekutiv të KP të rrethit Gjirokastrë. Gruaja e tij, Kane Sullo/Proda, e vajtoi duke thënë:

“O imzot a derëzi, Kush do të bëhet si ti, Të dalë në pleqësi, Për sinor e për kufi...” Emri i tij mbetet i ndritur në historinë luftarake, në lapidarin e Skërficës, në memorialin “Fushëbardha-2014” dhe në memorien kombëtare shqiptare.

Xhezo Dervish Proda, Hero i Popullit

Xhezo Dervish Proda lindi, më 20 shtator 1926, në lagjen Onjere të Fushëbardhës. Ai rridhte nga një familje me tradita luftarake dhe patriotike. Babai i tij, Dervish Proda, dhe të afërmit kishin marrë pjesë në Luftën Kombëtare të Vlorës më 1920, duke trashëguar tek Xhezo idealet e patriotizmit dhe përkushtimin ndaj lirisë.

Xhezo Proda mori pjesë si partizan në Luftën Nacionalçlirimtare dhe ra heroikisht, më **10 shtator 1944**, në Labinot të Elbasanit, bashkë me dhjetë partizanë të tjerë, duke luftuar kundër pushtuesve. Ai u shpall dëshmor, më **2 tetor 1971**, ndërsa statusi i tij u njoh me **vendim nr. 4 datë 27.11.2002**.

Familja e tij vazhdoi trashëgiminë patriotike, duke mbajtur gjallë idealet e lirisë dhe atdhedashurisë, ndërsa emri i Xhezos mbetet simbol i heroizmit dhe frymëzimit për brezat.

Tajar Shemsi Proda, Dëshmori i Tropojës

Tajar Shemsi Proda lindi, më 2 qershor 1924, në Fushëbardhë dhe mbeti jetim në moshën 6 vjeçare. U rrit tek teza e tij në Tiranë dhe kreu shkollën fillore dhe më pas shkollën amerikane “Harry Fultz”. Ai iu bashkua Brigadës VII Sulmuese (BrVS) dhe luftoi në Mat, Dibër, Kukës, Prizren dhe për çlirimin e trojeve shqiptare në Kosovë.

I plagosur rëndë në Prizren, u transportua në Tropojë për trajtim në spitalin partizan të Geghysenit, ku dha frymën e fundit më **22 mars 1945**, duke lënë fjalët në buzë: “Jam nga Fushëbardha...”.

Eshtrat e tij u rikthyen në Gjirokastrë, më 8 shtator 2016 dhe u varrosën pranë dëshmorëve të tjerë, duke përmbushur amanetin dhe duke i bashkuar përgjithmonë me idealin e lirisë. Tajar Proda është shpallur **“Dëshmor i Atdheut” me vendim nr. 127 datë 30.5.1985**.

Një Oxhak i Përjetshëm

Halil, Xhezo dhe Tajar Proda nuk janë vetëm emra, por simbol i një oxhaku të përjetshëm që frymëzon çdo shqiptar: Proda – një vatër ku trimëria, atdhedashuria dhe sakrifica janë të pandara. Ata mbeten pjesë e trupëzuar e krenarisë labe dhe shqiptare, në piedestalin e vlerave të lirisë dhe idealit kombëtar.

Historia e tre dëshmorëve të Fushëbardhës është një kujtesë e gjallë: **liria ka emra – Halil, Xhezo dhe Tajar Proda**, dhe ata do të mbeten përjetësisht inspirim për brezat që vijnë.



INTELIGJENCA

Artificiale dhe Rreziqet e Keqpërdorimit në Rrjetet Sociale

Aktualisht, njerëzit ndihen të hutuar nga sasia e madhe e informacionit online dhe kanë vështirësi të dallojnë informacionin e vërtetë nga ai i rremë, veçanërisht pas publikimit të dosjes së Epstein, e cila ka nxitur një valë të madhe diskutimesh dhe spekulimesh në rrjetet sociale. Ky fenomen është përkeqësuar nga përdorimi i inteligjencës artificiale, e cila mund të krijojë dhe përhapë përmbajtje të manipuluar dhe lajme të rreme në mënyrë shumë më efikase dhe të sofistikuar. Në epokën digjitale ku rrjetet sociale janë pjesë thelbësore e jetës sonë të përditshme, inteligjencia artificiale (AI-ja po luan një rol gjithnjë e më të rëndësishëm dhe njëkohësisht shqetësues. Ndërsa AI-ja sjell mundësi të reja për komunikim dhe përpunim informacioni, ajo gjithashtu hap dyer për keqpërdorime që mund të ndikojnë thellë në mënyrën se si perceptojmë realitetin dhe ndërveprojmë me botën përreth nesh.

Një nga sfidat më të mëdha që sjell përdorimi i AI-së në rrjetet sociale është përhapja e dezinformimit dhe lajmeve të rreme. Algoritmet e avancuara mund të krijojnë përmbajtje që duket e besueshme, por që në të vërtetë është e fabrikuar për të manipuluar opinionin publik. Kjo përmbajtje mund të përfshijë artikuj të rremë, video të manipuluar, apo edhe profile false që shërbejnë për të përhapur mesazhe të caktuara me qëllim.

Kjo situatë krijon një ambient ku përdoruesit e rrjeteve sociale janë të ekspozuar ndaj informacionit të pasaktë, duke vështirësuar dallimin mes faktit dhe trillimit. Për

më tepër, lajmet e rreme shpesh përhapen më shpejt dhe më gjerësisht se informacioni i verifikuar, duke rritur ndikimin e tyre negativ në shoqëri.

Përveç përhapjes së lajmeve të rreme, AI-ja përdoret gjithashtu për manipulimin e masës në mënyra më të sofistikuar. Përmes analizës së të dhënave të përdoruesve dhe sjelljeve të tyre online, sistemet e AI-së mund të krijojnë profile të detajuara psikologjike dhe sociale, të cilat përdoren për të targetuar mesazhe specifike që ndikojnë në mendimet dhe ndjenjat e individëve.

Kjo teknologji mund të përdoret për të formësuar opinionin publik në mënyrë të fshehtë, duke krijuar ndjenja të caktuara, duke nxitur polarizim apo duke minimizuar zërat kritikë. Në këtë mënyrë, AI-ja bëhet një mjet i fuqishëm për kontrollin dhe drejtimin e perceptimeve kolektive, shpesh pa dijeninë e atyre që ndikohen.

Keqpërdorimi i AI-së në këtë kontekst paraqet rreziqe serioze për shoqërinë dhe demokracinë. Një nga këto rreziqe është humbja e besimit në informacion dhe institucionet që e ofrojnë atë. Kur njerëzit nuk mund të dallojnë më mes të vërtetës dhe trillimit, krijohet një krizë besimi që dobëson dialogun publik dhe bashkëpunimin shoqëror.

Gjithashtu, manipulimi i opinionit publik mund të çojë në vendime të gabuara politike, sociale apo ekonomike,

duke dëmtuar stabilitetin dhe drejtësinë në shoqëri. Në nivel individual, ekspozimi ndaj përmbajtjes së manipuluar mund të ndikojë negativisht në mirëqenien psikologjike dhe në marrëdhëniet ndërpersonale.

Përballë këtyre sfidave, është thelbësore të vendosen rregulla dhe standarde etike që kufizojnë keqpërdorimin e AI-së në rrjetet sociale. Kjo përfshin transparencën në përdorimin e algoritmeve, përgjegjësinë për përmbajtjen e krijuar nga AI-ja dhe mekanizma efektivë për verifikimin e informacionit.

Bashkëpunimi ndërkombëtar dhe angazhimi i komunitetit teknologjik, ligjor dhe shoqëror janë të domosdoshëm për të krijuar një mjedis ku teknologjia shërben për të mirën e përbashkët, pa cenuar të drejtat dhe liritë themelore.

Inteligjenca artificiale është një mjet me potencial të jashtëzakonshëm, por përdorimi i saj në rrjetet sociale kërkon kujdes dhe përgjegjësi të madhe. Die3znformimi, lajmet e rreme dhe manipulimi i masës janë sfida reale që kërkojnë vëmendje të vazhdueshme dhe masa të forta për t'i adresuar. Vetëm në këtë mënyrë mund të sigurojmë që teknologjia të kontribuojë në një shoqëri më të informuar, të lirë dhe të drejtë për të gjithë.

Në këtë kontekst, nën-temat që trajtohen përfshijnë ndikimin e dosjes së Epstein në rritjen e konfuzionit dhe skepticizmit ndaj informacionit online, rolin e inteligjencës artificiale në krijimin dhe përhapjen e lajmeve të rreme, mënyrat se si algoritmet e AI-së manipulojnë opinionin publik përmes targetimit psikologjik, dhe rreziqet që këto praktika paraqesin për demokracinë dhe shoqërinë në përgjithësi. Gjithashtu, diskutohet nevoja për rregullime etike dhe ligjore, si dhe bashkëpunimi ndërkombëtar për të mbrojtur integritetin e informacionit dhe të drejtën e qytetarëve për të marrë vendime të informuara.

Në epokën digjitale ku rrjetet sociale janë pjesë thelbësore e jetës sonë të përditshme, inteligjenca artificiale (AI) po luan një rol gjithnjë e më të rëndësishëm dhe njëkohësisht shqetësues. Ndërsa AI-ja sjell mundësi të reja për komunikim dhe përpunim informacioni, ajo gjithashtu hap dyer për keqpërdorime që mund të ndikojnë thellë në mënyrën se si perceptojmë realitetin dhe ndërveprojmë me botën përreth nesh.

Dezinformimi dhe Lajmet e Rreme

Një nga sfidat më të mëdha që sjell përdorimi i AI-së në rrjetet sociale është përhapja e dezinformimit dhe lajmeve të rreme. Algoritmet e avancuara mund të krijojnë përmbajtje që duket e besueshme, por që në të vërtetë është e fabrikuar për të manipuluar opinionin publik. Kjo përmbajtje mund të përfshijë artikuj të rremë, video të manipuluar, apo edhe profile false që shërbejnë për të përhapur mesazhe të caktuara me qëllim.

Kjo situatë krijon një ambient ku përdoruesit e rrjeteve sociale janë të ekspozuar ndaj informacionit të pasaktë, duke vështirësuar dallimin mes faktit dhe trillimit. Për

më tepër, lajmet e rreme shpesh përhapen më shpejt dhe më gjerësisht se informacioni i verifikuar, duke rritur ndikimin e tyre negativ në shoqëri.

Manipulimi i Masës përmes Inteligjencës Artificiale

Përveç përhapjes së lajmeve të rreme, AI-ja përdoret gjithashtu për manipulimin e masës në mënyra më të sofistikuara. Përmes analizës së të dhënave të përdoruesve dhe sjelljeve të tyre online, sistemet e AI-së mund të krijojnë profile të detajuara psikologjike dhe sociale, të cilat përdoren për të targetuar mesazhe specifike që ndikojnë në mendimet dhe ndjenjat e individëve.

Kjo teknologji mund të përdoret për të formësuar opinionin publik në mënyrë të fshehtë, duke krijuar ndjenja të caktuara, duke nxitur polarizim apo duke minimizuar zërat kritikë. Në këtë mënyrë, AI-ja bëhet një mjet i fuqishëm për kontrollin dhe drejtimin e perceptimeve kolektive, shpesh pa dijeninë e atyre që ndikohen.

Rreziqet e Keqpërdorimit të Inteligjencës Artificiale

Keqpërdorimi i AI-së në këtë kontekst paraqet rreziqe serioze për shoqërinë dhe demokracinë. Një nga këto rreziqe është humbja e besimit në informacion dhe institucionet që e ofrojnë atë. Kur njerëzit nuk mund të dallojnë më mes të vërtetës dhe trillimit, krijohet një krizë besimi që dobëson dialogun publik dhe bashkëpunimin shoqëror.

Gjithashtu, manipulimi i opinionit publik mund të çojë në vendime të gabuara politike, sociale apo ekonomike, duke dëmtuar stabilitetin dhe drejtësinë në shoqëri. Në nivel individual, ekspozimi ndaj përmbajtjes së manipuluar mund të ndikojë negativisht në mirëqenien psikologjike dhe në marrëdhëniet ndërpersonale.

Nevoja për Rregullim dhe Etikë

Përballë këtyre sfidave, është thelbësore të vendosen rregulla dhe standarde etike që kufizojnë keqpërdorimin e AI-së në rrjetet sociale. Kjo përfshin transparencën në përdorimin e algoritmeve, përgjegjësinë për përmbajtjen e krijuar nga AI-ja dhe mekanizma efektivë për verifikimin e informacionit.

Bashkëpunimi ndërkombëtar dhe angazhimi i komunitetit teknologjik, ligjor dhe shoqëror janë të domosdoshëm për të krijuar një mjedis ku teknologjia shërben për të mirën e përbashkët, pa cenuar të drejtat dhe liritë themelore.

Inteligjenca artificiale është një mjet me potencial të jashtëzakonshëm, por përdorimi i saj në rrjetet sociale kërkon kujdes dhe përgjegjësi të madhe. Dezinformimi, lajmet e rreme dhe manipulimi i masës janë sfida reale që kërkojnë vëmendje të vazhdueshme dhe masa të forta për t'i adresuar. Vetëm në këtë mënyrë mund të sigurojmë që teknologjia të kontribuojë në një shoqëri më të informuar, të lirë dhe të drejtë për të gjithë.



Industria Ushtarake: Nga historia e armatimeve tek sfida e teknologjive moderne

Industria ushtarake është një nga sektorët më të vjetër dhe më të rëndësishëm të shoqërisë njerëzore. Që nga koha kur njeriu filloi të përdorte mjete primitive për mbrojtje dhe luftë, deri tek teknologjitë e sofistikuar të sotme, ky sektor ka qenë gjithmonë i lidhur ngushtë me mbijetesën, pushtetin dhe politikën. Në shekullin XXI, industria ushtarake nuk është thjesht një mekanizëm për prodhimin e armëve, por një sistem kompleks që përfshin kërkimin shkencor, inovacionin teknologjik, ekonominë dhe diplomacinë ndërkombëtare. Ky shkrim synon të

analizojë zhvillimin historik të industrisë ushtarake, rolin e saj në politikën globale, teknologjitë moderne që po e transformojnë atë, si dhe sfidat etike e ekonomike që e shoqërojnë.

[Rrënjët historike të industrisë ushtarake](#)

Që në lashtësi, fuqia e një shteti matej shpesh me aftësinë e tij për të prodhuar armë dhe për të mbajtur ushtri të organizuar. Egjiptianët, grekët dhe romakët ndërtuan perandori të mëdha falë superioritetit ushtarak.

Në Mesjetë, zhvillimi i armëve të ftohta si shpata, harku dhe më vonë baruti, solli ndryshime të mëdha në mënyrën e luftës. Revolucioni industrial i shekullit XIX e transformoi industrinë ushtarake duke e kthyer atë në një sektor të mekanizuar, ku prodhimi masiv i armëve u bë i mundur. Luftërat botërore të shekullit XX e çuan këtë industri në nivele të papara më parë, me tanke, avionë, nëndetëse dhe armë bërthamore.

Lufta e ftohtë dhe gara e armatimeve

Pas vitit 1945, bota u nda në dy blloqe të mëdha: SHBA dhe Bashkimi Sovjetik. Lufta e Ftohtë solli një garë të ethshme armatimesh, ku të dyja superfuqitë investuan miliarda dollarë për të zhvilluar raketa balistike, sisteme mbrojtjeje ajrore dhe teknologji bërthamore. Ky rivalitet nuk ishte thjesht ushtarak, por edhe politik e ideologjik. Industria ushtarake në këtë periudhë u bë motor i inovacionit teknologjik, duke nxitur zhvillime që më vonë gjetën përdorim edhe në jetën civile, si satelitët dhe interneti. Megjithatë, kjo garë solli edhe frikën e një konflikti global shkatërrues, duke e bërë kontrollin e armëve një temë të rëndësishme në diplomacinë ndërkombëtare.

Industria ushtarake në shekullin XXI

Në ditët e sotme, industria ushtarake është më e sofistikuar se kurrë. Konfliktet moderne nuk zhvillohen vetëm në fushëbetejë, por edhe në hapësirën digjitale dhe atë kozmike. Shtetet po investojnë në dronë të avancuar, inteligjencë artificiale, robotikë dhe sisteme kibernetike mbrojtjeje. Dronët përdoren për survejim, operacione precize dhe shpesh për eliminimin e objektivave pa rrezikuar jetën e ushtarëve. Inteligjenca artificiale po ndihmon në analizën e shpejtë të të dhënave, duke lejuar vendimmarrje taktike në kohë reale. Ndërkohë, mbrojtja kibernetike është kthyer në një fushë të domosdoshme, pasi sulmet digjitale mund të paralizojnë sisteme të tëra ushtarake dhe infrastruktura kritike.

Teknologjitë që po e transformojnë luftën

Dronët dhe robotika: kanë revolucionarizuar operacionet ushtarake, duke e bërë luftën më të distancuar dhe më të kontrolluar.

- Sistemet raketore dhe mbrojtja ajrore: si "Patriot" apo "Iron Dome" janë bërë elementë kyç për sigurinë e hapësirës ajrore.
- Inteligjenca artificiale: përdoret për analizë të të dhënave, simulime strategjike dhe vendimmarrje automatike.
- Mbrojtja kibernetike: është kthyer në një fushë të re lufte, ku shtetet përballen përmes sulmeve digjitale.

- Hapësira kozmike: satelitët ushtarakë përdoren për komunikim, survejim dhe navigim, duke e bërë hapësirën një arenë të re rivaliteti.

Sfida ekonomike dhe etike

Industria ushtarake është shpesh e kritikuar për kostot e larta që sjell. Miliarda investime në armatime shpesh krahasohen me nevojat sociale si arsimi, shëndetësia dhe infrastruktura. Shumë analistë argumentojnë se fondet e mëdha të shpenzuara për armë mund të përdoren për zhvillim ekonomik dhe mirëqenie sociale. Nga ana etike, përdorimi i teknologjive të reja si inteligjenca artificiale ngre pyetje mbi kontrollin dhe përgjegjësinë. Kush mban përgjegjësi nëse një dron autonom kryen një sulm të gabuar? Këto dilema e bëjnë industrinë ushtarake një fushë ku përplasen interesat e sigurisë, ekonomisë dhe moralit.

Roli i industrisë ushtarake në politikën ndërkombëtare

Industria ushtarake nuk është thjesht një sektor ekonomik, por një instrument politik. Eksporti i armëve shpesh përdoret si mjet ndikimi diplomatik. Shtetet e mëdha furnizojnë aleatët e tyre me armë, duke forcuar lidhjet strategjike. Megjithatë, ky eksport mund të përshkallëzojë konfliktet në rajone të caktuara, si Lindja e Mesme apo Afrika. Për këtë arsye, kontrolli ndërkombëtar i tregtisë së armëve është një temë e rëndësishme në organizata si OKB.

Perspektiva e së ardhmes

E ardhmja e industrisë ushtarake pritet të lidhet ngushtë me teknologjitë digjitale dhe hapësirën kozmike. Shtetet po investojnë në satelitë ushtarakë, sisteme mbrojtjeje hapësinore dhe mjete të avancuara komunikimi. Gjithashtu, bashkëpunimi ndërkombëtar për kontrollin e armëve do të jetë i domosdoshëm për të shmangur konflikte të mëdha dhe për të ruajtur ekuilibrin global. Industria ushtarake nuk është thjesht një sektor ekonomik apo teknologjik, por një element kyç që formëson politikën ndërkombëtare dhe sigurinë e njerëzimit.

Industria ushtarake është një fushë komplekse, ku bashkohen historia, teknologjia, ekonomia dhe politika. Ajo ka qenë gjithmonë një faktor përcaktues në zhvillimin e shoqërisë njerëzore dhe mbetet një nga sektorët më të rëndësishëm në botën moderne. Megjithatë, sfidat etike dhe ekonomike që e shoqërojnë kërkojnë një debat të vazhdueshëm mbi rolin e saj. Nëse industria ushtarake do të përdoret për të ruajtur paqen apo për të nxitur konflikte, kjo mbetet një pyetje që bota duhet ta adresojë me kujdes.



ATDHEU
NDERI
DETYRA

REVISTA "Mbrojtja"

Botim i Ministrisë së Mbrojtjes